



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE”

NË

MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë, 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-4
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	6
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	6
2.	Identifikimi i çështjes	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	7
7.	Metodat e auditimit	7-8
8.	Dokumentimi i auditimit	8
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:	8-9
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm.	9-18
2.2	Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.	18-30
2.3	Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.	30-39
2.4	Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera.	39-42
2.5	Prokurimet e fondeve publike.	42-64
2.6	Të tjera, në vlerësim të rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatorë, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ISH MTM-së, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.	64-78
IV	REKOMANDIME	78-85

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit Nr. 399/1, datë 15.04.2025, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.04.2025 deri më datë 31.07.2025, ne kemi audituar subjektin Ministria e Turizimit dhe Mjedisit (*këtu e në vijim MTM*) e cila sot pas riorganizimit është ndarë në Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministria e Mjedisit. Ish MTM ka funksionuar në mbështetje të Ligjit Nr. 93/2015 “*Për Turizmin*” i ndryshuar si dhe akteve ligjore e nënligjore për mjedisin. Objekti i veprimtarisë në fushën e turizmit është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në bashkëpunim me të gjithë aktorët e industrisë turistike.

Rëndësia e auditimit të tij.

KLSH në zbatim në nenit 6 dhe 10 të Ligjit Nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit*” i ndryshuar ka detyrimin të auditojë në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, standardet ndërkombëtare të auditimit si dhe në ushtrim të kompetencave të tij ligjore auditon përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në funksion të këtyre detyrimeve ligjore auditimi u krye në përmbushje të programit mujor të planifikimit të auditimit.

Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi, synon në dhënien e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me veprimtarinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për periudhën 01.01.2023 deri me datë 31.12.2024, nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë ish Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm.
- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera.
- Prokurimet e fondeve publike.
- Të tjera, në vlerësim të rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatorë, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ish MTM-së, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

-Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodat për kryerjen e këtij e auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;
- c. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve të dhëna. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni ish Ministria e Turisimit dhe e Mjedisit për periudhën e audituar 01.01.2023 deri me datë 31.12.2024, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar gjetje dhe ka dhënë rekomandime:

Në total **15** rekomandime, **12** rekomandime për masa organizative, **1** rekomandim për shpërblim dëmi, **2** rekomandime për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet.

Paraqitja e gjetjeve kryesore, të cilat janë konstatuar në:

Drejtimi 1: Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm, **2** gjetje për masat organizative dhe **1** gjetje për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën 27,164,000 lekë nga ekzekutimi i vendime gjqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë të punonjësve si pasojë e mos marrjes së masave për sistemimin e tyre për rikthim në detyrë apo në pozicione ekuivalente.

Drejtimi 2: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit është konstatuar **1** gjetje për masat organizative.

Drejtimi 3: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar **2** gjetje për masat organizative.

Drejtimi 4: Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera janë konstatuar **4** gjetje për masat organizative.

Drejtimi 5: Prokurimet e fondeve publike, janë konstatuar **2** gjetje për masë organizative, **1** gjetje për shpërblim dëmi në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH dhe **1** gjetje për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën 1,152,000 lekë.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Grupi i auditimit ka propozuar **12** rekomandime për masa organizative, **1** rekomandim për shpërblim dëmi, **2** rekomandime për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet konstatuar në:

Drejtimi 1: Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm, janë propozuar **2** rekomandime për masa organizative dhe **1** rekomandim për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën 27,164,000 lekë e cila përfaqëson shpenzimet për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjqësore për gjqëfituesit e larguar nga puna pa marrë masa më parë masa për sistemimin e tyre për rikthim në detyrë apo në pozicione ekuivalente.

Drejtimi 2: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit, propozuar **2** rekomandime për masa organizative.

Drejtimi 3: Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, janë propozuar **2** rekomandime për masa organizative.

Drejtimi 4: Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera janë propozuar **4** rekomandime për masa organizative.

Drejtimi 5: Prokurimet e fondeve publike, janë propozuar **2** rekomandime për masa organizative, **1** rekomandim për shpërblim dëmi në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera ose punime të llogaritura jo sipas gjendjes faktike në objekt si dhe **1** rekomandim për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën 1,152,000 lekë për marrje me qira të automjeti të pa justifikuar dhe të pa bazuar.

1.3. Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi përputhshmërinë (i modifikuar/kualifikuar ¹)

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregulloret dhe rregullat që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, zbatimin e buxhetit të shtetit, marrëdhëniet e punës dhe të pagave, veprimet me bankën, prokurimet publike etj. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit/dokumentacionin e kërkuar dhe vënë në dispozicion, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar/**kualifikuar**, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin Nr.154/2014, miratuar në datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 245, datë 29.12.2022. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P-10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit **të modifikuar/kualifikuar**, i cili rezulton në:

- shpenzimet e kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për gjyqëfituesit e larguar nga puna në vlerën në vlerën 27,164,000 lekë pa marrë masa për sistemimin e tyre për rikthimin në detyrë apo në pozicione ekuivalente;
- diferenca në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH që përbën dëm ekonomik për buxhetin e cila rezulton, nga llogaritjet e gabuara, punimet e pakryera ose punimeve të llogaritura jo sipas gjendjes faktike në objekt në zbatimin e kontratës për tenderin me objekt “Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”;
- përdorimin e fondeve publike pa ekonomikitet dhe efektivitet në vlerën 1,152,000 lekë, për marrjen me qira të një mjeti brenda periudhës së garancisë së mjetit të riparuar pa argumentuar dhe të pa bazuar;
- përditësimin e faqes së ëeb-it me dokumentet e transparencës, jo në mënyrë të rregullt pasi mungon baza e centralizuar e të dhënave për të ardhurat dhe detyrimet në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar;
- mos dërgimi i kërkesave buxhetore nga disa njësi varësie (AKT- për fazën e II të PBA 2023-2025) dhe (AKZM-për fazën e I të PBA 2024-2025 sipas formateve të kërkuara) veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe aktet nënligjore respektive;
- investimet me financim të huaj për të cilat MTM paguan TVSH, disa projekte nuk ishin planifikuar në PBA, me pretendimin se kërkesa për likuidimin e TVSH-së nga donatori ka ardhur pas afatit të mbylljes së PBA-ve përkatëse;

¹ Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin Nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3 Një opinion ”i modifikuar”, jepet kur audituesi modifikon opinionin në rastet e: a. anomalive dhe mospërputhjeve materiale. Në varësi të shtrirjes së mospërputhjes, kjo mund rezultojë në: opinion të kualifikuar ose opinion të kundërt: a. raste të anomalive dhe mospërputhjeve materiale. Në varësi të shtrirjes së mospërputhjes, kjo mund rezultojë në: opinion të kualifikuar ose opinion të kundërt.

-në procedurat e prokurimit “marrëveshje kuadër/minikontratat dhe procedurat me blerje të vogël, përbërja e Komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit/mallit nuk është sipas kërkesave të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Nr. 399/1, datë 15.04.2025, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.04.2025 deri më datë 31.07.2025, në subjektin ish Ministria e Turizimit dhe Mjedisit, u krye auditimi i përputhshmërisë për periudhën nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024 nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H. p/grupi
2. E. K. auditues
3. A. S. auditues
4. M. V. auditues
5. A. S. auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm, hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, zbatimin e dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera, auditimin e prokurimeve me fonde publike si dhe të tjera, në vlerësim të rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatorë, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ish MTM-së, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur aktkonstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në terren me datë 31.07.2025 me përfaqësues të ish MTM-së si dhe grupit të auditimit. Takimi përmbyllës në terren është mbajtur sipas protokollit përkatës (Dokumenti standard 2/2) parashikuar në “Rregulloren e Procedurave të Auditimit”, miratuar me Vendimin Nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH, e ndryshuar.

OBJEKTIVAT, FUSHË VEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit të rregullave dhe ligjeve. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e ish MTM-së për periudhën në auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së ish MTM-së.

2. Identifikimi i çështjes.

Projektraporti mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së ish MTM-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024, ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me zbatimin e buxhetit të shtetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, prokurimet e fondeve publike, vlerësimin e funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe auditit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të ish MTM-së, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësiave të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/ish MTM dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojnë e kryejnë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për zbatimin e buxhetit të shtetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, prokurimet e fondeve publike, vlerësimin e funksionit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar;

- Ligji nr.9936, datë 26,06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;

- Ligji nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6. Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 “*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;

-Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.;

-Praktikat më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arrijtjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me punonjësit e ish ISH MTM-së, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në aktkonstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e Projekt Raportit. Nga subjekti nuk ka patur observacione në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit si dhe nuk ka patur kërkesë për organizimin e një takimi mirëkuptimi në KLSH, me përfaqësues të subjektit dhe të grupit të auditimit, duke vijuar me hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin e zbatimin e politikave për turizmin.

Ish Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha të përgjegjësisë shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

a) Sektorin e Mjedisit, përfshirë politikën, standardet e trajtimit të mbetjeve dhe të efekteve që sjellin në drejtim të ajrit dhe mjedisit, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit dhe të cilësisë së ujërave, vlerësimin e ndikimit në mjedis.

b) Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve dhe zonat e mbrojtura.

c) Sektorin e Pyjeve dhe të Kullotave.

d) Harton dhe zbaton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 399/1, datë 15.04.2025 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin ish Ministria e Turizimit dhe Mjedisit u ushtrua auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2023-31.12.2024, sipas këtyre drejtimeve:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm.
- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.
- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.
- Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera.
- Prokurimet e fondeve publike.
- Të tjera, në vlerësim të rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatorë, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ish MTM-së, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

2.1 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar si dhe auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 1, të Programit të Auditimit Nr. 399/1, date 15.04.2025 i ndryshuar, u krye auditimi i këtij drejtimi bazuar në:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet në zbatim të Ligjit;
- Ligjin nr. 43/2023, datë 18.05.2023 “Për qeverisjen elektronike”;
- Ligjin Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe aktet në zbatim të Ligjit;
- Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Drejtimet kryesore ku u fokusua auditimi:

- Implementimi i 5 komponentëve të sistemeve të MFK
- Organizimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Komponenti I “Mjedisi i kontrollit”

Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë:

- ➔ integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njesisë publike;
- ➔ politikat menaxheriale dhe stilin e punës;
- ➔ strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;
- ➔ politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- ➔ aftësitë profesionale të punonjësve.

Integriteti personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njesisë publike.

Në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në Kapitullin III, pika 3.1 për menaxhimin e veprimtarisë së institucionit ish MTM janë miratuar:

- Kodi i Etikës, me urdhrin nr. 8920/1 prot., datë 20.11.2018 “*Rregullore e Kodit të sjelljes së mirë dhe etikës në Administratë*”, të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit përditësuar dhe ndryshuar me Urdhrin nr. 242, datë 25.06.2025.
- Rregullorja për parandalimin e konfliktit të Interesit , me Urdhrin nr. 380, datë 18.11.2019 ndryshuar.
- Ngritja e grupit të punës për Autoritetin Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me urdhrin nr. 374, datë 08.11.2019.

Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, janë paraqitur në strategjinë institucionale të MTM. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxiti kompetencën dhe sjelljen etike. Miratimi i planeve strategjike dhe i planeve vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe plan veprimet për arritjen e objektivave të vendosura, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i tyre është bërë referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, të ndryshuar, neni 8, pika 8/a. Për sa më sipër, rezultoi se ish MTM ka hartuar një strategji institucionale e cila është e publikuar edhe në faqen web, në programin e transparencës ku paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 8, pika 8/b dhe neni 27. Janë ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe grupet me Ekipet e Menaxhimit të Programit (EMP) për hartimin dhe miratimin e PBA për periudhën 2024-2026 dhe 2025-2027, përkatësisht:

- Me Urdhrin nr.130, datë 20.04.2023 “Për krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS)”.
- Me Urdhrin nr. 136, datë 25.04.2023 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit strategjik (EMP)” i ndryshuar me urdhrin nr. 259, dt 22.08.2023 dhe me urdhrin nr. 406, date 22.12.2023.
- Me Urdhrin nr. 150, datë 08.04.2024 “Për krijimin e grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS)” për vitin 2024.
- me Urdhrin nr.153, datë 15.04.2024 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit strategjik (EMP)” për vitin 2024.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejta, përgjegjësitë.

Për vitin 2023, MTM ka zbatuar Rregulloren e Brendshme miratuar me Urdhrin Nr. 420, datë 07.11.2018, i ndryshuar dhe për vitin 2024 Rregullorja e Brendshme është ndryshuar dhe miratuar me Urdhrin nr. 184, datë 15.05.2024. Struktura dhe Organika e MTM për vitin 2023 deri në fillim të vitit 2024, është bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.185, datë 15.11.2022 dhe për vitin 2024, është bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 28, datë 09.02.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së MTM*”.

Miratimi i tyre nga Ministri, është bërë në përputhje me Urdhrin nr. 184, datë 15.5.2024. Në rregullore përshkrimi i vendeve të punës është bërë në zbatim të VKM nr.142, datë 12.3.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Nga auditimi mbi “Menaxhimin e burimeve njerëzore” objekt i këtij auditimi, ka rezultuar:

- MTM përgjithësisht, ka ndjekur politika të drejta dhe të qarta në lidhje me rekrutimin, emërimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë etj., të stafit;
- në dosjen e çdo punonjësi ndodhej përshkrimi individual i punës;
- për periudhën objekt auditimi janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në Ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, neni 62. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit’.

- nga njësia e Burimeve Njerëzore në MTM, ishin hedhur në sistemin HRMIS, të dhënat për edukimin, trajnimet, rekrutimet, procedurat disiplinore, etj. për punonjësit e aparatit të MTM.

Aftësitë profesionale të punonjësve.

Bazuar në kërkesat e paraqitura nga vet punonjësit sipas drejtorive, MTM ka hartuar Planin Vjetor të Trajnimeve për vitet 2023 dhe 2024. Këto plane janë përcjellë në ASPA respektivisht në muajt dhjetor 2022 dhe dhjetor 2023 me e-mail. Për vitin 2023, rezulton se planifikimi për trajnime të stafit ka patur disa probleme, të cilat janë trajtuar si fusha me risk të lartë në rregjistrin e riskut

Pretendimi i ngritur nga MTM mbi mungesën e trajnimeve (nga ASPA) për ngritjen e aftësive teknike që përputhen me proceset e punës së Drejtorisë së rregullimit të Lejeve, Licensave dhe Monitorimit nuk qëndron pasi trainimi i stafit për këtë strukturë bëhet nga vetë ISH MTM.

Trajnimet që janë realizuar për vitin 2023 janë gjithsej 30.

Për vitin 2024, rezulton se planifikimi për trajnime të stafit ka patur përsëri problem si: mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për stafin e drejtorisë (të konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve në turizëm) në lidhje me hartimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorim&vlerësimin e projekteve; mungesa e trajnimeve për pozicionet e punës në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës (DIKMA) veçanërisht ato që mbulojnë kontratat dhe marrëveshjet.

Për vitin 2024 janë trajnuar 81 punonjës përkatësisht brenda vendit nga ASPA (on line), nga Banka Botërore, nga Akademia e Mjedisit, nga Qendra rinore Trokitje (OJF) etj si dhe jashtë vendit.

Në zbatim të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike” i ndryshuar, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “GMS duhet të mbliidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe t’i vihet në dispozicion drejtitimit në njësinë publike”.

Konstatim: *Ish MTM nuk ka të përcaktuar gjurmët për takimet e GMS dhe të EMP-ve, dhe për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.*

-për vitin 2023- 2024, rezulton se planifikimi për trajnime të stafit ka patur disa probleme, të cilat janë trajtuar si fusha me risk të lartë në rregjistrin e riskut të miratuar nga ish MTM.

-kriteret e pranimit për punonjësit e rekrutuar janë të përgjithshme dhe nuk ka kriteret specifike referuar pozicionit në strukturë, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Komponenti II “Menaxhimi i riskut”

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve ose situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të të gjithë njësisë publike dhe konceptohet për të dhënë garanci të arsyeshme se këto objektiva do të arrihen.

Në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 21, pika 2 përcaktohet se “Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nga MTM janë hartuar strategjitë dhe është hartuar rregjistrin e riskut në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, nenin 12, pika 3, ku përcaktohet se “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për identifikimin dhe krijimin e regjistrin të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Për vitin 2023, si aktivitete me risk të lartë janë evidentuar 7 që i përkasin objektivave të ndryshme.

Komponenti III “Aktivitetet e kontrollit”

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e miratuara si dhe të nxisin zbatimin e vendimmarrjeve. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues.

MTM ka hartuar rregulloren e përgjithshme për ndarjen e detyrave, por nuk ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditimit. Kjo tregon se komponentët kyç të mjedisit të kontrollit dhe të aktiviteteve të kontrollit nuk janë dokumentuar e formalizuar siç kërkohet, gjë që ul efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Miratimi i Nëpunësit Autorizues/Sekretar i Përgjithshëm në MTM, është bërë me shkresën nr.22245/1 prot., datë 22.12.2021 “Mbi konfirmimin e Nëpunësit Zbatues në MTM” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Bazuar në nenin 10 të MFK, Nëpunësit Autorizues gëzon edhe të drejtën si Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut.

Nëpunës zbatues për vitin 2023, në ish MTM deri në muajin qershor 2023 ka qenë z. S. J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve të Përgjithshme dhe nga data 13.06.2023 e në vazhdim është caktuar z. T. V. me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 i ndryshuar, dhe me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar.

Konstatim:

- MTM nuk ka përzgjedhur dhe zhvilluar aktivitete të kontrollit mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me parimin 11, për komponentin e aktivitetit të kontrollit, të Manualit për MFK, për të cilën duhej të bëhej edhe deklarata e vetëvlerësimit dhe cilësisë.
- MTM nuk ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditimit.

Për hartimin e hartës së proceseve të punës, me Urdhrin nr.1 32, datë 24.04.2023 është ngritur grupi i punës nga Titullari i MTM. Afati i përcaktuar për përgatitjen e këtij dokumenti ka qenë data 31 maj 2023, datë në të cilin nuk është paraqitur asnjë draft, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 16. Gjurmët e auditit janë miratuar vetëm për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm. Për Drejtorinë e prokurimeve, ky manual nuk është miratuar për periudhën objekt auditimi, por rezulton që është miratuar për vitin 2025.

Mungesa e hartës së proceseve të punës dhe e gjurmëve të auditit konstatohet edhe për proceset edhe sistemin e menaxhimit të të ardhurave të krijuara në aparatin e MTM.

Kjo mënyrë e menaxhimit të informacionit ka sjellë pasaktësi në të dhënat financiare dhe operacionale, mungesë të integritetit dhe besueshmërisë të sistemit të ardhurat, në mospërputhje me komponentin e MFK, “Aktiviteti i kontrollit”, parimi 10 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit që kontribuojnë në zbutjen e risqeve për arritjen e objektivave në nivele të pranueshme” të Udhëzimit nr. 2, datë 26.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

Gjurmët e auditit mungojnë edhe për procedurën e përdorimit dhe dorëzimit të kredencialeve për sistemet dhe platformat elektronike qeveritare (e-albania, e-filling, HRMIS/regjistër i Burimeve Njerëzore, Platforma e fiskalizimit të faturave elektronike, të sistemit të përdorimit APP etj për të cilin punonjësit përdorin kredenciale konfidenciale (ID, fjalëkalim/kode). Keqpërdorimi i tyre nga persona të paautorizuar mund të sjellë manipulim të informacionit financiar dhe operacional, mund të japi efekte negative financiare apo dëme ekonomike për institucionin.

Komponenti IV “Informacioni dhe komunikimi”

Komunikimi është shkëmbimi i informacionit të dobishëm midis njerëzve në të gjitha nivelet, si në mënyrë vertikale dhe horizontale dhe midis njësive për të mbështetur vendimet dhe koordinimin e aktiviteteve. Informacioni duhet t’iu komunikohet menaxherëve dhe punonjësve të tjerë që kanë nevojë për to në një formë dhe brenda një afati kohor që i ndihmon ata të kryejnë përgjegjësitë e tyre.

Informacionet dhe Komunikimi në MTM realizohet si në mënyrë të brendshme, ashtu edhe të jashtme, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes dhe koordinimin institucional. Komunikimi i brendshëm bëhet verbalisht, jo verbalisht nëpërmjet shkresave zyrtare dhe elektronikisht (e-mail). Komunikimi i jashtëm realizohet përmes:

- faqes zyrtare të internetit
- me adresat elektronike zyrtare (e-mail)
- njoftimeve për median
- rrjeteve sociale
- aktiviteteve publike
- takimeve me grupet e interesit (operatorë turistikë vendas dhe të huaj, shoqata, OJF)
- pjesëmarrjes nëpër panaiere dhe forume turistike.

MTM ka miratuar strategji dhe rregullore për komunikimin, ku janë përcaktuar edhe personat përgjegjës përkatësisht zëvendësministri, këshilltarët për komunikimin dhe marrëdhëniet me Parlamentin, drejtori i kabinetit të ministrit etj.

Referuar regjistrimit të riskut për vitin 2023 konstatohet si aktivitet me risk të lartë, mospublikimi në website i projek takteve duke sjell transparencë të ulët publike.

Nga auditimi ka rezultuar se mënyrat e raportimit dhe komunikimit janë të përcaktuara në Rregulloren e brendshme. Çdo tremujor është raportuar në MPF ecuria e detyrimeve të prapambetura, si dhe ecuria e investimeve mujore në sistemin e investimeve. MTM përdor sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) dhe ka program kontabiliteti ALPHA ëeb, për regjistrimin e veprimeve financiare, inventarin e asetëve etj., duke monitoruar në kohë reale shpenzimet financiare.

Stafi i MTM-së ka akses në e-mailim zyrtar, i cili sigurohet nëpërmjet AKSHI-it, duke patur parasysh ruajtjen e të dhënave dhe konfidencialitetit të shkresave dhe komunikimeve zyrtare.

Konstatim: Konstatohet se faqja ëeb nuk përditësohet rregullisht me dokumentet që duhet të pasqyrohen në programin e transparencës, në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, neni 7. Mungon një rrjet i strukturuar për shkëmbimin e informacionit ndërmjet niveleve hierarkike, si dhe një bazë të dhënash e centralizuar për sistemin e të ardhurave, për kontratat dhe detyrimet kontraktuale, edhe pse në financë përdoret programi informatik Alpha/ëeb. Raportimi sistematik mbi performancën, mangësitë dhe përdorimin e burimeve mbetet i dobët, pasi punonjësit shpesh nuk janë të qartë se ku duhet të raportojnë për problematikat. Ka përpjekje të kufizuara për ndërtimin e rregulloreve por të pa finalizuara.

Komponenti V “Monitorimi”

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë, duhet t’i kushtojnë vëmendje gjendjes së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe objektivave të arritura.

Bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, neni 9, pika 3 përcaktohet se “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë”.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të tjerë të menaxhimit financiar dhe kontrollit është plotësuar pyetsori i vetëvlerësimit për të dy vitet objekt auditimi. MTM ka dërguar në Ministrinë e Financave “Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm” me shkresën nr. 1554/1 prot., datë 26.2.2024 dhe “Raportin vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm” me shkresën nr.1554/2 prot., datë 26.2.2024 në përputhje me afatet, por në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2024 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”. Në zbatim të UMF nr.14 datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, i ndryshuar konstatohet se nga Drejtuesit e ekipeve të menaxhimit (EMP) dhe nga GMS nuk janë zbatuar proceset e monitorimit të aktiviteteve sipas produkteve të planifikuara veçanërisht për fondet e financimit të huaj dhe për projektet në fushën e turizmit.

Në kuadër të zbatimit të komponentit 5 “Monitorimi” të MFK, GMS/EMP nuk ka kryer procesin e monitorimit për kthimin në detyrë të punonjësve të laguar nga puna gjyqfitues në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar, neni 9, pika 3. Ekzekutimi i vendimeve është bërë pa iu ofruar rikthimin në vendin e mëparshëm duke sjellë si pasoje efekt financiar në buxhetin e ministrisë për shumat 27,164 mijë lekë për 2 vitet.

Në ISH MTM, për kryerjen e pagesave funksionon sistemi i dy firmave përkatësisht:

-Miratimi i Nëpunësit Autorizues /Sekretar i Përgjithshëm, me shkresën nr. 22245/1 prot., datë 22.12.2021 “Mbi konfirmimin e nëpunësit zbatues në MTM” nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Bazuar në nenin 10 të Ligjit për MFK, Nëpunësit Autorizues gëzon edhe të drejtën si Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut.

-Nëpunës Zbatues për vitin 2023, deri në muajin qershor 2023 ka qenë z. S. J. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik dhe i Shërbimeve të Përgjithshme dhe nga data 13.06.2023 e në vazhdim është caktuar z. T. V. me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar dhe me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar.

Konstatimi: Konstatohet se nga Drejtuesit e ekipeve të menaxhimit (EMP) dhe nga GMS nuk janë zbatuar proceset e monitorimit të aktiviteteve sipas produkteve të planifikuara veçanërisht për fondet e financimit të huaj dhe për projektet në fushën e turizmit.

-ekzekutimi i vendimeve është bërë pa iu ofruar rikthimin në vendin e mëparshëm duke sjellë si pasoje efekt financiar në buxhet për shumat 27,164 mijë lekë për 2 vitet.

Konkluzion: Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar për vitet 2023-2024 rezultoi:

- MTM nuk ka të përcaktuar gjurmët për takimet e mbledhjeve të GMS dhe të EMP-ve, dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi;

- planifikimi për trajnimet e stafit ka patur disa probleme, trajtuar dhe si fusha me risk të lartë në rregjistrin e riskut të miratuar nga MTM;

-kriteret e pranimit për punonjësit e rekrutuar nuk janë specifike referuar pozicionit në strukturë, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

-nuk ka përzgjedhur dhe zhvilluar aktivitete të kontrollit mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me parimi 11, të Manualit për MFK, për të cilën duhej të bëhej edhe deklarata e vetvlerësimit dhe cilësisë.

-nuk ka hartuar dhe miratuar hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditimit.

-faqja web nuk përditësohet rregullisht me dokumentet që duhet të pasqyrohen në programin e transparencës, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar.

-nga Drejtuesit e ekipeve të menaxhimit (EMP) dhe nga GMS nuk janë zbatuar proceset e monitorimit të aktiviteteve sipas produkteve të planifikuara veçanërisht për fondet e financimit të huaj dhe për projektet në fushën e turizmit.

-ekzekutimi i vendimeve është bërë pa ju ofruar rikthimin në vendin e mëparshëm duke sjellë si pasojë efekt financiar në buxhet për shumën 27,164 mijë lekë për 2 vitet.

Auditi i brendshëm.

Në zbatim të pikës 1, nënpika 1.2 i programit të auditimit: Auditi i brendshëm, janë shqyrtuar dokumentacionet të cilat janë hartuar dhe monitoruar nga Drejtoria e Auditit të brendshëm, si vijon:

- Plani Strategjik 2023-2025, Plani Vjetor 2023
- Plani Strategjik 2024-2026, Plani Vjetor 2024, miratimi i ndryshimit të planit
- Realizimi 2023 dhe 2024
- Raporti i Vetëvlerësimit 2023 dhe 2024
- Karta e auditimit
- Raporti i zbatimit të rekomandimeve 2023 dhe 2024
- Funksionimi i Komitetit të auditimit 2024 (në vitin 2023 nuk ka patur Komitet)
- Urdhëri i ministrit për krijimin e Komitetit të Auditit
- Proces Verbalet e mbledhjeve
- Rregullorja e Funksionimit
- Raporti i dërguar në Ministrinë e Financave për vitin 2023 dhe 2024
- Deklarata e Monitorimit të Cilësisë

Funksionimi i Komitetit të AB

Për periudhën Janar – Dhjetor **2023, nuk ka funksionuar** Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Për vitin 2024, janë mbajtur katër mbledhje në Ministri sipas rendit të ditës të miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit të Auditimit i bashkëlidhen vendimeve të marra nga Komiteti.

Komiteti ka hartuar dhe realizuar Programin Vjetor 2024 të punës, për shqyrtimin e raporteve periodike të njërive të auditimit të brendshëm, rekomandimeve të pranuar, raporteve të audituesve të jashtëm, monitorimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, analizimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit të brendshëm, shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga njëria e auditimit të brendshëm në MTM, dhënien e mendimit për planin vjetor dhe atë strategjik të Drejtorisë të auditimit të brendshëm para miratimit nga ministri. Komiteti ka monitoruar performancën e njërive të auditimit të brendshëm, zbatimin e planit, rezultatet e auditimit, zbatimin e rekomandimeve të dhëna dhe zbatimin e kodit etik nga audituesit e brendshëm.

Konstatim: Karta e Auditit nuk është përditësuar. Pavarësisht ndryshimeve në misionin e ish MTM-së, si dhe rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm në vitin 2024, Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është përditësuar në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Numri i misioneve të planifikuara dhe të realizuara

Nr	Emërtimi	Viti 2024		Devijimi	
		Plan/nr	Realizim/nr	+/-	
1	Auditime të kombinuara (Plan Fillestar, ndryshime miratuar nga Ministri)	7	7		
2	Auditime të përputhshmërisë	1	1		
3	Angazhime me kërkesë të Ministrisë		3	+3	
	Totali	8	11	+3	

Nga analiza e misioneve në vitin 2024, *rezulton se* nga 11 subjekte të parashikuara për t'u audituar (8 subjekte Plan fillestar, 3 subjekte shtuar me miratim nga Ministri), **realizuar 11 subjekte**.

Nga Ministri u miratua ndryshimi i shtesës së 3 subjekteve, pasi drejtorja u plotësua edhe me 2 specialistë auditues, ka patur shtim të numrit të audituesve (emërim në detyrë) në Janar 2024. Gjithashtu, ka patur subjekte që **auditohen për herë të parë** nga Drejtoria e Auditimit në MTM, 2 (dy) drejtori në MTM.

Auditimet janë realizuar sipas misioneve të planifikuara.

Raportimi i 1 (një) subjekti Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve, nuk ka përfunduar brenda vitit 2024 pasi është mbyllur puna në terren në dhjetor 2024.

Drejtorja e Auditimit **nuk ka funksionuar me strukturë të plotë** gjatë vitit 2024, me 1 specialist audit më pak, procedurë e papërfunduar në DAP.

Numri i misioneve të planifikuara dhe të realizuara

Nr	Emërtimi	Viti 2023		Devijimi	
		Plan/nr	Realizim/nr		
1	Auditime të kombinuara (Plan Fillestar, ndryshime miratuar nga Ministri)	10-5	5		
2	Auditime të përputhshmërisë	1	1		
3	Angazhime me kërkesë të Ministrisë	0	0		
	Totali	6	6	0	0

Nga analiza e misioneve në vitin 2023, *rezulton se* nga 6 subjekte të parashikuara për t'u audituar (11 Plan fillestar 5 subjekte hequr/ndryshuar me miratim nga Ministri), realizuar 6 subjekte.

Nga Ministri u miratua heqja/ndryshimi i 5 subjekteve, pasi u audituan nga KLSH në vitin 2023 dhe ka patur pakësim të numrit të audituesve (largim dhe dalje në pension).

Nga Drejtoria e Auditimit ka patur subjekte që **auditohen për herë të parë**.

Nuk ka përfunduar brenda vitit 2023 raportimi i 2 subjekteve, Administrata e Zonave të Mbrojtura Vlorë dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Fier, puna në terren ka përfunduar më janar 2024, mbetur pa u audituar 5 subjekte të planifikuara, pasi janë audituar nga KLSH si dhe plani i auditimeve **ka qënë për strukturë të plotë**, ndërkohë Drejtoria e Auditimit **nuk ka funksionuar me strukturë të plotë** gjatë vitit 2023, 10 muaj me 2 specialistë auditë dhe 3 muaj vetëm me 1 specialist audit.

Probleme të konstatuara nga Drejtoria AB .

Për vitin 2023

-Ka patur funksionim jo të plotë të strukturës si rezultat i vakancave të krijuara, 10 muaj për 3 specialistë auditë dhe 2 muaj për 2 specialist audit.

-Nuk ka funksionuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm pas mbarimit të mandatit të tij në Janar 2021.

Për vitin 2024

- Ka patur funksionim jo të plotë të strukturës si rezultat i vakancës së krijuar, 12 muaj për 1 specialist audit.

- Ndryshimi i objektivave dhe prioriteteve strategjike.

Rekomandimet e dhëna sipas viteve dhe sistemeve të audituara

Për përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive janë dhënë rekomandime:

Për vitin 2023 janë dhënë gjithsej 40 rekomandime.

Sipas prioritetit rekomandimet e dhëna janë:

- për përmirësim kuadri ligjor 1 rekomandim
- për përmirësimin e sistemeve 15 rekomandime
- për masa organizative 24 rekomandime
- për arkëtime 8 rekomandime

Sipas sistemeve rekomandimet e dhëna janë:

- në sistemin e prokurimeve 3 rekomandime
 - në zbatimin e kontratave 11 rekomandime
 - në procedurat inspektuese 5 rekomandime
 - në administrimin e pronës 14 rekomandime
 - në procedurat e qiradhënies 8 rekomandime
 - në menaxhim burime njerëzore 5 rekomandime
 - në administrimin e gjobave 2 rekomandime
- 48 rekomandime**

Viti 2023. Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Gjetjet i referohen parregullsive, shkeljeve dhe mangësive në të gjitha fushat e audituara si: auditimin e sistemeve, të përputhshmërisë, auditimin financiar dhe të performancës, si vijon:

- Sistemi i Prokurimeve, Blerjeve, Investimeve 5 raste në 1 subjekt
- Sistemi i Pagesave, shpërblime, trajtime, komisione 1 rast në 1 subjekt
- Sistemi i Administrimit të pronës 11 raste në 5 subjekte
- Sistemi i qiradhënies 13 raste në 4 subjekte
- Sistemi i legalizimeve 1 rast në 1 subjekt
- Sisteme të tjera 9 raste në 5 subjekte

Sipas nivelit të riskut, gjetjet janë:

Gjithsej	i ulët	Mesëm	Lartë
40	3	22	15

- **Gjithsej 40 raste në 5 subjekte**

Për vitin 2024 janë dhënë gjithsej 63 rekomandime

Sipas prioritetit rekomandimet e dhëna janë:

- për përmirësim kuadri ligjor 3 rekomandime
- për përmirësimin e sistemeve 23 rekomandime
- për masa organizative 27 rekomandime
- për arkëtime 9 rekomandime
- të tjera 1 rekomandim

63 rekomandime

Sipas sistemeve rekomandimet e dhëna janë:

- në sistemin e prokurimeve 14 rekomandime
- në zbatimin e kontratave 11 rekomandime
- në administrimin e pronës 12 rekomandime
- në procedurat e qiradhënies 14 rekomandime
- në administrimin e gjobave 2 rekomandime
- në sisteme specifike sipas subjektit 10 rekomandime

63 rekomandime

Viti 2024, Gjetjet kryesore janë për 10 subjekte (pasi 1 subjekt është zbatim rekomandimesh), sipas sistemeve gjetjet janë:

- Në sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve	14 gjetje
- Në sistemin e pagesave	11 gjetje
- Në fondet e sigurimeve, përkujdesje sociale	1 gjetje
- Në sistemin e Administrimit të pronës dhe pasurisë	21 gjetje
- Në sistemin e qiradhënies	15 gjetje
- Në sisteme të tjera	30 gjetje
Gjithsej	92 gjetje

Gjetje me dëm ekonomik janë në 1 (një) subjekt:

Agjencia Rajonale e Mjedisit në vlerën 5,967 mijë lekë (ndërhyrje të paligjshme të konstatuara dhe evidentuara, të referuara pranë Prokurorisë)

Gjetjet sipas nivelit të riskut

Gjithsej	i ulët	Mesëm	Lartë
92	31	42	19

Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi mbi auditin e brendshëm rezultoi:

- *Karta e Auditit është e papërditësuar në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar*
- *Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dhënë rekomandim për përmirësimin e kartës së auditimit.*

Ndaj Projekt Raportit të Auditimit, është bërë observacionin nga subjekti Ministria e Mjedisit, pjesë e ish Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 1869 prot., datë 23.12.2025 nga znj.I.B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, prot në KLSH me nr. 399/16 datë 29.12.2025 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. “...paraqesim observacionet tona mbi konstatimet/rekomandimet e paraqitura... lidhur me fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.. Sa i takon finalizimit të Manualit të Procedurave për Ministrinë e Mjedisit .. ka filluar rishikimi dhe përditësimi i hartës së proceseve të punës ... grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 671, datë 18.12.20025 ka nisur menjëherë këtë proces rishikimi... ”.

2. “Rekomandimi 3.1. ... ky rekomandim do të merret në konsideratë në vijimësi për procedurat e shpalljes së pozicioneve përkatëse në DAP, apo proceset vijuese të ristrukturimit...”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e mësipërme, subjekti ka pranuar konstatimet e KLSH dhe ka filluar procedurat për zbatim, të cilat do të auditohen në vijimësi në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

2.2 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.

-Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Aparatit të Ministrisë dhe nëpërmjet saj institucioneve të varësisë i çelen nga buxheti i shtetit për çdo vit fonde buxhetore.

MTM ka në përbërje të buxhetit të saj pesë programe:

-Programin nr. 1110 “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”;

-Programin nr. 5320 “Mbrojtja e Mjedisit”;

-Programin nr. 4260 “Administrimi i Pyjeve”;

-Programin nr. 4760 “Zhvillimi i turizmit”;

-Programi nr. 06220 “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” (AKEM ka filluar aktivitetin në muajin shtator 2024).

Në varësi të MTM për vitin 2024 janë gjithsej 14 (katërmbëdhjetë) njësi dhe konkretisht:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe 4 Agjencitë Rajonale;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe 4 Agjencitë Rajonale;
- Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
- Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve.

Financimi i MTM-së është kryer si më poshtë:

-Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602, 606 dhe 230-231) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;

-Për shpenzimet për investime (llog. 230 & llog. 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe financim i huaj.

Vendimarrjet mbi procedurat e miratimit të PBA-së, projektbuxhetit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit janë kryer nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik në përputhje me pikën 8/b, nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Për planifikimin e PBA-së dhe projektbuxhetit të vitit 2023 konstatohet të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik sipas Urdhrit të Ministrit nr. 146 datë 15.04.2022 “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore” janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të programeve që administrojnë MTM.

Nga auditimi rezultoi se nuk janë mbajtur procesverbale lidhur me takimet e kryera nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka gjurmë auditimi për të verifikuar nëse ky grup është mbledhur 4 herë, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, pika 2.1.4 ku citohet “GMS-ja duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit... Vendimet e GMS-së duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike...”

Sipas nenit 12, pika 2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar “Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së: a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike”.

Me urdhrin nr. 239 datë 05.08.2022 është ngritur grupi i EMP për fazën teknike. Nëpunësi zbatues ka përgatitur dokumentin përfundimtar të buxhetit konform Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 12, pika 2/a dhe 3/a. Ky dokument është miratuar nga Nëpunësi autorizues dhe është dërguar në MF konform pikës 4/d, nenit 9 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, të ndryshuar.

Nga auditimi i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi u konstatua se është hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit si dhe aktivitetet e programit, ku çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore.

-U audituan kërkesat buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Turizmit e cila ka dërguar kërkesat për fazën e I-rë të PBA-së 2023-2025 me shkresën nr. 263 prot., datë 21.04.2022 dhe për fazën e dytë nuk ka dërguar kërkesa buxhetore, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MF nr. 9 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”. Për veprimet ose mosveprimet e mësipërme, mban përgjegjësi nëpunësi zbatues i Agjencisë Kombëtare të Turizmit z. E. I. dhe nëpunësi autorizues znj. K. F.

-Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka dërguar kërkesat buxhetore për PBA 2023-2025 faza e I-rë

me shkresën nr. 349 prot., datë 04.05.2022 në vlerë totale 62,800 mijë lekë. Gjithashtu me shkresën nr. 783 prot., datë 27.08.2022 ka dërguar kërkesat buxhetore për PBA 2023-2025 faza II-të në vlerën 63,000 mijë lekë.

Planifikimi buxhetor i periudhës PBA 2023-2025

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe UMF nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, MTM ka dërguar kërkesat për “Planifikimin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2023-2025”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve.

Me shkresën nr. 3922/1 prot., datë 29.04.2022, ish MTM ka dërguar në MFE “Raporti i PBA-së 2023-

2025 Faza e I-rë” dhe me shkresën nr. 6526/1 prot., datë 01.09.2022 “Raporti i PBA-së 2023-2025 Faza II-të” janë dërguar kërkesat buxhetore të fazave strategjike dhe teknike, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar.

Planifikimi buxhetor sipas PBA 2023-2025, faza teknike krahasuar me buxhetin e vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 1 “Kërkesat buxhetore sipas PBA 2023-2025 për fazën teknike për ish MTM”

000/lekë

Planifikimi	Buxheti	PBA 2023-2025 Faza teknike			
		2022	2023	2024	2025
Artikujt buxhetorë					
Paga (600-601)	797,790	801,090	801,090	801,090	801,090
Korrente të Tjera (602-606)	570,930	566,910	411,910	422,910	422,910
Kapitale (230-232) Të Brendshme	580,740	507,100	507,100	357,100	357,100
Kapitale (230-232) Të Huaja	490,000	390,000	390,000	390,000	390,000
Totali	2,439,460	2,265,100	2,121,100	1,971,100	1,971,100

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej 2,265,100 mijë lekë për vitin 2023 në PBA është më e ulët krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2022 me një rënie në vlerën 174,360 mijë lekë ose në masën 7%.

-Artikujt buxhetorë 600 dhe 601 “Paga dhe sigurime” janë planifikuar në bazë të strukturës së miratuar duke bërë shpërndarjen e këtij fondi sipas programeve përkatëse në bazë të VKM-së nr.187/2017 “Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve...” dhe VKM-në nr. 202, datë 15.03.2017 për punonjësit me status civil dhe Kod pune dhe urdhrave të Kryeministrit për strukturën e MTM dhe njësisë të varësisë. Për fondin e pagave llogarinë 600 janë kërkuar për MTM-në, 8 milionë lekë në programin “Administrimi i pyjeve” pasi në këtë llogari nuk ka përpunime organika me buxhetin e çelur.

-Në planifikimin buxhetor për llogarinë 602 “Mallra e shërbime” në shumën totale 566,910 mijë lekë, janë planifikuar shpenzimet për: telefon, shërbim postar duke marrë parasysh ndryshimin e tarifave dhe rritjes së detyrimeve ndaj Shërbimit Postar, internetit; për shpenzime për udhëtime e dieta pasi puna e Ministrisë në vitet 2023-2025 planifikohet të përqendrohet akoma më shumë në kontrollin e mjedisit dhe pyjeve; rritjen e nevojave për karburant si rezultat i shtimit të numrit të kontrolleve dhe lëvizjeve në terren; rritjen e nevojave për energji elektrike si rezultat i rritjes së tarifave ndaj KESH, si dhe furnizimit me pelet për nevojat e ngrohjes; për rritjen e numrit të kontrolleve nga policia pyjore dhe strukturave të mbrojtjes nga zjarri në kushtet e thatësirës sezonale ciklike; për rritjen e numrit të pajisjeve dhe gatishmërisë për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota; për pagesa sipas situacioneve për shuarjen e zjarreve; për pagesa për vendimet gjyqësore të formës së prerë.

-Planifikimi për llogarinë 604 “Transferta korrente të brendshme” është bazuar në monitorimet

e projekteve prioritare të ministrisë si: monitorimi i ujrave sipërfaqësore, i cilësisë së ajrit urban, i zhurmave urbane në qytetet kryesore të Shqipërisë;

-Planifikimi për llogarinë 605 “Transferime korrente me jashtë” është bazuar në kontributet në konventat, protokollet dhe organizma të tjerë në të cilat MTM është palë;

-Planifikimi për llogarinë 606 “Transferime korrente të brendshme” është bazuar në kuotat e kompensimit të karburantit dhe telefonave, rastet e fatkeqësive dhe daljeve në pension për stafin e ish MTM.

Planifikimi për shpenzime kapitale

Kërkesat e ish MTM-së në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 897,100 mijë lekë, nga të cilat 57% ose 507,100 mijë lekë janë investime me financim të brendshëm dhe 43% ose 390,000 mijë lekë janë kërkesat për investime me financim të huaj.

Ndër investimet e planifikuara me financim të brendshëm pjesën kryesore e zënë investimet në programin “Zhvillimi i turizmit” në shumën 315,500 mijë lekë ose 62% të investimeve me financim të brendshëm. Shpenzimet kapitale të këtij programi sipas PBA 2023-2025 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 2 “Kërkesat për investime me financim të brendshëm, programi Zhvillimi i Turizmit” 000/lekë

Zhvillimi i turizmit	Buxheti	PBA 2023 – 2025 Faza teknike		
	2022	2023	2024	2025
Fondi për zhvillimin e turizmit	75,760	78,000	78,000	78,000
Mbështetje financiare BERZH	178,740	210,500	210,500	77,500
Përmirësimi i infrastrukturës dhe kthimi i parkut natyror “Syri i kaltër” në destinacion ekoturistik	50,000	-	-	-
Hartimi dhe zbatimi i projektit “Ujërat termale të Bënjës monument kulture brenda Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës Dangelli”	-	24,000	27,000	10,000
Due Mari TVSH	9,000	3,000	-	-
Totali	315,500	315,500	315,500	165,500

Burimi: ISH MTM , përpunuar nga grupi i auditimit

Çeljet e buxhetit për vitet 2023-2025 janë dërguar nga MFE me shkresën nr. 23774/44 prot., datë 20.01.2023 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2023-2025” sipas së cilës plani fillestar i buxhetit për vitin 2023 rezulton në shumën 1,493,500 mijë lekë. Miratimi i buxhetit për shpenzimet kapitale është dërguar me shkresën nr. 2919/1 prot., datë 28.02.2023 “Dërgohet detajimi i buxhetit 2023-2025 për shpenzimet kapitale”, sipas të cilit plani fillestar buxhetor për vitin 2023 rezulton në shumën 809,100 mijë lekë. Si dhe me shkresën nr. 3107/1 prot., datë 21.02.2023 “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023”, vlera në total për ISH MTM rezulton 1,900 mijë lekë.

Buxheti fillestar, transferimet dhe monitorimi i buxhetit për vitin 2023

Tabela nr. 3 “Planifikimin, rishikimi i buxhetit të MTM dhe realizimi faktik për vitin 2023” 000/ lekë

Programi	Fakti 2022	PBA 2023-2025 F.1	PBA 2023-2025 F.2	Buxheti fillestar 2023	Buxheti i rishikuar 2023	Ndryshimi i buxhetit R-F 2023	Fakti 2023	Realizimi %
Planifikim, Menaxhim Administrim	213,776	199,000	199,000	210,590	226,560	15,970	211,753	93%
Mbrojtja e mjedisit	838,082	933,000	933,000	970,900	952,435	-18,465	548,075	58%
Administrimi pyjeve	354,912	433,600	433,600	526,050	473,122	-52,928	454,487	96%
Zhvillimi i turizmit	699,438	699,500	699,500	595,060	976,903	381,843	948,521	96%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	66,812						18,836	
Totali	2,173,020	2,265,100	2,265,100	2,302,600	2,629,020	326,420	2,181,672	82%

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2023, janë planifikuar në PBA 2023-2025 kërkesa buxhetore në shumën prej 2,265,100 mijë lekë, buxheti fillestar i akorduar MTM rezulton në shumën 2,302,600 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2023, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 2,629,020 mijë lekë, pra me 326,420 mijë lekë ose 14% më shumë se buxheti fillestar.

Në këndvështrimin e programeve buxhetore për të cilat MTM realizon shpenzime konstatohet se nga rishikimi buxhetor rritjen më të lartë e ka patur programi “Zhvillimi i turizmit” në shumën 381,843 mijë lekë dhe rënien më të lartë programi “Administrimi i pyjeve” në shumën 52,928 mijë lekë.

Nga auditimi u konstatua se përgjatë vitit 2023 janë kryer gjithsej 20 transferime fondesh, nga të cilat:

2 rialokime si rezultat i Akteve Normative nr. 5 datë 18.10.2023 dhe AN nr. 06, datë 14.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2022 ‘Për buxhetin e vitit 2023’, 4 VKM të veçanta, 1 udhëzim vjetor i buxhetit lidhur me fondin e veçantë dhe 13 rialokimeve të brendshme. Ndryshimet përfaqësojnë ndryshimet e planit të buxhetit në zbatim të VKM-së nr. 293, datë 17.05.2023 “*Rishpërndarje fondesh për buxhetin e miratuar 2023*”; VKM-së nr. 795, datë 28.12.2023 “*Për shpërblimin e punonjësve të Qeverisjes Qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të Acquis, në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian*”; VKM-së nr. 834, datë 28.12.2023 “*Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2021 të Këshillit të Ministrave ‘Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë’, të ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, të miratuar për disa institucione*”.

Investimet viti 2023

Referuar planit dhe realizimit të investimeve me financim të brendshëm për vitin 2023 janë përmbledhur si vijon:

Tabela nr. 4 “Buxheti fillestar dhe realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2023 sipas programeve”

000 lekë

Emërtimi i Institucionit	Kodi i projektit	Emërtimi i Projektit	Çelje buxhet 2023	Plan buxhet përf 2023	Realizim 2023	Në %
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit			419,100	592,800	557,543	94.1%
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			3,000	3,000	2,201	73.4%
Aparati i ISH MTM	18AV402	Pajisje TIK	2,000	2,000	1,422	71.1%
Aparati i ISH MTM	M260001	Orendi pajisje	1,000	1,000	779	77.9%
Administrimi i Pyjeve			158,600	47,300	45,410	96.0%
Aparati i ISH MTM	18BE611	Zbatim projekti "Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza	102,900			
AKZM	18BE613	Studim mbi rëndësinë e Eko Sistemeve të Lagunave	17,000	17,000	16,580	97.5%
AKZM	18BE614	Hartim Projekti - "Shtigjet ne Rrjetin e Zonave Mbrojtura"	16,350	16,350	15,720,000	96.1%
AKZM	18BE615	Hartim Projekti "Qendra Multifunkionale në Luginën e Vjosës"	20,000	11,600	11,193	96.5%
AKZM	18BE604	Blerje Fidane	1,350	1,350	1,350	100.0%
AKZM	18BE502	Jica	1,000	1,000	568	56.8%
Zhvillimi i Turizmit			137,500	414,500	413,665	99.8%
Aparati i ISH MTM	18BE902	Mbështetje Financiare Projekti BERZH	110,500	410,900	410,500	99.9%
Aparati i ISH MTM	18BE908	Ujrat termale të Benjës-Monument Natyre	24,000			
Aparati i ISH MTM	18CH401	Due Mari	3,000	3,000	2,593	86.4%
AKT	M260001	Orendi pajisje (Blerje kondicioner)		600	572	95.3%

Programi për Mbrojtjen e Mjedisit			120,000	128,000	96,266	75.2%
Aparati i ISH MTM	18BF301	Mbyllja, rehabilitim i mbetjeje urbane nga vendepozitime ekzistuese	50,160	50,160	50,109	99.9%
Aparati i ISH MTM	18BF502	Rikonstruksion i godinës AKM	24,000	24,000	22,794	95.0%
Aparati i ISH MTM	18BG704	Ekonomia qarkulluese IPA 3	1,377	1,377	-	0.0%
Aparati i ISH MTM	18BG705	Fire Prep Kosto lokale	5,000	5,000	-	0.0%
Aparati i ISH MTM	18BG705	Fire Prep TVSH	1,000	300	-	0.0%
Aparati i ISH MTM	18BH005	ËBC-RRI-NET (Horizont 2020)	200	200	-	0.0%
Aparati i ISH MTM	18BH101	Sistemi i ngritur për parandalimin e mbetjeje detare	-	700	609	87.0%
Aparati i ISH MTM	18BH202	Menaxhimi i kimikateve dhe mbetjeje farmaceutike në Shqipëri (Str.Sound.Chem)	700	700	-	0.0%
Aparati i ISH MTM	18BH301	Raporte performace të hartuara	7,488	7,488	301	4.0%
Aparati i ISH MTM	M260248	TVSH Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës		15,300	14,602	95.4%
Aparati i ISH MTM	M260379	TVSH Mbetjet- në kuader të ndryshimeve klimatike-GIZ	30,000	22,700	7,776	34.3%
Aparati i ISH MTM	M260401	Përshtatja me ndryshimet Klimaterike në fushën e menaxhimit ndërkufitar të riskut të përmbytjeve në Ballkanin perëndimor-GIZ	75	75	75	99.9%

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2023 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2023-2025, nga ku u evidentua:

Projekti M260001 “Blerje kondicioner” nuk ka qenë e planifikuar në PBA 2023-2025 është rialokuar fondi në vlerën 600 mijë lekë me shkresën nr. 13790/1 prot., datë 07.08.2023 sipas kërkesës së bërë nga Agjencia Kombëtare e Turizmit për blerje dhe montim kondicionerësh.

Projekti M260248 “TVSH Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës” nuk ka qenë i planifikuar në PBA 2023-2025, është rialokuar fond me shkresën nr. 11944/1 prot., datë 12.07.2023 të MFE dhe është shtuar në vlerën 7,300 mijë lekë në bazë të kërkesës nr. 1343/1 prot., datë 14.06.2023 të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për pagesën e TVSH-së për faturat e GFA Consulting Group në shumën totale 7,254 mijë lekë.

Projekti M260401 “Përshtatja me ndryshimet Klimaterike në fushën e menaxhimit ndërkufitar të riskut të përmbytjeve në Ballkanin perëndimor-GIZ” është çelur me shkresën e ligjit fillestar por nuk është e planifikuar në PBA 2023-2025, pasi kërkesat për rimbursimin e TVSH-së nga GIZ (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik) kanë ardhur pas datës së dërgimit të PBA 2023-2025, faza II. Ky projekt është i përfshirë në listën e investimeve dërguar në MFE me shkresën nr. 948 prot., datë 07.02.2023.

Me shkresën nr. 19139/49 prot., datë 02.11.2023 në zbatim të Aktit Normativ nr. 5 datë 18.10.2023 janë pakësuar projektet 18BE908 “Ujrat termale të Benjës-Monument Natyre” dhe GM26065 “TVSH Mbetjet-në kuadër të ndryshimeve klimatike-GIZ” në vlerat rreskive 23,400 mijë lekë dhe 10,000 mijë lekë.

Projekti 18BF502 “Rikonstruksioni i godinës AKM” është planifikuar në PBA 2023-2025 në vlerë totale 39,000 mijë lekë e ndarë respektivisht 25,000 mijë lekë për vitin 2023 dhe 14,000 mijë lekë për vitin 2024. Ky projekt është i lidhur me kontratën e prokurimit publik nr. 6615 datë 25.08.2023 për rikonstruksionin e godinës në vlerë totale 26,510 mijë lekë.

Lidhur me investimet me financim të huaj për të cilat MTM paguan TVSH, në disa raste evidentohet se këto projekte nuk janë të planifikuara në PBA, duke qenë se kërkesa për likuidimin e TVSH-së nga donatori ka ardhur pas afatit të mbylljes së PBA-së përkatëse, faza

II. Në këto raste nuk ka pasur koordinim dhe korrespondencë për të arritur në parashikimin e kostos së TVSH-së përpara përfundimit të afatit të planifikimit të PBA. Gjithashtu sipas udhëzimeve plotësuese të zbatimit të buxhetit sipas pikës 22, gërma d citohet: “Detyrimet për TVSh-në, Taksa Doganore ose bashkëfinancimet nga buxheti i shtetit për projektet me financim të huaj, do të financohen në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj planifikuar për vitin 2023. Financimi i projekteve me financim të huaj nuk duhet të tejkalojë tavanin e miratuar në ligjin e buxhetit për vitin 2023.”

Raporti i monitorimit dhe realizimi i treguesve buxhetorë

Raporti i monitorimit për vitin 2023 është dërguar në MFE me shkresën nr. 1576 prot., datë 28.02.2024 “Dërgohet raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” brenda afateve të përcaktuara në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar”, pika 270.

- Buxheti i planifikuar në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Adminstrim” është realizuar në masën 93% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Administrim i Pyjeve” është realizuar në masën 96% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Zhvillimi i Turizmit” është realizuar në masën 96% ndaj fondeve vjetore të planifikuara;
- Buxheti i planifikuar në programin “Mbrojtja e Mjedisit” është realizuar në masën 58% ndaj fondeve vjetore të planifikuara, nivel realizimi i ulët krahasuar me programet e tjera, si rezultat i nivelit të ulët të realizimit për projektet me financim të huaj.

Realizimi faktik i vitit 2023 për MTM rezulton në shumën 2,181,672 mijë lekë ose 83% kundrejt

buxhetit të rishikuar dhe 95% kundrejt buxhetit fillestar, përmbledhur në tabelën e mëposhtme sipas artikujve buxhetorë:

Tabela nr. 5 “Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 sipas artikujve buxhetorë” 000/lekë

Artikujt buxhetorë	Fakti	PBA 2023-2025 F.1	PBA 2023-2025 F.2	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Fakti	% e realizimit
	2022			2023	2023		
Paga (600)	588,189	687,700	687,700	727,790	746,607	739,462	99
Sigurime (601)	98,213	113,390	113,390	120,800	124,703	121,467	97.4
Mallra e shërbime (602)	478,174	535,410	535,238	535,238	622,738	564,933	90.7
Transferta korrente të brendshme (604)	3,557	10,000	10,000	88,000	128,600	124,596	96.9
Transferta korrente të huaja (605)	16,975	20,000	20,000	20,000	20,000	10,124	50.6
Transferta për buxhet fam e individë (606)	15,428	1,500	1,672	1,672	3,572	1,930	54
Kapitale (230-232) Të Brendshme	534,195	507,100	507,100	419,100	592,800	557,543	94
Kapitale (230-232) Të Huaja	371,478	390,000	390,000	390,000	390,000	42,782	11
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	66,812					18,836	
Totali	2,173,020	2,265,100	2,265,100	2,302,600	2,629,020	2,181,672	83

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Evidentohet diferencë ndërmjet vlerës së dhënë nga subjekti dhe vlerës së raportuar në raportin e monitorimit të buxhetit sa i takon nivelit të realizimit të shpenzime me financim të huaj në vlerën 7,382 mijë lekë. Për këtë diferencë subjekti ka spjegimin si vijon: në raport monitorimi është vendosur vlera sipas raportimit të njësisë së jashtme që ndjek zbatimin e Projekteve, e cila më pas regjistrohet në SIFQ nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pranë MF-së. Komunikimi për sistemim me MF është me shkresën në 6 mars, ndërsa raporti i monitorimit

në zbatim të udhëzimit dërgohet deri më datë 28 shkurt, ndaj ne raport monitorimi është reflektuar vlera sipas raportimit, ndërsa anekset pasqyrojnë vlerat e regjistruara në SIFQ.

-Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600-601) për vitin 2023 janë realizuar në masën 99% kundrejt fondeve totale të planifikuara;

- Shpenzimet korrente (602-606) për vitin 2023 janë realizuar në masën 90% kundrejt fondeve totale të planifikuara;

-Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231) për vitin 2023 janë realizuar në masën 94% kundrejt fondeve totale të planifikuara.

-Shpenzimet kapitale me financim të huaj (230-231) për vitin 2023 janë realizuar në masën 11% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara, për shkak se dy nga projektet me buxhetin më të lartë të planifikuar "Ekonomia qarkulluese IPA 3" me vlerë 182,000 mijë lekë dhe projekti ii. "Clean and Resilient Environment for Blu Sea Project CARE4BLUESEA" me vlerë 100,000 mijë lekë kanë qenë në fazën fillestare (inception) dhe nuk kanë patur shpenzime për t'u raportuar.

- Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit (Kap. 6) për vitin 2023 paraqiten në vlerën 18,836 mijë lekë, ku përfshihen shpenzimet e realizuara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të VKM-së nr. 1156 datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat që paguhen nga zonat e mbrojtura, të masës dhe kriterëve të përdorimit të tyre" si edhe grantet e UNEP në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në zbatim të VKM-së nr. 432, datë 28.06.2006 "*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore*" Ministria mbledh të ardhura për llogari të Thesarit të Shtetit për dhënien e lejeve mjedisore, licencave, autorizimeve, tarifave vjetore, guida turistike, transit dhe eksport mbetje jo të rrezikshme. Në ndryshim nga Aparati dhe institucionet e tjera të varësisë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), i përdor të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e miratuara për zonat e mbrojtura.

Viti 2024

Për planifikimin e PBA-së 2024-2026 dhe projekt buxhetin e vitit 2024 konstatohet të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik sipas Urdhrit të Ministrit nr. 130 datë 20.04.2023 me shkresën nr. 2621 prot., datë 20.04.2023.

Nga auditimi rezultoi se nuk janë mbajtur procesverbale lidhur me takimet e kryera nga Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe nuk ka gjurmë auditimi për të verifikuar nëse ky grup është mbledhur 4 herë, në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 21 datë 25.10.2016 "*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*", pika 2.1.4 ku citohet "*GMS-ja duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit... Vendimet e GMS-së duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike...*"

Me shkresën nr. 2675 prot., datë 25.04.2023, ka dalë urdhri i Ministrit nr. 136 datë 25.04.2023 "Për ngritjen e Ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore" ku janë caktuar drejtuesit dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit të programeve që administrojnë MTM. Ky urdhër është ndryshuar me urdhrat nr. 259 datë 22.08.2023 dhe 406 datë 22.12.2023 me ndryshimet përkatëse.

Planifikimi buxhetor i periudhës 2024-2026

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe UMF nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", në zbatim të VKM-së nr. 436 datë 19.07.2023 "*Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026*" ish MTM ka dërguar kërkesat për "*Planifikimin Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2024-2026*", mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve.

U audituan kërkesat buxhetore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e cila ka dërguar kërkesat

për fazën e I-rë të PBA-së 2024-2026 me shkresën nr. 3346 prot., datë 02.05.2023 në vlerën 405,570 mijë lekë dhe për fazën II-të ka dërguar kërkesa buxhetore me shkresën nr. 6759 datë 28.08.2023 në vlerën 432,339 mijë lekë.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ka dërguar kërkesat buxhetore për fazën e I-rë sipas formateve të kërkuara, veprim ky jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, shtojca 3, pika 25 ku cihet “Koordinatori i Grupit për Menaxhimin Strategjik nëpërmjet nëpunësit zbatues, në rolin e sekretarit, përgatit materialet për miratim të titullari i Njësisë së Qeverisjes së Përgjithshme dhe më pas kërkesat buxhetore të miratuara nga titullari dërgohen në ministrinë përgjegjëse për financat.”

Evidentohet se me shkresën nr. 1232 prot., datë 03.04.2023, ka dërguar kërkesë për planifikim TVSH për projektin “Rezervati Ndërkufitar i Biosferës së Prespës” në vlerën 8,030 mijë lekë për vitin 2024. Bashkëngjitur shkresës ndodhet relacioni shpjegues mbi shtesën e fondeve buxhetore të kërkuara.

Ndërsa me shkresën nr. 2921 prot., datë 28.08.2023 ka dërguar kërkesat buxhetore për PBA 2024-2026 faza II-të në vlerën 1,372,909 mijë lekë, brenda afateve të përcaktuara në udhëzim.

Me shkresën nr. 2742/1, prot., datë 28.04.2023, MTM dërgon në MFE “Raporti i PBA-së 2024-2026 Faza e I-rë” dhe me shkresën nr. 5350/1, prot., datë 30.08.2023 “Raporti i PBA-së 2024-2026 Faza e II-të” janë dërguar kërkesat buxhetore të të dyja fazave. Planifikimi buxhetor sipas PBA 2024-2026, faza teknike krahasuar me buxhetin e vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 6 “Planifikimi buxhetor afatmesëm 2024-2026 faza teknike” 000/lekë

Planifikimi	Buxheti fillestar	PBA 2023-2025 Faza teknike			
		2023	2024	2025	2026
Artikujt buxhetorë					
Paga (600-601)	848,590	848,590	848,590	848,590	848,590
Korente të tjera (602-606)	644,910	410,410	380,410	379,610	379,610
Kapitale (230-232) të Brendshme	419,100	860,847	741,347	741,347	741,347
Kapitale (230-232) të Huaja	390,000	890,000	690,000	690,000	690,000
Jashtë-buxhetore					
Totali	2,302,600	3,009,847	2,660,347	2,659,547	2,659,547

Burimi: ISH MTM, Përpunuar nga grupi i auditimit

-Planifikimi buxhetor faza e dytë paraqitet për llogarinë 600 dhe 601 “Paga dhe sigurime” në shumën 848,590 mijë lekë dhe është kryer në zbatim të tavanit të miratuar dhe kategorive të punonjësve në zbatim të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar për punonjësit me status të nëpunësit civil dhe Kod pune, si dhe Urdhrave të Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” dhe Urdhrave që miratojnë strukturat e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, për të cilat shpërndarja e fondit të pagave është bërë në programet përkatëse buxhetore. Në vijim të ndryshimeve të legjislacionit të pagave sipas vendimeve të sipërcituara si edhe për shkak të mos rritjes së tavanëve buxhetore në fazën II të PBA-së, ministria ka pasur pamjaftueshmeri fondesh për artikujt 600 dhe 601. Si rrjedhojë ka pasur kërkesa shtesë, përkatësisht:

-Për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” fond shtesë 50,150 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe 8,800 mijë lekë në llogarinë ekonomike 601;

-Për programin “Mbrojtja e Mjedisit” fond shtesë 143,500 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe 24,500 mijë lekë në llogarinë ekonomike 601;
 -Për programin “Administrim i Pyjeve” fond shtesë 89,100 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe 19,935 mijë lekë në llogarinë ekonomike 601;
 -Për programin “Zhvillim i Turizmit” fond shtesë 44,600 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe 7,570 mijë lekë në llogarinë ekonomike 601;
 -Për programin “Menaxhim i Mbetjeve” fond shtesë 41,000 mijë lekë për llogarinë ekonomike 600 dhe 6,850 mijë lekë në llogarinë ekonomike 601;

-Në planifikimin buxhetor për llogarinë 602 “Mallra e shërbime” janë planifikuar shpenzimet për: energji elektrike, ujë, telefon, shërbim postar, interneti, shërbime gjelbërimi, kancelari, materiale pastrimi, shpenzime transporti (karburant, sigurimi i mjeteve të transportit, shërbime udhëtime të brendshme e të jashtme, vendime gjyqësore etj. Në relacionin shoqërues të kësaj PBA konstatohet kërkesa shtesë për programin “Administrimi i Pyjeve” në vlerën 470,650 mijë lekë për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për programin “Zhvillimi i Turizmit” vlera 7,350 mijë lekë për një ish punonjës të AKB-së. Kërkesa shtesë në artikullin 602 në vlerën 300,000 mijë lekë për pastrimin e bregdetit.

-Planifikimi për llogarinë 604 “Transferita korrente të brendshme” është bazuar në monitorimet e projekteve prioritare të ministrisë si: monitorimi i ujrave sipërfaqësore, i cilësisë së ajrit urban, i zhyrmave urbane në qytetet kryesore të Shqipërisë. Kërkesa shtesë fondi 150,000 mijë lekë për realizimin e kalendarit turistik; për organizimin e panairit IT të turizmit fond 350,000 mijë lekë për vitin 2024 dhe 100,000 mijë lekë për vitin 2025.

-Planifikimi për llogarinë 605 “Transferime korrente me jashtë” është bazuar në kontributet në konventat, protokollet dhe organizma të tjerë në të cilat MTM është palë, për llogarinë 606 “Transferime korrente të brendshme” është bazuar në kuotat e kompensimit të karburantit dhe telefonave, rastet e fatkeqësive dhe daljeve në pension për stafin e MTM. Projektet me investim të brendshëm të planifikuar nga MTM sipas programeve janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

		<i>000/lekë</i>
Programi	Shpenzime kapitale me investim të brendshëm	Vlerë plan
Planifikim, Administrim dhe Menaxhim	Orendi dhe pajisje	1,000
Planifikim, Administrim dhe Menaxhim	Pajisje TIK	2,000
Mbrojtja e Mjedisit	Rikonstruksion i godines AKM	15,000
Mbrojtja e Mjedisit	Ekonomia qarkulluese IPA 3	33,688
Mbrojtja e Mjedisit	EBC-RRI-NET (Horizon 2020)	50
Mbrojtja e Mjedisit	Menaxhimi i kirmikateve dhe mbetjeve farmaceutike në Shqiperi (Str.Sound.Chem)	1,000
Mbrojtja e Mjedisit	Raporte performance të hartuara	3,862
Mbrojtja e Mjedisit	Sistemi i ngritur për parandalimin e mbetjeve detare	4,900
Mbrojtja e Mjedisit	Projekti i zonës biosferike të parkut kombëtar të Prespës	31,500
Administrimi i Pyjeve	Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore-EKO-PARK ULZA	200,600
Zhvillimi i Turizmit	Mbështetje Financiare Projekti BERZH	227,600
Zhvillimi i Turizmit	Blerje automjeti	9,900
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	Fond i Ngrirë	329,747
Totali		860,847

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Kërkesat e ish MTM në lidhje me shpenzimet kapitale për vitin 2024 kanë vlerën 1,750,847 mijë lekë, nga të cilat 49% ose 860,847 mijë lekë janë investime me financim të brendshëm dhe 51% ose 890,000 mijë lekë janë kërkesat për investime me financim të huaj.

Ndër investimet e planifikuara me financim të brendshëm pjesën kryesore e zënë investimet në programin “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” në shumën 329,747 mijë lekë ose 38.3% të investimeve me financim të brendshëm.

Projektet me financim të jashtëm përfshihen në programet “Mbrojtja e Mjedisit” dhe “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”. Këto projekte kanë donatorë të huaj si BE, Banka Botërore, KFÛ, SIDS, GIZ, UNDP, UNIDO dhe GEF. Projekte zbatohen nga njësitë e projekteve në

zyrat e donatorëve. Kërkesat buxhetore për to për zërat si financim i huaj, kosto lokale dhe TVSh janë përfshirë në PBA ardhur nga zyrat e zbatimit të projekteve dhe bashkërenduan me të dhënat e financimit nga buxheti për planifikimin buxhetor të MTM.

Çeljet e buxhetit për vitet 2024-2024 janë dërguar nga MFE me shkresën nr. 496/1 prot., datë 29.01.2024 “Dërgohet detajimi pjesor i shpenzimeve korrente për vitet 2024-2026” sipas së cilës plani fillestar rezulton në shumën 2,032,260 mijë lekë.

Miratimi i buxhetit për shpenzimet kapitale është dërguar me shkresën nr. 1404/1 prot., datë 08.03.2024 “Dërgohet detajimi pjesor i buxhetit 2024-2026 për shpenzimet kapitale”, sipas të cilit plani fillestar rezulton në shumën 921,000 mijë lekë.

Miratim i Ministrisë së Financave nr. 11696/77, datë 17.09.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 3, datë 28.08.2024 për shpenzimet korrente”, shtuar fonde në llogarinë 602 në vlerën 100,000 mijë lekë, pakësuar llogaria 600 në vlerën 28,000 mijë lekë dhe efekti total rezulton shtesë në vlerën 72,000 mijë lekë. Miratim i Ministrisë së Financave nr. 11696/127, datë 24.09.2024 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.3, datë 28.08.2024 për shpenzimet kapitale”, shtuar fonde në shpenzimet kapitale në kapitullin 01 dhe 03, në vlerën 199,070 mijë lekë, pakësuar fonde në shpenzimet kapitale në kapitullin 01 në vlerën 193,502 mijë lekë dhe efekti total rezulton shtesë në vlerën 5,568 mijë lekë.

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

Në zbatim të VKM-së nr. 132 datë 06.03.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 94 datë 12.6.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, u krijua Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, institucion i ri në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me 26 punonjës në strukturë. Kodi i institucionit është 1026096, programi buxhetor “Menaxhimi i mbetjeve urbane”, kodi i programit buxhetor (06220).

Me shkresën nr. 11603/1 date 4.9.2024 të MF është dërguar “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korrente për 2024 për programin “Menaxhimi i Mbetjeve urbane” është miratuar buxheti për shpenzimet korrente si më poshtë:

- Paga (llogaria ekonomike 600) - 29 milion lekë
 - Sigurime (llogaria ekonomike 601) - 6 milion lekë
 - Mallra dhe shërbime (Llogaria ekonomike 602) - 5 milion lekë
- Total shpenzime korrente 40 milion lekë.

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 15654/1 datë 2.12.2024 “Detajim dhe transferim fondi për shpenzimet kapitale” është çelur sipas buxhetit të miratuar si fond i ngrirë vlera 329,747 mijë lekë kapitull 231 dhe 200,000 mijë lekë kapitull 2 financim i huaj, po ashtu fond i ngrirë. Gjithashtu, në vijim të kërkesës së AKEM për rimbursim TVSH-je së projektit “Mbi Menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipërinë Juglindore”, Urdhrave të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.421 dt.7.11.2024 dhe nr. 422 datë 7.11.2024 “Për likuidimin e TVSH-së për projektin është transferuar fondi për këtë projekt në vlerën totale 20,346 mijë lekë duke u pakësuar nga fondi i ngrirë. Detyrimet e TVSH rrjedhin nga MIE i cili ka administruar këtë program buxhetor më parë. Kodet e projektit të TVSH-së 18BE311 dhe M063124, janë kode të cilat janë çelur nga MIE dhe janë trashëguar për efekt historiku.

Buxheti fillestar, transferimet dhe monitorimi i buxhetit për vitin 2024

Për vitin 2024, janë planifikuar në PBA 2024-2026 kërkesa buxhetore në shumën prej 3,009,847 mijë lekë, buxheti fillestar i akorduar MTM rezulton në shumën 3,523,107 mijë lekë dhe deri në fund të vitit 2024, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 2,710,979 mijë lekë, pra 812,128 mijë lekë ose 23% më pak se buxheti fillestar.

Në këndvështrimin e programeve buxhetore për të cilat MTM realizon shpenzime konstatohet se rritjen më të lartë e ka patur programi “Zhvillimi i turizmit” në shumën 381,843 mijë lekë dhe rënien më të lartë programi “Administrimi i pyjeve” në shumën 52,928 mijë lekë.

Në këndvështrimin e programeve buxhetore për të cilat MTM realizon shpenzime konstatohet se rënien më të lartë e ka patur programi “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane” në shumën 474,000 mijë lekë dhe programi “Mbrojtja e mjedisit” në shumën 240,687 mijë lekë.

Tabela nr. 7 “Planifikimin, rishikimi i buxhetit të MTM dhe realizimi faktik për vitin 2024”
000/ lekë

Programi	Fakti 2023	PBA 2024-2026 F.1	PBA 2024-2026 F.2	Buxheti fillestar 2024	Buxheti i rishikuar 2024	Ndryshimi i buxhetit plan 2024	Fakti 2024	Realizimi %
Planifikim, Menaxhim, Administr	211,753	210,000	210,000	252,950	252,654	(296)	240,367	95%
Mbrojtja e mjedisit	548,075	931,000	931,000	979,110	738,423	(240,687)	485,514	66%
Administrimi i pyjeve	454,487	566,600	566,600	867,560	761,960	(105,600)	574,509	75%
Zhvillimi i turizmit	948,521	472,500	472,500	853,740	862,195	8,455	824,015	96%
Menaxhimi i Mbetjeve Urbane			829,747	569,747	95,747	(474,000)	31,167	33%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	18,836						50,695	
Totali	2,181,672	2,180,100	3,009,847	3,523,107	2,710,979	(812,128)	2,206,266	80%

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se përgjatë vitit 2024 janë kryer gjithsej 18 rialokime; 2 si rezultat i Akteve Normative nr. 3, datë 28.08.2024 për shpenzimet korrente dhe nr. 5 datë 19.12.2024 për shpenzimet kapitale, 3-VKM të veçanta, 1 udhëzim vjetor i fondit të veçantë dhe 12 rialokimeve të brendshme.

Investimet viti 2024

Referuar planit dhe realizimit të investimeve me financim të brendshëm për vitin 2024 janë përmbledhur sipas tabelës paraqitur në Aneksin 1/1 të Projekt Raportit të auditimit.

Nga kjo tabelë evidentohet se për programin “Administrimi i pyjeve” niveli i realizimit të investimeve rezulton i ulët në masën 42.7%.

PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026

Nga auditimi i projekteve të investimit të planifikuara evidentohet se projekti 18BE611 “Zbatim projekti ‘Ngritja e infrastrukturës turistike me theks tek ajo ujore - Eco Park Ulza’, për vitin 2023 është parashikuar në PBA 2023-2025 në vlerën 240,100 mijë lekë. Sipas relacionit vlere totale e projektit parashikohet të jetë 504,000 mijë lekë. Në pamundësi të shtrirjes në periudhën 2023-2025, lind nevoja e kërkesës shtesë për diferencën prej 263,900 mijë lekë dërguar në MF me shkresën nr. 6562/2 prot., datë 29.09.2022 për prioritizimin e kesaj kërkesë shtesë.

Në PBA 2024-2026 është parashikuar në vlerë 401,200 mijë lekë, pra shtrirja 2023-2025 rezulton 504,100 mijë lekë.

Raporti i monitorimit për vitin 2024 është dërguar në MF më shkresën nr. 1768 prot., datë 28.02.2025 “Dërgohet raporti i monitorimit për vitin 2024” brenda afateve të përcaktuara në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar”, pika 270. Realizimi faktik i vitit 2024 për ish MTM rezulton në shumën 2,206,266 mijë lekë ose 80% kundrejt buxhetit të rishikuar dhe 63% kundrejt buxhetit fillestar, përmbledhur në tabelën më poshtë sipas artikujve buxhetorë:

Tabela nr. 8 “Realizimi i shpenzimeve për vitin 2024 sipas artikujve buxhetorë”
000/ lekë

Artikujt buxhetorë	Fakti	PBA 2024-2026 F.1	PBA 2024-2026 F.2	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Fakti 2024	% e real
	2023			2024	2024		%
Paga (600)	739,462	727,790	727,790	947,800	887,550	873,494	98
Sigurime (601)	121,467	120,800	120,800	159,050	153,700	144,632	94%
Mallra e shërbime (602)	564,933	333,458	333,458	688,458	716,418	646,391	90%

Transferta korrente të brendshme (604)	124,596	50,280	50,280	255,280	255,280	250,854	98%
Transferta korrente të huaja (605)	10,124	25,000	25,000	20,000	20,000	10,964	55%
Transferta për buxhet fam e individë (606)	1,930	1,672	1,672	1,672	7,363	6,474	88%
Kapitale (230-232) Të Brendshme	557,543	531,100	860,847	860,847	430,068	207,358	48%
Kapitale (230-232) Të Huaja	42,782	390,000	890,000	590,000	240,600	15,403	6%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	18,836					50,695	
Totali	2,181,672	2,180,100	3,009,847	3,523,107	2,710,979	2,206,266	

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

- Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600-601) për vitin 2024 janë realizuar në masën 98% kundrejt fondeve totale të planifikuara;
- Shpenzimet korrente (602-606) për vitin 2024 janë realizuar në masën 92% kundrejt fondeve totale të planifikuara;
- Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm (230-231) për vitin 2024 janë realizuar në masën 48% kundrejt fondeve totale të planifikuara;
- Shpenzimet kapitale me financim të huaj (230-231) për vitin 2024 janë realizuar në masën 6% kundrejt fondeve vjetore të planifikuara, për shkak se dy nga projektet me buxhetin me të lartë të planifikuar kanë vijuar të jenë në fazën fillestare
- Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit (Kap.6) për vitin 2024 paraqiten në vlerën 50,695 mijë lekë.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitet 2023 dhe 2024

Përveç fondeve buxhetore MTM në zbatim të VKM nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe VKM nr. 417 datë 25.6.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit” MTM realizon të ardhura dytësore.

Realizimi i të ardhurave dytësore u konstatua dhe u përmbledh sipas aktrakordimit me thesarin në fund të çdo viti buxhetor.

Tabela nr. 9 “Realizimi i të ardhurave dytësore”

000/ lekë

Llog. ekonomike	Përshkrimi	2023			2024		
		Progresivi	Rritje e autorizuar	Derdhur në buxhet	Progresivi	Rritje e aut	Derdhur në buxhet
7113009	Tarifë vjetore Tipi B	10		10	20		20
7113010	Tarifë për certifikat udhërrëfyese	31		31			
7035015	Tarifë e përkohshme për tarifë arsimore				5		5
7113099	VNM paraprake, leje mjedisore	79,710		79,710	78,917		78,917
7200105	Grant nga UNEP/MAP	577	577				
7211100	Grant nga UNEP/MAP	2,810	2,810				
7780100	Korigjime nga viti i mëparshëm	248		248	240		240
7115600	Sekustrime dhe zhëndime	1,707		1,707	9,265		9,265
4664100	Derdhur gabim të vitit në vazhdim	200	200		22,041	22,041	
TOTALI		85,293	3,587	81,706	110,487	22,041	88,446

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar auditimit të realizimit të të ardhurave evidentohet se burimi kryesor i të ardhurave dytësore përbëhet nga lejet dhe tarifatat mjedisore. Për vitin 2024 të ardhurat janë rritur me 25,194 mijë lekë krahasuar me vitin 2023.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit Nr.399/1, date 15.04.2025 i ndryshuar, auditimi i këtij drejtimi u fokusua:

Respektimi i strukturës së miratuar dhe krahasimi me faktin:

Struktura organike e MTM-së për periudhën objekt audimi (01.01.2023 deri në 31.12.2024) ka funksionuar:

- Për vitin 2023, me Urdhrin e Kryeministrit Nr.185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” dhe për punonjësit me kontratë sipas VKM nr. 56 datë 01.2.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” i ndryshuar.
- Për vitin 2024, me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 28, datë 09.2.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MTM” dhe për punonjësit me kontratë sipas VKM nr.39 datë 25.1.2024 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” i ndryshuar.

Planifikimi rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.

Lidhur me proceset e pranimit dhe emërimit në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues (TND), e transferimit, pezullimit, lirimit nga detyra, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe vlerësimit të performancës, grupi i auditimit ka kryer testimin me përzgjedhje të dosjeve të personelit me qëllim verifikimin e respektimit të procedurave ligjore për pranimin dhe emërimin në detyrë, si dhe vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit administrativ për çdo punonjës.

Dosjet e përzgjedhura kishin fletën prezantuese dhe fletën e inventarit të saj që përmban listën e dokumenteve përkatësisht: kërkesën për punësim të punonjësit në pozicionin vakant, shpalljen publike në faqen eeb të DAP, njoftimin e fituesit nga DAP, urdhrin e emërimit, CV, kopje të dokumentit të identitetit (letërnjoftim), certifikatën personale dhe certifikatë e gjendjes familjare nga e-albania, kopje e noterizuar e diplomës me listën e notave, kopje të certifikatave ose diplomave të kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës, dëshmia apo certifikata e mbrojtjes së gjuhëve të huaja, librezja e punës, dëshmia e penaltetit nga e-albania, raporti mjekësor (nga e-Albania), masat disiplinore (ps. për vitin 2023 dhe 2024 nuk janë dhënë masa disiplinore), vlerësimi i rezultateve në punë çdo 6 muaj në përputhje me VKM Nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar. Verifikimi dhe testi i dosjes së personelit u bë edhe nga sistemi HRMIS për regjistrin elektronik të personelit, në zbatim të VKM Nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, i ndryshuar si dhe deklarimi për punonjësit e rinj në sistemin e-filling të tatimeve. Gjithashtu, u verifikua se pranimet për vitet 2023 dhe 2024 janë kryer në përputhje me organikën dhe strukturën e miratuar. Për sa vijon u konstatua:

Për vitin 2023.

MTM nuk ka bërë planifikim të shpalljeve të vendeve vakante për shkak se ishte në procesin e ristrukturimit të Ministrisë, konkretisht Urdhri i Kryeministrit nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 70, datë 24.02.2023 “Për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit me nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, i fillon efektet financiare të zbatimit me strukturën e re më 1.03.2023. Numri i punonjësve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me strukturën e re u bë 125 pozicione pune nga 132 pozicione me strukturën e mëparshme:

- 22 pozicione: kabinet + funksione mbështetëse, mbështetur në Kodin e Punës;
- 103 pozicione: punonjës me status të nëpunësit civil.

Pranimi dhe Emërimi në Shërbimin Civil, ngritja në detyrë

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese është bërë në përputhje me Ligjin Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, si vijon:

-MTM nuk ka patur procedura për lëvizje paralele dhe Pranim në pozicion specialist është zhvilluar 1(një) procedurë.

-Janë realizuar 9 procedura ngritjeje në detyrë (4 drejtues dhe 5 përgjegjës sektori).

Emërimet nga Jashtë Shërbimit Civil

1 emërim nga jashtë shërbimit civil në kuadër të 20% të lejuar nga ligji, në pozicionin “Përgjegjës Sektori”.

Lirime me transferim të përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil

-6 transferime gjithsej: 5 të përhershme në kuadër të ristrukturimit dhe 1 i përkohshëm 1 transferim të përkohshëm deri në 6-muaj, nivel Drejtor (nga MTM në MFE).

-5 nëpunës civil u emëruan përmes transferimit të përhershëm.

Gjatë vitit 2023, për shkak të ristrukturimit janë transferuar jo vetëm nga MTM në institucionet e varësisë por edhe nga institucionet e varësisë në aparatit e MTM-së. Sistemimet janë kryer në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme të vendeve vakante (arsimi, përvoja e punës, certifikatat dhe kualifikimet etj.), përcaktuar sipas përshkrimeve të punës së pozicioneve të reja të krijuara rishtazi.

Nga MTM, kanë kaluar në institucionet e varësisë në nivel “specialist” përkatësisht:

-1 punonjës në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM)

-2 punonjës në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (AKB)

-2 punonjës në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP).

Në aparatit e MTM-së kanë ardhur 5 nëpunës civil, me transferim nga institucionet e varësisë, gjatë periudhës së ristrukturimit të tyre, e cila përputhej edhe me kohën që vetë aparati i ish MTM ishte në proces ristrukturimi. Gjatë vitit 2023 janë emëruar në këtë kontekst:

-1 Drejtor, 1 Përgjegjës Sektori,

-2 Specialistë, të cilët transferohen nga institucionet e varësisë në MTM.

-1 specialist, me transferimin e përhershëm në fund të periudhës së pezullimit.

Pezullimi dhe lirimi nga shërbimi civil

Pezullimi dhe lirimi për punonjësit është bërë në përputhje me Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të ndryshuar, për të cilët janë zhvilluar procedurat si vijon:

- 3 procedura pezullimi për nëpunës civil, nga të cilat 1 në pozicionin Drejtor dhe 2 në pozicionin specialist;
- 5 procedura lirimi nga shërbimi civil, nga të cilat 1 me dorëheqje për arsye shëndetësore, 2 me dorëheqje, 2 mbushin moshë e plotë të pleqërisë dhe dalin në pension.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës.

- për 4 nëpunës civil, në pozicionin specialist në pozicione të tjera jashtë institucionit të miratuara nga DAP.
- për 4 nëpunës civil, në pozicionin specialist në pozicione të tjera jashtë institucionit.

Emërimi, rekrutimi, menaxhimi dhe përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil të nëpunësve civilë të Nivelit të Lartë Drejtues dhe Anëtarëve të TND-së.

Për nëpunësit civilë të Nivelit të Lartë Drejtues dhe Anëtarëve të TND-së, është zbatuar procedura vetëm për 1 rast emërimi TND në përputhje me Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe me VKM-së nr.118, datë 5.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënieve në shërbimin civil të nëpunësve civilë të Nivelit të Lartë Drejtues dhe Anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar.

Vlerësimet e punës për anëtarët e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), MTM ia ka përcjellë zyrtarisht DAP-t me shkresën nr. 5790, datë 22.07.2023 për shkak se vlerësimi i punës së tyre vijon me vlerësimin nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes (KPK).

Vlerësimi i Performancës së Punonjësve

Numri Total i nëpunësve civil është 103, për të cilët është bërë vlerësimi vetëm për 70 punonjës për 6 mujorin e parë dhe 74 punonjës për 6 mujorin e dytë si vijon:.

Për 6-mujorin e parë 2023.

- 25 janë vende vakante
- 2 me leje lindje
- 6 janë në periudhë prove
- 70 nëpunës civilë janë vlerësuar, nga të cilat:

Niveli i vlerësimit	Numri i punonjësve të vlerësuar
Shumë mire (1)	24
Mirë (2)	46
Kënaqshëm (3)	nuk ka
Jo kënaqshëm (4)	nuk ka

Për 6-mujorin e dytë të vitit 2023

Numri Total i nëpunësve civil të vlerësuar ka qenë 103, nga të cilat:

- 26 janë vende vakante
- 2 me leje lindje
- 1 në periudhë prove
- 74 nëpunës civilë të vlerësuar, nga të cilat:

Niveli i vlerësimit	Numri i punonjësve të vlerësuar
Shumë mire (1)	19
Mirë (2)	55
Kënaqshëm (3)	nuk ka
Jo kënaqshëm (4)	nuk ka

Përshkrimet e Punës

Të gjitha përshkrimet e punës janë rishikuar dhe dërguar në DAP me shkresën zyrtare nr. 385 prot., datë 17.01.2023. Për sa vijon procedurat janë në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM-së nr.125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Kryeministrit, nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”.

Emërimet dhe Lirime të Kabinetit të Ministrit

Gjatë vitit 2023 janë emëruar 4 punonjës të Kabinetit të Ministrit, si më poshtë:

- 1 Drejtor Kabineti;
- 2 Këshilltarë;
- 1 Sekretare e Zëvendësministrit.

- 1 punonjës mbështetës.

Për sa më lart janë zbatuar procedurat e rekrutimit në përputhje me Ligjin Nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Ligjin Nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të VKM-së Nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të Administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i ndryshuar, të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 185, datë 15.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, si dhe Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Trajnime dhe Kualifikime

Rreth 30 punonjës janë trajnuar në bashkëpunim me ASPA dhe institucione të tjera vendase dhe ndërkombëtare.

Zbatimi i Vendimeve Gjyqësore.

Në çdo institucioni/njësi publike, në zbatim të Urdhrit Nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, Kreu IV, pika 1, krijohet Komisioni i Posaçëm i cili në zbatim të pikës 3, kryen këto detyra:

a-shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyqëfitues;

b- shqyrtimin e rasteve kur urdhrat e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitoare;

c- shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyqëfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin 46 civil.

Për periudhën nën auditim u konstatua se me Urdhrin e Ministrit nr. 153, datë 03.05.2018 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të MTM i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” i ndryshuar, me Urdhrin e Ministrit të MTM nr. 135, datë 08.04.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 153, datë 03.05.2018 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm”, Ministri ka ngritur Komisionin e Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në MTM në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Komisioni është kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe (4+1) anëtarë dhe sekretariatit teknik.

MTM ka likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë konkretisht:

- Për vitin 2023, shpenzimet e kryera për 13 punonjës në zbatim të vendimeve gjyqësore deri më 31.12.2023, janë në vlerën 12,722,911 lekë.
- Për vitin 2024, shpenzimet e kryera për 15 persona në zbatim të vendimeve gjyqësore deri më 31.12.2024 janë në vlerën 14,441,563 lekë.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe legjislacionit në fuqi për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të qeverisjes së përgjithshme e në llogari të thesarit, aktualisht MTM ka në listën e vendimeve gjyqësore të formës së prerë 9 ish-punonjës të shërbimit civil si më poshtë vijon:

1. I.Q., me vendim të formës së prerë nr. 89, datë 21.09.2010
2. Sh. N., me vendim të formës së prerë nr. 80, datë 21.09.2010
3. A. T., me vendim të formës së prerë nr. 83, datë 23.09.2010
4. D. G., me vendim të formës së prerë nr. 335, datë 21.02.2012
5. H. C., me vendim të formës së prerë nr. 1092, datë 20.05.2015
6. E.B., me vendim të formës së prerë nr. 736 (86-2019-833), datë 12.03.2019

7. J. Gj., me vendim të formës së prerë nr. 2703 (86-2019-3081), datë 15.10.2019
8. I. G., me vendim të formës së prerë nr. 3432, datë 26.10.2016
9. E. O., me vendim të formës së prerë nr. 102, datë 19.01.2017.

Në proces gjyqësor janë edhe 2 ish- punonjës përkatësisht:

1. E. D., për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së lartë, me vendimin nr. 146, datë 07.04.2022 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.
2. I. S., në proces gjyqësor.

Për periudhën nën auditimi janë ekzekutuar vendime të formës së prerë edhe për 7 ish -punonjës me kontratë, përkatësisht I. H.; H. D.; N. Ç.; R. S.; S. C.; A.K. A. S., të cilët janë likuiduar rast për rast, mbështetur në dokumentacion dhe legjislacionin në fuqi.

MTM ka korrespondencë elektronike me DAP, për raportimin dhe përditësimin e të dhënave, si dhe statusin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Nga auditimi rezultoi se për periudhën nën auditim, Komisioni i Posaçëm i ngritur me Urdhër Ministri nr. 153, datë 03.05.2018, i ndryshuar, për periudhën nën auditim nuk është mbledhur brenda afateve ligjore, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil. Për pasojë, shumë vendime gjyqësore të formës së prerë mbeten të paekzekutuara, me zvarritje të konsiderueshme me fillesa viti 2010 e në vazhdim në rikthimin e ish-nëpunësve civilë në pozicionet e tyre. Kjo përbën moszbatim të drejtpërdrejtë të procedurës së parashikuar sipas ligjit, shkelje të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative (Ligji nr. 44/2015), si dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” i cili përcakton detyrimin e qartë të institucioneve publike për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me zgjidhje konkrete për sistemin e gjyqfituesit, në një pozicion të shërbimit civil.

Nga Sektori i Buxhetit janë kontabilizuar detyrimet që lindin nga gjyqëfituesit e larguar nga puna në momentin e likuidimit të tyre. Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbarimore dhe detyrimet ndaj gjyqfituesve, por i regjistron ato në total, si rezultat nuk mund të nxjerrim një përfundim në lidhje me shpenzimet përmbarimore për periudhën në auditim. Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5: “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar”.

Konstatim: Nga të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, rezulton se gjatë vitit 2023, janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë për 15 punonjës, në shumën totale prej 12,723 mijë lekë dhe janë paguar shpenzime për tarifë përmbarimore në shumën 363 mijë lekë. Për vitin 2024, shpenzimet vjetore për ekzekutimin e vendime gjyqësore janë 14,441 mijë lekë për 13 punonjës dhe shpenzime për tarifë përmbarimore në vlerën 445 mijë lekë. Vlera prej **27,973 mijë lekë** përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

Ekzekutimi i vendimeve është bërë pa ju ofruar rikthimin në vendin e mëparshëm duke sjellë si pasojë, efekt financiar në buxhet për shumat e sipërcituara.

Struktura organizative e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, megjithëse ka qenë funksionale, kjo drejtori nuk ka ndërmarrë masa për sistemimin në kohë të punonjësve të larguar në pozicionet vakante, në kundërshtim me parimet e menaxhimit me ekonomicitet, efikasitet dhe eficiencë të fondeve publike dhe të burimeve njerëzore, të përcaktuara në neni 4, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Pagesat e kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të ish-punonjësve mund të ishin shmangur nëse do të ishte siguruar një vendimmarje e drejtë për largim nga puna të punonjësve si dhe një menaxhim më i mirë i burimeve njerëzore për sistemin në vendimin e mëparshëm ose ekuivalent si pasojë e rikthimit në punë me vendim gjyqësor. Në tabelat më poshtë jepen të dhënat për pagesat vjetore të kryera të cilat kanë ngarkuar shpenzimet operative (zëri 602).

Për gjithë sistemin e MTM-së kanë qenë të planifikuar 866 vende dhe faktikisht kanë qenë 710 punonjës, pra 56 vende vakante. Për vitin 2023, struktura e re e aparatit ka patur shkurtime të pozicioneve të punës, krahasuar me strukturën e vjetër, pra nga një strukturë me 132 pozicione, është bërë një strukturë me 125 pozicione pune.

Punonjësit me kontratë për Aparatin e MTM kanë qenë 22 të planifikuar dhe 22 faktikisht në punë, kurse për gjithë sistemin plan/fakti për punonjësit me kontratë kanë qenë 93 punonjës, ku shumica e tyre janë miratuar të punojnë 6 orë/ditë, përjashtim bënin punonjësit sanitar të Agjencisë së Bregdetit dhe Agjencisë së Zonave të Mbrojtura që punonin 4 orë/ditë.

Referuar informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, asetëve dhe shërbimeve dhe nga rakordimi i sistemit e-filing të Tatimeve rezultojnë për vitin 2023 janë larguar 33 dhe janë rekrutuar 24 punonjës, kurse për vitin 2024 janë larguar 15 punonjës dhe janë rekrutuar 22 punonjës.

Konkluzion: Nga auditimi i kryer mbi trajtimin e vendimeve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet të ish MTM, konstatohet:

Ekzekutim pjesor dhe i vonuar i vendimeve gjyqësore. Për 2023, janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë për 15 punonjës, në shumën totale prej 12,723 mijë lekë dhe janë paguar shpenzime për tarifë përmbarimore në shumën 363 mijë lekë. Për vitin 2024, shpenzimet vjetore për ekzekutimin e vendime gjyqësore janë 14,441 mijë lekë për 13 punonjës dhe shpenzime për tarifë përmbarimore në vlerën 445 mijë lekë. Vlera prej 27,973 mijë lekë përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore.

✓ Megjithatë, numri i vendimeve të formës së prerë vijon të mbeten i paekzekutuar për periudha të gjata kohore që shkojnë deri në 15 vite, duke përfshirë raste të pazgjdhura që datojnë nga viti 2010 e në vijim. Kjo përbën shkelje të detyrimeve ligjore për zbatimin e menjëhershëm të vendimeve gjyqësore, veçanërisht në rastet e rikthimit në detyrë të nëpunësve civilë, siç parashikohet në nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013.

✓ Shkelje e dispozitave për zbatimin e menjëhershëm të vendimeve për kthimin në detyrë - Moszbatimi i vendimeve gjyqësore për kthimin në punë të nëpunësve civilë përbën shkelje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe nenit 117 të Kodit të Procedurave Administrative (Ligji nr. 44/2015), i cili përcakton detyrimin e qartë të institucioneve publike për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto mosveprime përbëjnë përgjegjësi ligjore dhe administrative për strukturat përkatëse, duke sjellë pasoja në të drejtat ligjore të individëve dhe rritjen e barrës financiare për institucionin.

✓ Mospasqyrimi i detyrimeve në pasqyrat financiare -Vendimet gjyqësore të paekzekutuara nuk janë evidentuar në pasqyrat financiare vjetore përmes llogarisë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke shkelur nenin 6 të Ligjit nr. 9936/2008 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 të Ministrisë së Financave. Sipas këtyre dispozitave, detyrimet duhet të njihen në momentin e krijimit të tyre (pra në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë), pavarësisht momentit të likuidimit.

Regjistri qendror elektronik (HRMIS)

Referuar strukturës së miratuar për punonjësit e aparatit të MTM rezulton se kriteret e pranimit janë të përgjithshme dhe nuk ka kriteret specifike referuar pozicionit në strukturë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2023 datë 30.05.2013 “Për nëpunësit civil” i ndryshuar në nenin 19, pika 8, germa (b) ku cilësohet se “...8. Pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive klasifikohen sipas natyrës së pozicionit në: b) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm, që përfshijnë ato pozicione që kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësive specifike ...dhe ushtrimi i të cilave kërkon njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar apo të ngjashëm me të”.

Me zgjedhje u audituan dosjet e personelit të larguar nga puna me dëshirë/dorëheqje, transferim etj. Për të gjithë punonjësit administroheshin kopje të dokumentacionit përkatës. Procedura standarde e largimit nga puna përfshinte: kërkesën e punonjësit, procesverbalin e dorëzimit të dokumentacionit në ngarkim dhe bazës materiale, si dhe nënshkrimin në Regjistrin Themeltar. Njoftimet për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës realizoheshin përmes shkresave zyrtare, të miratuara nga Nëpunësi Autorizues (Sekretari i Përgjithshëm) dhe me vendim të Drejtorit të Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.

Për vitin 2024

Pranimi, Lëvizja Paralele dhe Emërimet në Kategorinë Ekzekutive

Bazuar në Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar dhe janë realizuar:

9 procedura për pranim në shërbimin civil (pozicion specialist).

1 konfirmim nëpunësi civil pas përfundimit të periudhës së provës.

5 lëvizje paralele, nga të cilat 2 brenda institucionit dhe 3 nga jashtë.

Ngritja në Detyrë

ISH MTM ka zbatuar procedurat sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar.

Gjatë vitit 2024 janë bërë:

1 emërim në pozicionin Drejtor nga institucion tjetër.

3 emërim si Përgjegjës Sektori nga brenda institucionit.

Kandidatët Jashtë Shërbimit Civil (20%)

1 kandidat jashtë shërbimit civil (Drejtor i Drejtorisë së Promovimit të Turizmit) sipas VKM nr. 255, datë 244.2024.

Transferimet e Nëpunësve Civilë.

1 transferim i përhershëm (në nivel Drejtor) sipas VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”.

-nuk ka transferime të përkohshme.

Pezullime dhe Lirime.

Procedurat për pezullimet dhe lirimet nga shërbimi civil janë zbatuar në përputhje me Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të ndryshuar, gjatë vitit 2024 është zhvilluar, si më poshtë:

1 procedurë pezullimi për nëpunës civil, në pozicionin specialist;

1 procedurë pezullimi për TND, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm

1 procedurë lirimi nga shërbimi civil, me dorëheqje.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Gjatë vitit 2024, ka pasur vetëm 1 nëpunës civil, në pozicionin Përgjegjës Sektori për shkëputjen e marrëdhënieve financiare të nëpunësit civil, kjo si pasojë e shkresës së DAP për emërim të tij në një pozicion tjetër jashtë institucionit.

Plani Vjetor i Pranimit për 2024

Çdo fillim viti, Këshilli i Ministrave miraton Planin Vjetor të Pranimit. MTM ka dërguar zyrtarisht në DAP shkresën nr. 6775/3 prot., datë 18.12.2023 lidhur me planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil, kërkesa të cilat për aparatën e MTM-së konsistojnë në:

- 3 pozicione Drejtor,
- 1 Përgjegjës Sektori,
- 6 Specialistë.

Janë krijuar gjithashtu vakanca të reja për shkak të lëvizjeve.

Vlerësimi i Nëpunësve Civilë

6-mujori i parë:

Numri Total i nëpunësve civil 2024 në këtë 6 mujor është 102 punonjës

- 18 janë vende vakante
- 6 janë me leje lindje
- 6 janë në vit prove
- 72 nëpunës civilë janë vlerësuar të gjithë me vlerësim “Mirë”(2)

6-mujori i dytë

Numri Total i nëpunësve civil 2024 është 103, nga të cilat:

- 15 janë vende vakante
- 1 është me leje lindje
- 6 është në vit prove
- 80 nëpunës civilë të vlerësuar, nga të cilët 9 janë vlerësuar “Shumë mirë” (1) dhe 71 “Mirë”(2).

Përshkrimet e Punës

Janë **rishikuar dhe përshtatur** për të gjitha pozicionet në përputhje me strukturën e re (shkresa zyrtare drejtuar në DAP nr. 1096/3, datë 08.04.2024).

Rregullorja e Brendshme

- Rishikuar dhe miratuar me **Urdhrin nr. 184, datë 15.05.2024.**

Emërimet dhe Lirime në Nivel Politik dhe Kabinet

- 2 Zëvendësministra të emëruar dhe 2 të liruar me VKM.
- Lëvizje në pozicionin këshilltar dhe sekretarësh.

Punonjësit Mbështetës

- 2 emërimet dhe 2 lirimet për pozicione ndihmëse (sanitar dhe sekretare).

Procesi i Ristrukturimit

- Struktura e re (miratuar me Urdhrin nr. 28, datë 09.02.2024) përmban **124 pozicione** (nga 125 më parë).
- Janë **rishikuar emërtesat, bashkime dhe ndarje sektorësh**, si dhe **aktet e transferimit të përhershëm** sipas VKM nr. 325, datë 31.5.2023.
- **Të gjithë nëpunësit janë sistemuar**, me përjashtim të një rasti pikëzimi dhe një rasti të ndryshimit të kriterëve të përshkrimit të punës.

Trajnime dhe Kualifikime

- **81 punonjës të trajnuar.**

Për vitin 2024, numri total i punonjësve i miratuar në strukturën e Aparatit të MTM ka qenë 124 ndërsa numri mesatar faktik 115 pra rreth 9 vende vakante.

Për gjithë sistemin e ish MTM kanë qenë të planifikuar 891 punonjës dhe faktikisht 752, Shtesa e planit ka ardh si pasojë e miratimit të strukturës së re të njësisë së varësisë Agjencia Kombëtare e ekonomisë së mbetjeve, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 94, datë 126 2024 për 26 punonjës me kohë të plotë.

Punonjësit e Planifikuar me kontratë për Aparatin kanë qenë 22 dhe 22 faktikisht kurse për gjithë sistemin plan/fakti për punonjësit me kontratë kanë qenë 93 punonjës, ku shumica e tyre janë miratuar të punojnë 6 orë/ditë, ku përjashtim bëjnë punonjësit sanitar të Agjencisë së Bregdetit dhe Agjencisë së Zonave të Mbrojtura që punojnë 4 orë/ditë.

Auditimi me përzgjedhje i listëpagesave të punonjësve për vitet objekt auditimi.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit financiar, analizës së listëpagesave dhe Librit të Pagave për vitet 2023–2024 u konstatua se:

Listëpagesat mujore rezultojnë të jenë mbajtur në mënyrë të rregullt, me të dhëna të sakta për të gjithë punonjësit, Gjatë periudhës së auditimit nuk janë evidentuar nëse ka parregullsi apo shkelje që lidhen me përlllogaritjen, dhe likuidimin e pagave.

Lidhur me dokumentacionin e pagave të cilat janë deklaruar në sistemin e tatimeve dhe me vlerat e pasqyruara në Pasqyrat financiare përkatësisht të Pozicionit Financiar, Të Performancës, Aneks I statistikor (Formati 8) konstatohen mospërputhje të vlerave.

Të gjitha llogaritjet për paaftësi të përkohshme në punë bazoheshin në raportet mjekësore dhe në listprezencën në punë.

Konstatim: *Mospërputhje në raportimet financiare dhe tatimore për vitin 2023.*

Pasqyra e Performancës Financiare (llog. 600), dhe Pasqyra e Aneksit Statistikor, Format nr. 8. Diferenca e konstatuar është në shumën 2,474,388 lekë.

Gjithashtu, janë evidentuar mospërputhje edhe në vlerat e kontributeve të sigurimeve sipas pasqyrës financiare të performancës:

1. Llogaria 436 – Kontributet për sigurimet shëndetësore (punëdhënësi):
 - o Diferencë negative prej 2,497,344 lekë.
2. Llogaria 435 – Kontributet për sigurimet shoqërore (punëdhënësi):
 - o Diferencë pozitive prej 2,497,910 lekë.

Kjo mospërputhje ka ardhur si rezultat i pasqyrimin të të dyja detyrimeve në të njëjtën llogari kontabël, ndonëse ato i përkasin si të ardhura të konstatuar dy institucioneve të ndryshme (FSDKSH dhe ISSH).

Për më tepër, në Llogarinë 431 – Tatime mbi të ardhurat nga punësimi, është konstatuar:

- Sipas ditarit të pagave dhe deklaratave tatimore, vlera e raportuar 13,731,800 lekë.
- Ndërsa në Formatin nr. 8 të Pasqyrave Statistike, vlera e pasqyruar është 14,334,933 lekë.

Diferenca e identifikuar është në shumën 603,133 lekë.

Konkluzion: Për sa sipër, për periudhën objekt auditimi në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave për vitin 2023-2024, janë konstatuar:

-*Moszbatimi i vendimeve gjyqësore për kthimin në punë të punonjësve të larguar padrejtësisht, në mospërputhje përcaktuara në nenin 4, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,*

-*Mospërputhje në raportimet financiare dhe tatimore për vitin 2023 në mospërputhje me UMF nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.*

2.4 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera.

Për auditimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor të marrëdhënieve të punës, pagave dhe bursave, sipas programit të auditimit nr. 110/1 prot, datë 24.01.2025, i ndryshuar për realizimin e drejtimit 4 grupi i auditimit u bazua në dokumentacionin më poshtë:

- ✓ Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- ✓ Transaksionet e llogarive bankare;
- ✓ Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.
- ✓ Të dhëna nga sistemi SIFQ

Regjistrimi i veprimeve në ditarin e bankës është një domosdoshmëri ligjore dhe praktike për subjektet shtetërore, pasi siguron transparencë, llogaridhënie dhe përdorim të rregullt të fondeve publike. Ky proces mundëson gjurmimin e saktë të çdo transaksioni bankar, lehtëson pajtimin ndërmjet të dhënave të brendshme dhe ekstrakteve bankare, si dhe ndihmon në zbulimin e gabimeve apo veprimeve të dyshimta. Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2015 i Ministrisë së Financave, përcaktojnë detyrimin për regjistrim të saktë e të plotë të veprimeve financiare në institucionet publike.

Gjithashtu, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”, UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”, kërkojnë që çdo transaksion, përfshirë ato bankare, të pasqyrohet në përputhje me standardet dhe praktikat e kontabilitetit. Nga regjistrimi i transaksioneve të kryera përgjatë viteve 2023-2024 në ditarin e bankës rezultoi se:

- ✓ Për vitin 2023 në ditarin e bankës janë kontabilizuar 715 transaksione me vlerë 980,496,504 lekë.
- ✓ Për vitin 2024 në ditarin e bankës janë kontabilizuar 875 transaksione me vlerë 892,640,002 lekë.

Nga auditimi me përzgjedhje i transaksioneve të kryera gjatë muajve të përzgjedhur për auditim **për vitet 2023-2024**, mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në MTM rezultoi se dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të UMF nr. 30, date 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*”, veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj.

Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ (rastet e evidentuara në Aneksin 4.1 dhe 4.2 bashkëlidhur) nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua:

- Për vitin 2023, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, 33 fatura;
- Për vitin 2024, janë kryer likuidime në tejkalim të afatit ligjor 30 ditor, 12 fatura;

Në pikën 184 të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, përcaktohet se “Nëpunësit Zbatues të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe në nenin 7 pika “a” të Ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, lidhur me afatet për autoritet publike, parashikohet që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendrike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.”

Gjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2024, në ditarin e arkës janë kontabilizuar me **mandat arkëtime 7,845 Euro** dhe për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023 janë kontabilizuar **10,586 Euro**.

Në fund të vitit, përgjegjësja financiare që administron arkën, ka derdhur në llogarinë e qeverisë pranë bankës përkatëse tepricat në euro dhe në dollarë përmes mandat-pagesash, duke **zëruar gjendjen e arkës** sipas kërkesave të administrimit financiar.

Konkluzion:

Për vitin 2023 në ditarin e bankës janë kontabilizuar 715 transaksione me vlerë 980,496,504 lekë, nga të cilat u përzgjedhën për auditim 230 transaksione që i përkasin kryesisht muajt janar, nëntor, dhjetor 2023 që përfaqësojnë 52% të vlerës së transaksioneve të kryera.

Për vitin 2024 në ditarin e bankës janë kontabilizuar 875 transaksione me vlerë 892,640,002 lekë, nga të cilat u përzgjedhën për auditim 232 transaksione që i përkasin kryesisht muajt janar, nëntor, dhjetor 2022 që përfaqësojnë 54% të vlerës së transaksioneve të kryera.

Sa më lart në ISH MTM u konstatuan vonesa për likuidimin e 33 faturave për vitin 2023 dhe 12 faturave për vitin 2024 (evidentuar në Aneksin nr. 4.1 dhe 4.2 bashkëlidhur PRA), në tejkalim të afatit prej 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës, vepruar në kundërshtim me Ligjin 9936 datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : “specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OEsë”, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

Detyrime e Prapambetura

Në funksion të forcimit të disiplinës buxhetore dhe kontrollit të detyrimeve të papaguara, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020, i cili përcakton procedura të detajuara për raportimin, monitorimin dhe kontrollin e detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

Në përmbajtje, udhëzimi kërkohet që të gjitha institucionet buxhetore të raportojnë në mënyrë mujore dhe vjetore për detyrimet e prapambetura përmes Sistemit të Menaxhimit Financiar të

Qeverisë (AFMIS), të ndajnë detyrimet sipas kategori shpenzimesh dhe vjetërsisë, si dhe të ndërmarrin masa korrigjuese në rast të tejkalimit të kufijve të përcaktuar.

Nga raportimi në sistemin e Menaxhimit Financiar të Qeverisë (AFMIS) në llogarinë 6864 ISH MTM nuk ka raportuar detyrime të prapambetura në 31.12.2023 dhe 31.12.2024.

Në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” rezulton me një vlerë 2,024,624 lekë, e mbartur pa ndryshim nga viti 2023, e cila përfaqëson detyrime të krijuara përpara vitit 2010 (*trajtuar nga KLSH edhe në auditimet paraardhës*).

Nga transaksionet e likuidimit të faturave sipas dokumentacionit bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit u konstatua se:

- gjatë vitit 2023, janë likuiduar 9 fatura të fatura të vitit 2022 në shumën 48,562,124 lekë, të cilat nuk janë pasqyruar si detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare të vitit 2023 (*të dhënat Aneksi 4.2 bashkëngjitur*);
- gjatë vitin 2024, janë kryer likuiduar 12 fatura të fatura të vitit 2023 në shumën 2,674,228 lekë, të cilat nuk janë pasqyruar si detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare të vitit 2024 (*të dhënat Aneksi 4.1 bashkëngjitur*).

Sa më sipër, konstatohet se institucioni nuk ka respektuar plotësisht kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 37, datë 06.10.2020, lidhur me pasqyrimin, klasifikimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura. Tejkalmi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimi*” dhe Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykate të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Konkluzion

Në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” paraqitet me një vlerë prej 2,024,624 lekësh, e cila është mbartur pa ndryshim nga viti 2023 dhe përfaqëson detyrime të krijuara përpara vitit 2010, të evidentuara edhe në auditimet e mëparshme të KLSH. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, u konstatua se gjatë vitit 2023 janë likuiduar 9 fatura të vitit 2022 në shumën 48,562,124 lekë, ndërsa gjatë vitit 2024 janë likuiduar 12 fatura të vitit 2023 në shumën 2,674,228 lekë. Këto transaksione nuk janë pasqyruar si detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare përkatëse të viteve 2023 dhe 2024, siç dokumentohet në Aneksin nr. 4.2 dhe 4.1, duke ndikuar në saktësinë dhe transparencën e raportimit financiar.

2.5. Prokurimet e fondeve publike.

Në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit Nr. 399/1, date 15.04.2025 i ndryshuar, auditimi i këtij drejtimi, u bazua në:

-Ligjin Nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij (*VKM/ udhëzime APP-së etj.*)

Në ish MTM është në strukturë dhe funksion Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve e cila ka në përbërje të saj Sektorin e Prokurimeve.

Për çdo vit buxhetor objekt auditimi, është hartuar Regjistri i Parashikimeve për prokurimet publike dhe dërguar në APP brenda afatit ligjor. Një kopje e tij është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë, me shkresat përcjellëse respective. Çdo nevojë për ndryshim, në regjistrat e parashikimeve është pasqyruar dhe dërguar në APP rast pas rasti. Në përputhje me aktet nënligjore është krijuar dhe Regjistri i Realizimeve të prokurimeve.

VKM e aplikueshme për hartimin dhe publikimin e Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve për prokurimet publike:

-neni 3, neni 3, pika 4, neni 3, pika 7 dhe neni 4, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti si dhe nga auditimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) i regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit rezulton:

Për vitin **2023**, procedurat e realizuara sipas të dhënave në Tabelën 1, janë: Në lekë

Nr.proc.	Procedura/lloji	Fondi limit pa TVSH	Vlera kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
21	Sistemi dinamik ajror	7,000,000	4,885,570	4,885,570
20	Blerje të vogla	12,183,333	8,224,892	9,869,871
1	Hapur e thjeshtuar	7,000,000	5,286,266	6,343,519
2	T. Hapur	72,000,000	58,550,903	70,261,084
5	Marrëveshje kuadër/minikontratë	9,387,150	9,387,150	11,264,580
49	Totali	107,570,483	86,334,781	102,624,624

Burimi: ISH MTM (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SPE)

Për vitin **2024**, procedurat e realizuara sipas të dhënave në Tabelën 2, janë: Në lekë

Nr.proc.	Procedura/lloji	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera kontratës me TVSH
26	Sistemi dinamik ajror	7,000,000	5,553,280	5,553,280
24	Blerje të vogla	13,333,333	9,520,419	11,424,503
1	Hapur e thjeshtuar	6,000,000	5,001,759	6,002,111
2	T. e hapur	999,666,600	923,191,822	1,107,830,187
6	Marrëveshje kuadër/minikontratë	10,474,895	8,246,195	9,895,434
59	Totali	1,036,474,828	951,513,476	1,140,705,515

Burimi: ISH MTM (të dhënat nga regjistrat e realizimit të prokurimeve dhe SPE)

Procedurat e prokurimit “marrëveshje kuadër”, janë kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ASHPP).

VKM e aplikueshme për kryerjen e procedurave:

-neni 3 dhe 4, VKM Nr. 393, datë 09.06.2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë shtetërore të prokurimeve të përqendruara dhe ngarkimin e kësaj agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”.

Viti 2023

Auditimi u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion dosjet me vlerë më të lartë të kontratave të lidhura trajtuar më poshtë.

Tenderi me objekt “**Rikonstruksion i Godinës së AKM**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “Rikonstruksion i Godinës së AKM”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.134, dt 24.04.2023	3.NJHDT/Njësia e prokurimit: R. L. K. T.-spec. fushe i jashtëm AKM A. S.	4.KVO Urdhër nr.135, date 24.04.2023 S. J. P. M.- spec. fushe i jashtëm AKM I. B.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: T. Hapur		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 26,510,323.94 (për 2 vite): 19,637,000 lekë-viti 2023 6,873,323.94 lekë- viti 2024	6.Oferta fituese “A-A” 20,041,353.15 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 6,468,970.79lekë pa TVSH

8. Data e hapjes së tenderit 15.05.2023	9. Fonde të Buxhetit të Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës 16. BOE "A." fitues me vlerë 24,049,623.78 lekë me TVSH
---	--	---

Burimi: Të dhënat ish MTM dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim- Planifikimi i nevojave për këtë procedurë prokurimi është parashikuar në PBA 2023-2025 në vlerën totale 39,000,000 lekë shtrirë në 2 vite (2023-24,000,000 lekë dhe 2024-15,000,000 lekë) si dhe në regjistrin e parashikimeve për vitin 2023 në vlerën 26,510,323.94 (i shtrirë në 2 vite), ku fondi limit i parashikuar nuk ka pësuar ndryshime të mëvonshme nga ato të publikuara në regjistrin e parashikimeve dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë Nr. 536 prot., datë 24.01.2023.

Bazuar në:

-neni 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.

Llogaritja e fondit limit-AK i është referuar preventivit të zbatimit të projektit bazuar në kontratën e lidhur nga AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) Nr.6615, datë 25.08.2022, si autoritet kontraktor dhe OE "I. D. A.", në vlerën 26,510,323.94 lekë pa TVSH.

Bazuar në:

-Kontrata Nr.6615, datë 25.08.2022, mes AKM dhe OE "I. D. A."

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Titullari i AK (me detyrë Sekretar i Përgjithshëm) ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.134, datë 24.04.2023 për zhvillim e procedurës së prokurimit "Tender i Hapur", për të cilën është ngarkuar Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Bazuar në:

-neni 73, pika 1 dhe neni 77 VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim - Njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. (Procesverbali Nr. 2644/2 prot., datë 24.04.2023 dhe Nr. 2644/3 prot., datë 24.04.2023).

Bazuar në:

-neni 78, pika 1 dhe 2, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Nga auditimi i kriterëve të veçanta DT, u konstatua:

Për kriterin 2.3 "Kapaciteti teknik", pika 2, pika 4 dhe 5" kërkohen licenca profesionale... dhe staf inxhinierik dhe staf teknik":

-NP-12A (punime të inxhinierisë së mjedisit)

-NS-18A (punime topogjeodezike)

staf inxhinierik të punësuar:

-1(një) inxhinier mjedisi

-1(një) inxhinier gjeodet

Kriteret e sipërme nuk janë në raport me objektin, natyrën e kontratës objekt prokurimi. Në preventivin e projektit të zbatimit nuk parashikohen zëra punimesh për të cilat të kërkohen licencat e sipërme, pasi në VKM Nr.42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", Lidhja 3, përcaktohen qartë:

"NP-12A-Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit

bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte”;

“NS-18A- Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh”.

Për rrjedhojë, edhe disponimi nga operatori ekonomik i një stafi inxhinierik (konkretisht: *ing. mjedisi, ing. gjeodet*) ekspertiza profesionale e të cilëve është e domosdoshme në këto kategori punimesh, nuk i përgjigjet kategorisë së punimit parashikuar në preventivin e zbatimit. Ekspertiza e stafit të kërkuar duhet të jetë në fazën e projektimit.

Kriteret e sipërme jo në përputhje me:

-VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Lidhja 3,

-neni 77, Ligji Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar,

-neni 39, pika 4, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Veprimet e kryera jo në përputhje me:

-neni 74, pika 4, dhe 78, pika 2, të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Koompetenca:

-specialisti i fushës përcaktuar me shkresën Nr.878/1 prot., datë 08.02.2023 të AKM dhe miratuar me Urdhër Prokurimin Nr.134, datë 24.04.2023 të titullarit të AK, në përbërje të grupit për hartimin e DT.

-Në lidhje me hartimin e DT, nga Koordinimi i APP-së me e-mailin datë 4.05.2023, janë dhënë sugjerime për disa kritere si dhe rekomandimet përkatëse.

AK me Urdhër Nr.151, datë 05.05.2023 ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar NJHD për modifikimet e nevojshme dhe njoftimin e OE. AK njoftuar OE, përmes publikimit të njoftimit në SEP. (*Procesverbali NJHD datë 05.05.2023*). Pas heqjes së pezullimit të procedurës me Urdhër Nr. 152/3 prot., datë 05.05.2023 KVO ka hapur procedurën ditën e përcaktuar në DT. Në lidhje me DT nuk është bërë asnjë ankim nga OE.

Vlerësimi i Ofertave

Bazuar në:

-neni 80, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Nga auditimi për hapjen publike të ofertave në SEP rezultojnë të kenë shpallur interes dhe paraqitur oferta 16 OE. KVO ka bërë verifikimin mbi ekzistencën e ofertave anomalisht të ulta në zbatim të nenit 93 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar dhe nenit 80 dhe 82 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar:

-Oferta e OE “A. C.” me vlerë 17,534,375.25 lekë, rezultojnë ofertë anomalisht e ulët;

-oferta e OE “A.-S.” në vlerën 34,216,194.44 lekë, rezultojnë mbi vlerën e fondit limit. (*Procesverbali KVO Nr.1, datë 15.05.2023*).

-Referuar procesverbalit të mbajtur nga KVO rezultojnë se është kualifikuar në vend të parë oferta e operatorit “A.-A.” 20,041,353.15 lekë, pasi janë skualifikuar operatorët (A. C., A-S., F&SH, I, S., T&XH, F. dhe A-S), për shkak të:

- ofertës anomalisht të ulët dhe mbi vlerën e fondit limit,

-si dhe ofertave që nuk kanë dorëzuar dokumentacionin për plotësimin e kritereve të vendosura. (*Procesverbali KVO Nr.2, datë 29.05.2023*).

Nga auditimi në SPE i bërë nga grupi i auditimit për ofertën e skualifikuar nga KVO me vlerë më të ulët 19,678,681 lekë BOE “F&SH.” rezultoi:

BOE është skualifikuar nga KVO me argumentin se, nuk ka vendosur në fushat e përcaktuara, Shtojca 8, Pjesa II/A, “*Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit*”, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, adresën përkatëse ku gjendet e baza e të dhënave.

Nga auditimi në SPE rezultojnë se, Shtojca 8, Pjesa II/A, “Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, është plotësuar me bazën e të dhënave përkatëse në përputhje

me nenin 26, pika 2, të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, ku, për çdo deklaram të kërkuar sipas kriterëve të formularit është vendosur adresa elektronike dhe emërtimi i dokumentit.Gjithashtu konstatohet se deklarata është plotësuar vetëm nga operatori F. e cila është ngarkuar në SPE 2 herë dhe jo prej secilit nga operatorët, anëtarë të BOE.

Pavarësisht se nga KVO për këtë kriter është skualifikuar BOE, përsëri BOE nuk i ka përmbushur të gjithë kërkesat e kriterëve të veçanta.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO nuk ka patur asnjë ankesë pranë AK apo KPP.

Lidhja e kontratës-Me BOE “A-A.” fitues me vlerë oferte më të ulët është lidhur kontrata Nr.2644/8, datë 22.11.2023 me vlerë 20,041,353.15 lekë pa TVSH/24,049,623.78 lekë me TVSH.

Bazuar në:

-Kontrata Nr.2644/8, datë 22.11.2023.

Tenderi me objekt “**Mbikqyrje punimesh per objektin “Rikonstruksion i Godinës së AKM”**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “ Mbikqyrje punimesh per objektin “Rikonstruksion i Godinës së AKM” ”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.230, dt 30.06.2023	3.Komisioni për llogaritjen e f. limit dhe hartimin e spec.tek.: Urdhri Nr.210, datë 21.06.2023 R. L. A. S. Dh. L.	4.Komisioni i blerjeve të vogla; Urdhri nr.2, datë 05.01.2023
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Blerje me vlerë të vogël		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 282,537.98 lekë	6.Oferta fituese BOE “E. C. G&S” 224,944.15 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit: 57,594 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 03.07.2023	9. Fonde të Buxhetit të Shtetit	10. OE/Pjesëmarrës: 19 BOE “E. C. G&S.” 269,932.98 lekë me TVSH

Burimi: Të dhënat ish MTM dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Llogaritja e fondit limit-Me Urdhri Nr.210, datë 21.06.2023 të titullarit të AK është ngritur Komisioni për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike. Referuar Procesverbalit datë 23.06.2023, Komisioni për llogaritjen e fondit limit është bazuar në VKM Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e *Manuali të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim*”.

Bazuar në:

-VKM Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e *Manuali të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim*”.

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Titullari i AK ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.134, datë 24.04.2023 për zhvillim e procedurës së prokurimit “*Tender i Hapur*”, ngarkuar Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Bazuar në:

-neni 73, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar,

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit i janë referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e *Manuali të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim*” dhe UKM Nr. 5, datë 25.06.2001 “*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*”(Procesverbali Nr. 4016/3, prot.,datë 30.06.2023).

Vlerësimi i Ofertave-Përmes klasifikimit automatik në sistem të ofertave rezulton se është shpallur fituese oferta e operatorit BOE “E. C.G&S” në vlerën 224,944.15 lekë pa TVSH/269,932.98 lekë me TVSH me të cilin është lidhur kontrata Nr.4016/4, datë 10.07.2023.

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara (ASHPP) ka zhvilluar në datë 21.02.2023 si organ organ qëndror blerës procedurën e prokurimit me objekt **“Riparim dhe mirëmbajtje automjesh për MTM”**, Loti 2.

Në zbatim të germës “k” të VKM Nr. 393, datë 09.06.2022 *“Për krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara dhe ngarkimin e kësaj Agjencie për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimeve të Prokurimit Publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë”*, ASHPP me shkresën Nr.314, datë 07.04.2023, protokolluar në MTM me Nr.2421, datë 12.04.2023, ka njoftuar ISH MTM për nënshkrimin e Marrëveshjes Kuadër Nr. 3112 prot., datë 07.04.2023 si dhe ka kërkuar lidhjen e minikontratave me OE fitues “A” SHA.

Procedura e ndjekur për lidhjen e minikontratave nga ISH MTM dhe marrja në dorëzim e shërbimit:

Referuar Marrëveshjes Kuadër Nr.3112 prot., datë 07.04.2023 me operatorin fitues “A” SHA për vitin 2023, janë lidhur minikontratat:

-Nr.3257/2 prot., datë 29.05.2023 me vlerë 949,800 lekë pa TVSH/1,139,760 lekë me TVSH
-Nr.6058/3 prot., datë 20.10.2023 me vlerë 1,080,100 lekë pa TVSH/1,296,120 lekë me TVSH.
ISH MTM ka dërguar Ftesat për Ofertë për çdo rast në procedurat para lidhjes së minikontratave respective operatorit fitues “A” SHA me kusht që, oferta nuk duhet të tejkalojë çmimet për njësi të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër.

Me shkresat respective janë dërguar në APP, Formulari i Njoftimit për publikimin e minikontratës së nënshkruar.

-Me Urdhrin Nr.144, datë 03.05.2023 të titullarit të AK/Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për mbikqyrjen e minikontratave që do të lidhen në bazë të marrëveshjes kuadër nr.3112, datë 07.04.2023 dhe marrjen në dorëzim të shërbimit (*Sh. K., K. F., D. M., A. T. dhe B. Ç*).

Nga auditimi u konstatua: AK në nxjerrjen e urdhrin për ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit, nuk ka respektuar kërkesat e Kapitullit III, pika 43, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, si dhe Rekomandimin e APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 *“Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”*, pika III/4, germa “a”, që në përbërje të Komisionit të jetë specialist i fushës.

Përsa i përket mungesës në përbërjen e Komisionit të specialistit të fushës, fenomeni mbartet dhe për vitin 2023 dhe pse KLSH, është shprehur dhe në auditimin e mëparshëm për këtë konstatim, por rekomandimi i saj nuk është zbatuar.

2. Grupi për marrjen në dorëzim të shërbimit nuk ka patur në vëmendje të tij kërkesat e Kapitullit III, pika 36 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, nenit 13, të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave si dhe Rekomandimit të APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 *“Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”*, pika III/4, germa “d” pasi, procesverbalet respective të marrjes në dorëzim të shërbimit për minikontratën Nr.6058/3 prot., datë 20.10.2023 mbajtur për çdo automjet, nuk janë protokolluar por vetëm janë nënshkruar.

Në Rekomandimin e APP përcaktohet në mënyrë eksplicite se *“...sjellim në vëmendje të AK që procesverbalet të hartohen në përputhje me aktet dhe modelet e dokumenteve stadarde*

administrative, të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, si dhe të protokollohen në institucion”.

3.Vërehen korrigjime në një rast (por jo i përhapur) në Fletëhyrjen Nr.17, datë 31.10.2023 bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit Nr.572/1, datë 21.11.2023, në rubrikën “çmimi” dhe në përshkrimin e datës së procesverbalit 30.10.2023, veprim në kundërshtim me Kapitullin III, pika 36 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, në të cilin në mënyrë eksplicite përcaktohet se “...Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve” si dhe pika III/4, germa “d” Rekomandimit të APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023.

-Marrja në dorëzim e shërbimit të kryer për çdo automjet është bërë me procesverbal ku është përshkruar shërbimi i kryer sipas situacionit përkatës, bashkëlidhur fatura elektronike e shitësit si dhe fletë hyrja e magazinës.

Veprimet e sipërme jo në përputhje me:

-Kapitulli III, pika 43, pika 36, Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,

-pika III/4, germa “a” dhe germa “d” Rekomandimi i APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”.

Kompetenca:

-Titullari i AK,

-Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit,

-Magazineri.

Viti 2024

Referuar Marrëveshjes Kuadër Nr.3112 prot., datë 07.04.2023 me objekt “**Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për MTM**”, Loti 2, me afat 2 vjet, me operatorin fitues “A” SHA janë lidhur minikontratat:

-Nr.7390/3, datë 10.12.2024 me vlerë 771,300 lekë pa TVSH/925,560 lekë me TVSH

-Nr.4766/2 prot., datë 27.08.2024 me vlerë 524,100 lekë pa TVSH/628,920 lekë me TVSH.

MTM ka dërguar Ftesat për Ofertë për çdo rast në procedurat para lidhjes së minikontratave respective operatorit fitues “A” SHA me kusht që, oferta nuk duhet të tejkalojë çmimet për njësi të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër.

Me shkresat respective janë dërguar në APP, Formulari i Njoftimit për publikimin e minikontratës së nënshkruar.

Komisioni i marrjes në dorëzim të shërbimit:

Nga auditimi u konstatua:1. AK në nxjerrjen e urdhrit për caktimin e Komisionit për marrjen në dorëzim të shërbimit, nuk ka respektuar kërkesat e Kapitullit III, pika 43, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Rekomandimin e APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”, pika III/4, germa “a”, që në përbërje të Komisionit të jetë specialisti i fushës.

2.Grupi për marrjen në dorëzim të shërbimit nuk ka patur në vëmendje të tij kërkesat e Kapitullit III, pika 36 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, nenit 13, të “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave si dhe Rekomandimit të APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”, pika III/4, germa “d”

pasi, procesverbalet respective të marrjes në dorëzim të shërbimit për dy minikontratat mbajtur për çdo automjet, nuk janë protokolluar.

Përsa i përket mungesës në përbërjen e Komisionit të specialistit të fushës, fenomeni mbartet dhe në vitin 2024 dhe pse KLSH është shprehur dhe në auditimin e mëparshëm për këtë konstatim, por rekomandimi i saj nuk është zbatuar.

-Marrja në dorëzim e shërbimit të kryer për çdo automjet është bërë me procesverbal ku është përshkruar shërbimi i kryer sipas situacionit përkatës bashkëlidhur procesverbalit si dhe fatura elektronike e shitësit dhe fletë hyrja e bërë në magazinë.

Veprimet e sipërme jo në përputhje me:

-Kapitullit III, pika 43, pika 36, Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,

-pika III/4, germa “a”, Rekomandimi i APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”,

-neni 13, “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Kompetenca:

-Titullari i AK

-Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit.

Tenderi me objekt “**Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona Rreth tij**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “ Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni I Ulzës dhe Zona Rreth tij ”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.171, dt 2.05.2024	3.NJHDT/Njësia e prokurimit: D. P. - spec. fushe R. L. D. L.	4.KVO: Urdhër nr.172, datë 02.05.2025 S. J. H. D. E. R.- spec. fushes
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: T. Hapur		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 429,666,564 (për 3 vite): 164,916,666.66 lekë-viti 2024 164,916,666.66 lekë viti 2025 99,833,230.68 lekë viti 2026	6.Oferta fituese “H” SHPK 377,094,056 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 52,572,508 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 28.05.2024	9. Fonde të Buxhetit të Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës 7 “H” SHPK 452,512,866.96 lekë me TVSH

Burimi: Të dhënat ISH MTM dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim-Planifikimi parashikuar në PBA 2022-2025 dhe 2024-2026, në vlerën totale 504,100,000 lekë si dhe në regjistrin e parashikimeve për vitin 2024 në vlerën 429,666,666. Parashikimi për procedurën e prokurimit është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë Nr. 536 prot., datë 24.01.2023. Procedura e prokurimit parashikuar për vitin 2023 është anuluar për shkak se ofertat e paraqitura janë skualifikuar. Me Memo Nr.6771 prot., date 14.11.2023 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm nga Drejtoria e Prokurimeve dhe Partneriteteve, është vënë në dijeni, mbi pamundësinë e rishpalljes së procedurës për shkak të tejkalimit të afateve dhe riorganizimin e fondeve buxhetore për këtë procedurë në zbatim të Vendimit Nr.807, datë 16.11.2016” Për *Disiplinimin e Angazhimeve Buxhetore*”.

Bazuar në:

-neni 3, pika 4, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.

Llogaritja e fondit limit-AK i është referuar vlerës së preventivit 429,666,564 lekë pa TVSH llogaritur për projektin e zbatimit.

Bazuar në:

-Kontrata Nr.5668/11, datë 3.10.2022 mes ish MTM dhe BOE "A & T".

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Titullari i AK (*me detyrë Sekretar i Përgjithshëm*) ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.171, datë 2.05.2024 për zhvillim e procedurës së prokurimit "Tender i Hapur", ngarkuar Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Bazuar në:

-neni 73, pika 1, 2 VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. (*Procesverballi Nr. 3008/2 prot., datë 07.05.2024 dhe Nr.3008/3 prot., datë 07.05.2024*).

Bazuar në:

-neni 78, pika 1 dhe 2, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua: AK për kriterin më poshtë nuk ka mbajtur në konsideratë kërkesa në përputhje me objektin e kontratës. Konkretisht:

Për kriterin 2.3. pika 8, është kërkuar:

-OE të ketë një punësim mesatar "*minimumi 150 punonjës*":

Një kërkesë e tillë dhe pse është e argumentuar si historik nga AK/NJHD se kujt i janë referuar mbi përlllogaritjen për këtë numër punonjësish, nuk gjendet bashkëlidhur këtij argumenti, llogaritja e detajuar bazuar në preventivin e punimeve sipas normave ditore të punës për punonjës, mjeteve që do të përdoren dhe grafikut të punimeve, apo të jetë lënë gjurmë mbi referencën e përdorur si shënim (Footnote) (*llogaritjen analitike të kryer*) për të nxjerrë këtë rezultat. Argumentimi i bërë në këtë formë nga AK është i përgjithshëm dhe nuk jep informacion të saktë mbi llogaritjet e bëra për përcaktimin e numrit të punonjësve si kriter i veçantë.

Kriteret e sipërme jo në përputhje me:

-VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Lidhja 3,

-neni 77, Ligji Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar,

-neni 39, pika 4 VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Koompetenca:

-specialisti i fushës përcaktuar në Urdhër Prokurimin Nr.171, dt 2.05.2024 në përbërje të grupit për hartimin e DT.

Në lidhje me DT, nga Koordinimi i APP-së me e-mailin datë 21.05.2024, janë dhënë sugjerime për disa kriteret për të cilat janë dhënë rekomandime. Me Memo Nr.3523, datë 27.05.2024 drejtuar SP-së nga specialisti i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partineriteteve, janë përcjellë argumentet e AK. Në lidhje me DT, nuk është bërë asnjë ankim nga OE.

Vlerësimi i Ofertave-Për tenderin kanë shfaqur interes 7 OE, nga të cilët operatori D nuk ka ngarkuar në sistem (SPE) ofertë ekonomike e cila përbën kusht për skualifikim.

Nga KVO, janë skualifikuar operatorët për mos plotësim të kriterëve dhe është kualifikuar operatori H. me vlerë oferte 377,094,056 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit fizik si dhe në SPE i operatorit H. rezultoi:

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Shtojca 8, ka mangësi konkretisht:

-Pjesa II/A, "*Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit*", nuk është plotësuar me bazën e të dhënave përkatëse në përputhje me nenin 26, pika 2, të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, ku, për çdo deklaram të kërkuar sipas kriterëve të formularit të jepet sqarimi përkatës mbi adresën elektronike ku gjendet baza e të dhënave të dokumentit si dhe emërtimi i dokumentit të deklaruar.

-Pjesa II/A, pika B, Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” janë deklaruar 2 punonjës (B. O. dhe S. T.) të cilët janë staf i operatorit mbështetës I.Të dhënat për këto punonjës janë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të operatorit mbështetës, ndërkohë që secili deklaron pjesën që dispon përsa i përket pajisjeve, mjeteve dhe stafit.

-Shtojca 8, Pjesa II/A, e operatorit mbështetës I. nuk është plotësuar me bazën e të dhënave përkatëse në përputhje me nenin 26, pika 2, të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar

-Nga krahasimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE me dokumentacionin fizik të administruar nga AK, rezulton se mungon fizikisht grafiku i punimeve i detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST), pika 2.3.9. Në procesverbalin Nr.3, datë 13.06.2024 të KVO-së, për marrjen në dorëzim të dokumentave fizike të operatorit fitues H, në rubrikën Nr.5, “Emërtimi”, grafiku i punimeve, nuk është vendosur numër për fletë (mungon fizikisht) dhe pse është listuar emërtimi i dokumentit. Gjithashtu në SPE, rezulton që është ngarkuar grafiku i punimeve nga operatori por nuk është i detajuar sipas zërave të punimeve bazuar në DT, por sipas kapitujve të punimeve në total.

Jo në përputhje me:

-neni 82, Ligji Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar

-neni 26, pika 2 dhe 3, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

-DT, pika 2.3.9.

Koompetenca për sa sipër:

-KVO, neni 75, pika 4, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Lidhja e Kontratës: Me operatorin fitues është lidhur kontrata nr.3008/8, datë 08.07.2024, me afat 21 muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve, me vlerë 377,094,055.80 lekë pa TVSH/452,512,866.96 lekë me TVSH. Zbatimi i punimeve është në proces.

Tenderi me objekt “**Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës**”, me të dhënat:

Procedura e Prokurimit “ Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës ”		
1.Urdhër Prokurimit: Nr.365, dt 7.10.2024	3.NJHDT/Njësia e prokurimit: D. P. -specialist. fushe R. L. D. L.	4.KVO Urdhër nr.366, datë 07.10.2024 S. J. H. D. E. Z., Specialist i fushes
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: T. Hapur		
5.Fondi Limit Total (pa TVSH) 569,366,644.34 (për 3 vite): 140,300,000 lekë-viti 2024 214,533,333 lekë viti 2025 214,533,311.34 lekë viti 2026	6.Oferta fituese BOE “H” SHPK & “I.” SHPK 546,097,766.65 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 23,268,877.69 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 28.10.2024	9. Fonde të Buxhetit të Shtetit	10. OE/ Pjesëmarrës 5 BOE “H” SHPK & “I.” SHPK 655,317,319.98 lekë me TVSH

Burimi: Të dhënat ish MTM dhe sistemi elektronik i prokurimeve (SPE)

Planifikimi i nevojave për prokurim-Planifikimi parashikuar në PBA 2024-2026, në vlerën totale 850,800,000 lekë (*shpërndarë per 3 vite*) si dhe në regjistrin e parashikimeve për vitin

2024 në vlerën 429,666,666. Parashikimi për procedurën e prokurimit është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë Nr. 536 prot., datë 24.01.2023.

Bazuar në:

-neni 3, pika 4, e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 me ndryshime.

Llogaritja e fondit limit- AK i është referuar vlerës 569,366,643 lekë pa TVSH së preventivi të zbatimit të projektit të tenderuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura realizuar me BOE” C.S&A &B &U” llogaritur për projektin e zbatimit.

Nxjerrja e urdhër prokurimit-Titullari i AK (*me detyrë Sekretar i Përgjithshëm*) ka nxjerrë Urdhër Prokurimin Nr.365, datë 07.10.2024 për zhvillim e procedurës së prokurimit “*Tender i Hapur*”, ngarkuar Njësia e Prokurimit për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Bazuar në:

-neni 73, pika 1, 2 VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar

Hartimi i dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta për kualifikim-Njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar DT/kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim. (*Procesverbali Nr. 6271/2 prot., datë 09.10.2024 dhe Nr. 6271/3, prot., datë 10.10.2024*).

Bazuar në:

-neni 78, pika 1 dhe 2, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua: AK për kriterin më poshtë nuk ka mbajtur në konsideratë kërkesa në përputhje me objektin e kontratës. Konkretisht:

Për kriterin 2.3 “Kapaciteti *teknik*”, është kërkuar:

-NS-13 A

VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Lidhja 3, përcakton qartë:

N.S - 13 “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme”.

Referuar projektit si dhe preventivit të zbatimit të punimeve, kemi të bëjmë me instalimin e linjave të thjeshta të komunikimit të cilat përfshihen në kategorinë N-14 dhe jo, impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë.

Bazuar në VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Lidhja 3:

N.S-14 “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV” Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme”.

Në pikën 9, është kërkuar:

-OE të ketë një punësim mesatar “*minimumi 150 punonjës*”:

Një kërkesë e tillë dhe pse është e argumentuar si historik nga AK/NJHD se kujt i janë referuar mbi përlllogaritjen për këtë numër punonjësish, nuk gjendet bashkëlidhur këtij argumenti, llogaritja e detajuar bazuar në preventivin e punimeve sipas normave ditore të punës për punonjës, mjeteve që do të përdoren dhe grafikut të punimeve, apo të jetë lënë gjurmë mbi referencën e përdorur si shënim (Footnote) (*llogaritjen analitike të kryer*) për të nxjerrë këtë rezultat. Argumentimi i bërë në këtë formë nga AK është i përgjithshëm dhe nuk jep informacion të saktë mbi llogaritjet e bëra për përcaktimin e numrit të punonjësve si kriter i veçantë.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.14 (*dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike*), nga AK nuk është vendosur detyrimi i operatorit për deklarim të mos angazhimit të mjeteve dhe pajisjeve në kontrata të tjera, kusht ky për realizimin në kohë të punëve ashtu, sikurse është vepruar për tenderin me objekt “*Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona*

Rreth tij”, zhvilluar me datë 28.05.2024, lidhur kontrata datë 08.07.2024, ku në DT, është vendosur një kriter i tillë. Nisur nga fakti se numri i mjeteve dhe pajisjeve për realizimin e kontratës është i konsiderueshëm, pasi zona ku do të kryhen punime ka statusin “zonë e mbrojtur”, një kusht i tillë është i dosmosdoshëm për tu patur në konsideratë nga AK.

Kriteret e sipërme jo në përputhje me:

-VKM Nr.42, datë 16.01.2008, Lidhja 3,

-neni 77, Ligji Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar,

-neni 39, pika 4 VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Kompetenca:

-specialisti i fushës përcaktuar në Urdhër Prokurimin Nr. 365, dt 7.10.2024 në përbërje të grupit për hartimin e DT.

Në lidhje me DT, nga Koordinimi i APP-së me e-mailin datë 15.10.2024, janë dhënë sugjerime për disa kriteret si dhe rekomandimet përkatëse. Me Memo Nr.6846, datë 17.10.2024 drejtuar SP-së nga specialist i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partineriteteve janë përcjellë argumentet për këto sugjerime të cilat janë marrë pjesërisht në konsideratë, duke bërë ndryshimet përkatëse në DT.

Vlerësimi i Ofertave-Për tenderin kanë shfaqur interes 5 OE dhe kanë publikuar ofertat e tyre në SPE. KVO pas shqyrtimit të ofertave ka skualifikuar operatorët më poshtë për mos përmbushje të kritereve për kualifikim:

-L&... me vlerë oferte 424,174,254 lekë pa TVSH

-Z. me vlerë oferte 553,872,709.05 lekë pa TVSH

-U. me vlerë oferte 561,434,883.84 lekë pa TVSH

-R.G. me vlerë oferte 569,366,000 lekë pa TVSH nuk ka ngarkuar në sistem dokumentacion,

BOE “I. &...” me vlerë oferte 546,097,766.65 lekë pa TVSH është kualifikuar fitues.

Nga auditimi në SPE i dokumentacionit të operatorit fitues rezulton:

-Shtojca 8, formular i vetëdeklarimit në SPE është ngarkuar vetëm prej operatorit H. i cili ka në këtë bashkëpunim operatorësh 90% të punimeve dhe jo prej çdo operatori anëtar të BOE, sipas DT, pra jo dhe nga I., ndërsa në dokumentacionin fizik të dorëzuar nga BOE, rezulton të jetë plotësuar prej secilit nga operatorët sipas përqindjes në BOE, kërkesë kjo e DT, shtojca 8.

-Shtojca 8, Pjesa II/A, “*Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit*”, e operatorit H., nuk është plotësuar seksioni me bazën e të dhënave përkatëse në përputhje me nenin 26, pika 2, të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, ku, për çdo deklaram të kërkuar sipas kritereve të formularit jepet sqarimi përkatës mbi adresën elektronike ku gjendet baza e të dhënave të dokumentit si dhe emërtimi i dokumentit;

-Nuk jepen të dhëna të sakta në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe punonjësve sipas përqindjes në BOE, por jepet në total disponimi i tyre.

-Mungon dokumenti fizikisht si dhe në SPE i grafikut të punimeve i detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST), pika 2.3.9.

Jo në përputhje me VKM:

-Dokumentat e tenderit

-neni 75, pika 4, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Kompetenca:

-KVO, neni 75, pika 4, VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Lidhja e Kontratës: Me operatorin fitues është lidhur kontrata nr.6271/8, datë 02.12.2024, me afat 24 muaj nga data e njoftimit të fillimit të punimeve, me vlerë 377,094,055.80 lekë pa TVSH/655,317,319.98 me TVSH. Zbatimi i punimeve është në proces.

Konkluzion:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2023-2024 u konstatuan parregullësi dhe mangësi proceduriale në:

☞ hartimin e dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta (tenderat “Rikonstruksion i Godinës së AKM”, “Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona Rreth tij” dhe “Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës”, jo në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, nenin 39, pika 4 të VKM-në Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar; ☞ vlerësimin e ofertës fituese në 2 raste (tenderat “Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona Rreth tij” dhe “Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës”) me mangësi midis dokumentacionit të publikuar në SPE dhe dokumentacionit fizik të dorëzuar pas shpalljes fitues, jo në përputhje me dokumentet e tenderit;

☞ në katër raste (viti 2023-2 raste dhe viti 2024-2 raste), Komisioni për marrjen në dorëzim të shërbimit për minikontratat (“Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për MTM”) nuk ka patur përbërje të tij specialistin e fushës, në kundërshtim me kërkesat e Kapitullit III, pika 43, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe Rekomandimin e APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”, pika III/4, germa “a”.

☞ në tre raste (viti 2023-1 rast dhe viti 2024-2 raste), procesverbalet respektive të marrjes në dorëzim të shërbimit mbajtur për çdo automjet për vitin 2024 nuk janë protokolluar, në kundërshtim me kërkesat e Kapitullit III, pika 36 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenit 13, të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave si dhe Rekomandimit të APP Nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”, pika III/4, germa “d”.

Auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”:

Nga auditimi i zbatimit të kontratave të punëve publike në ish Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për vitin 2023 nga të dhënat e Regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike është lidhur 1 kontratë për punë publike me vlerë kontrate 20,041,353 lekë pa TVSH ose 24,049,624 lekë me TVSH dhe për vitin 2024 janë lidhur 2 kontrata për punë publike me vlerë kontrate 923,191,823 lekë pa TVSH ose 1,107,830,187 lekë me TVSH. Mbi bazën e materialitetit është audituar 1 kontratë me vlerë 24,049,624 lekë me TVSH ose 100 % e vlerës së kontratave të zhvilluara, të dhënat në Tabelën 1.

Për vitin 2024, zbatimi i punimeve për këto objekte ishte në proces, për pasojë auditimi mbi zbatimin e punimeve do të realizohet në auditimet e radhës, të dhënat në Tabelën 2.

Tabela 1: Lista e kontratave të audituara, periudha 01.01.2023 deri më 31.12.2023

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit (Pa TVSH për 2 vite)	Vlera e kontratës (Pa TVSH)	OE Fitues	Data e lidhjes se kontrates	Afati mbarimit kontrates	Vlerësu ar për auditim
1	Rikonstruksion i Godinës së AKM	26,510,324	20,041,353	ASI-2A CO	22.11.2023	09/01/2024	PO
	Totali	26,510,324	20,041,353				
	%	100%	100%				

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Tabela 2: Lista e kontratave të lidhura dhe që janë në proces zbatimi, periudha 01.01.2024 – 31.12.2024

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit (Pa TVSH per 3 vite)	Vlera e kontratës (Pa TVSH)	OE Fitues	Data e lidhjes se kontrates	Afati mbarimit kontrates
1	Zbatim Projekti “Qendra multifunkionale në Luginën e Vjosës”	569,366,644	546,097,767	BOE HASTOCI	12/2/2024	12/2/2026
2	Zbatim Projekti për Parkun Natyror "Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij"	429,666,564	377,094,056	HASTOCI	8/7/2024	4/7/2026
	Totali	999,033,208	923,191,823			
	%	0%	0%			

Burimi: ISH MTM, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”** rezultoi se:

- Objekti i kontratës është **“Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”** me nr.2644/8 prot., datë 10.07.2023, lidhur midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Operatorit Ekonomik “A” SHPK. Vlera e kontratës është 24,049,623.78 lekë me TVSH. Afati i kontratës në muaj është parashikuar 4 muaj dhe punimet janë realizuar në 5 muaj e 10 ditë. Për këtë objekt është miratuar nga AK, një Amendim kontrate me nr.2644/8 datë 24.11.2023 me afat të ri data 09.01.2024. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse me nr.4016/4 prot., datë 10.07.2023, midis AK Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe mbikëqyrësit BOE “E.” Shpk & “S.” Shpk, me liçensat respektive për mbikëqyrje-kolaudim punimesh MK.3574/4 dhe MK.4146/5.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve është më datë 31.07.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve është kryer nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 09.01.2024.

-Nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatuan disa parregullsi/mangësi si më poshtë: Në katin 0, u vu re se kishte prezencë të lagështirës nëpër muret e korridorit, gjithashtu në tavanet e disa prej sallave u vu re se kishte plasaritje të suvatimit të tavanit, këto tregojnë për një neglizhencë në kryerjen e punimeve sipas KTZ. Materialet e përdorura në objekt nuk janë të shoqëruar me certifikata cilësie, skeda teknike dhe deklaratë konformiteti. Gjithashtu procesverbalet e miratimit të tyre janë vendosur në dosje pa datë dhe të pashoqëruara me certifikatat cilësie. Mungojnë provat laboratorike për materialet e ndërtimit, provat e hidroizolimit, prova për sistemin e sinjalizimit të zjarrit dhe provat nën ngarkesë për punimet elektrike, procesverbali i tokëzimit etj. Në dosjen tekniko ligjore nuk janë vendosur fotografi për çdo punim të maskuar, në kundërshtim me: *Udhëzim Nr.2, Datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”* Kreu I neni 8.3 dhe Kreu II neni 7. Librezat e masave janë hartuar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”* dhe udhëzimet nr.1 datë 16.06.2011, dhe nr.3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, pasi ato nuk janë shoqëruara me vizatime dhe skica ilustruese për çdo zë pune.

-Nga verifikimi i punimeve në terren rezultuan disa parregullsi dhe mangësi apo diferenca lidhur me volumet e punës të situacionuara në situacionin përfundimtar me punimet faktike në terren si dhe volume të llogaritura në librezat e masave jo në përputhje me punimet faktike si më poshtë:

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize *“An 4-Prishje shtrese suvaje mure+tavane”* i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 3,825.6 m², sqarojmë se duke kontrolluar librezat e masave me punimet faktike në terren; vihet re se në librezat e masave të dorëzuara në dosje është përfshirë në mënyrë të gabuar prishja e suvatimeve të tavaneve në disa nga

ambientet në Katin 1, ndërkohë që tavanet në këtë kat janë bërë me tavan gipsi, ashtu si edhe korridorët janë bërë me gips. Gjithashtu edhe një pjesë e fasadës së jashtme, pjesa e mbrapëme është raportuar sikur është prishur suvaja në katin 1, ndërkohë që sipas fotografive fillestare përpara se të fillonin punimet, kjo pjesë e fasadës nuk ka qënë e suvatuar. Pasi kryejmë rillogaritjet sipas gjendjes faktike në terren, për këtë zë pune kjo sasi llogaritet 2,622.29 m² Diferenca midis sasisë së raportuar 3,825.6 m² dhe sasisë së llogaritur 2,622.29 në vlerën: 1,203m² x 320 lekë/m² = **384,960 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.196/c-Hidroizolim me dy shtresa mapej” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 392.5 m², vihet re se në librezat e masave të dorëzuara në dosje është përfshirë në mënyrë të gabuar hidroizolimi i disa sallave të tjera në kundërshtim me projektin e zbatimit, ku në të cilin parashikohet vetëm hidroizolimi i tualeteve. Referuar sa më sipër nëse kryejmë llogaritjet e sipas punimeve faktike në terren, kjo sasi duhet të ishte raportuar 91.5 m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën 301 m²x1,500 lekë/m²= **451,500 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.328-Patinim muri allçi (stuko)” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,410.6 m², referuar sa më sipër nëse kryejmë llogaritjet sipas punimeve faktike në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 1,788.9m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën: 612.6 m² x 250 lekë/m² = **155,400 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “An.66-Lyerje me beton kontakt per muret qe do patinohen” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,410.6 m², referuar sa më sipër nëse kryejmë llogaritjet e sipas punimeve faktike në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 1,788.9m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën: 612.6 m² x 350 lekë/m² = **217,564 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.358/b-Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 712 m², ndërsa sipas gjendjes faktike në fasadën e pasme te objektit kjo veshje nuk ishte kryer në të gjithë gjatësinë perimetrale, dhe jo me lartësinë e raportuar në librezës e masave. Sa më sipër nëse kryejmë llogaritjet e sipas punimeve faktike në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 618.4 m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën: 94.1 m² x 1,700 lekë/m² = **160,024 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Në lidhje me zërin e punës me nr.analize “2.181-Profile për oxhakët teknike ne fasade (te kanaleve te aspirimeve te laboratoreve)” në librezat e masave nuk është shprehur në mënyrë analitike llogaritja në librezën e masave për sasinë e raportuar prej 6 ton.

Gjithashtu në terren u konstatuan disa zëra pune në mangësi në sasi me sasinë e raportuar në situacionin përfundimtar, zëra të cilat po i paraqesim në formë tabelare si më poshtë:

Analizë	Emërtim i punimeve	Njësi	Sasia sipas situacionit perf	Sasia sipas punimeve faktike	Çmimi	Vlera sipas situacionit perfunditar	Vlera sipas punimeve faktike	Diferenca mes vlerave
An.33	F.V Ndricues LED 1.2ml 28w IP44 4000K	copë	47	20	2,500	117,500	50,000	67,500
An.40	"F.V. Baze dhe Dedektor tymi & nxehtesie te adresuar, optik -jonik - termik komplet"	copë	13	10	5,000	65,000	50,000	15,000
An.42	F.V. Perserites optik me drite per sensore brenda tavanit	copë	3	0	5,000	15,000	0	15,000
An.43	F.V. Sirena lajmeruese te brendshme	copë	9	2	3,000	27,000	6,000	21,000
An.44	F.V. Sirena lajmeruese te jashtme	copë	5	1	3,000	15,000	3,000	12,000

An.46	F.V. Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, kapak etj, IP-65 aktivizimi	copë	4	2	2,500	10,000	5,000	5,000
An.47	F.V. Kontakte magnetike per komandimin e dyerve antizjarr, tensioni i punes 24V, DC, P 1,5 w, Dimensionet Ø: 50 mm H: 30 mm	copë	10	0	2,500	25,000	0	25,000
An.48	"F.V. Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, kapak etj,, IP-65 caktivizimi"	copë	1	0	2,500	2,500	0	2,500
Kartela								
An.56	F.V Fikese zjarri me pluhur (AL-5203-B)	copë	15	7	6,500	97,500	45,500	52,000
An.57	F.V Buton sinjalizimi zjarri (AL-5102-B)	copë	4	0	2,500	2,000	0	10,000
An.58	F.V Drejtim dalje emergjence (AL-5107-B)	copë	8	7	2,000	16,000	14,000	2,000
An.59	F.V Zbritje shkallesh (AL-5103-B)	copë	4	1	2,500	10,000	2,500	7,500
An.62	V. sprinklera 75 l/min I kompletuar	copë	31	0	2,000	62,000	0	62,000
Pajisje								
An.64	F. sprinklera 75 l/min I kompletuar	copë	31	0	6,000	186,000	0	186,000
Totali						658,500	176,000	482,500

Burimi: Të dhëna nga dosjet e prokurimit, përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera totale e diferencave 1,851,948 lekë pa TVSH, përbën dëm për buxhetin e shtetit për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera ose punime të llogaritura jo sipas gjendjes faktike në objekt.

Për sa sipër, mbikqyrësi i punimeve BOE “E” SHPK & “S” SHPK, në kundërshtim me nenin 7, kreu III, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, nuk ka zbatuar detyrimet ligjore të sipërme sipas të cilave *“Mbikqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantirerit dhe është përgjegjës për saktësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”*. Për rrjedhojë, rezultuan diferenca në volume pune të cilat janë likuiduar por të pakryera në fakt, që përbën dëm për buxhetin në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH.

Gjithashtu kolaudatori i punimeve OE “A” SHPK, me licencë MK. 3678, i cili bazuar në kontratën nr.881 prot., datë 05.02.2024, për shërbimin e kolaudit për objektin *“Rikonstruksion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”* me Kontraktor punimesh OE “A” SHPK, është likuiduar në vlerën 32,400 lekë me TVSH, pasi në kundërshtim me nenin 12, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, nuk ka zbatuar detyrimet ligjore të sipërme sipas të cilave *“Kolaudatori ose grupi i kolaudit duhet të verifikojë: Realizimin e objektivit në përputhje me projektin...”*. Për rrjedhojë, rezultuan diferenca në volume pune të cilat janë likuiduar por të pakryera në fakt, që përbën dëm për buxhetin në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH.

Për marrjen në dorëzim të punimeve me Urdhrin nr.236, datë 10.07.2023 është ngritur grupi i punës për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës dhe marrjen në dorëzim të punimeve (M. P., K. A. dhe E. K. Sipas certifikatës së marrjes në dorëzim të punimeve datë 23.02.2024, Grupi i punës për ato zëra pune të cilat nga ana sasiore janë lehtësisht të verifikueshme, nuk ka bërë numërimin e tyre për të shprehur gjendjen faktike të këtyre punimeve, por ka vendosur sasi të sipas situacionit përfundimtar të punimeve nënshkruar nga Mbikqyrësi i punimeve.

Procedurat e prokurimit “Blerje me vlerë të vogël”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) për vitet 2023-2024, ka ngritur Komisionin e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël me urdhrat respektivë të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK). Konkretisht urdhri nr. 02 datë 05.01.2023 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” dhe urdhri nr. 2 datë 04.01.2024 bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 68, dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2023 përbëhet nga z. S. K., znj. I. B. dhe znj. R. L.

Sipas viteve objekt auditimi, realizimi i procedurave të prokurimit “blerje me vlerë të vogël” dhe “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” paraqitet në vijim:

Për vitin 2023, janë realizuar 20 procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël” dhe 21 procedura prokurimi “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me vlerë totale të kontratave të realizuara **14,755 mijë** lekë me TVSH dhe fond limit 19,183 mijë lekë pa TVSH.

Procedurat e prokurimit në mënyrë të pëmbledhur paraqiten në tabelë në seksionin “Aneke”.

Për vitin 2023 u përzgjedhën për auditim procedurat si vijon:

000/lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Urdhër prokurimi	Pjesëmarrës në tender	Refuzuar
1	Blerje materiale kancelarie, letër A4/A3	996	640	Ma & D	Nr. 214 datë 22.06.2023	22	1
2	Blerje Tонера	1,000	495	I	Nr. 168 datë 24.05.2023	24	5
3	Shërbim mirëmbajtje gjelbërimi për ambientet e ISH MTM-së	990	850	P	Nr. 57 datë 14.02.2023	13	1
4	Shërbim riparim dhe mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit	805	500	C	Nr. 113 datë 11.04.2023	10	3
5	Monitorim i medias	940	765	P	Nr. 90 datë 23.03.2023	1	0
Totali		4,731	3,250				

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave nga regjistri i realizimit të prokurimeve

U audituan procedura e prokurimit:

1. “Blerje materiale kancelarie, letër A4/A3”

Urdhër Prokurimi nr. 214, datë 22.06.2023 fond limit 996 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta me vlerën më të ulët “M & D” me vlerë 640 mijë lekë pa TVSH.

2. “Blerje tonera”

Urdhër Prokurimi nr. 168, datë 24.05.2023 fond limit 1,000 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta me vlerën më të ulët “I” me vlerë 495 mijë lekë pa TVSH.

3. “Shërbim mirëmbajtje gjelbërimi për ambientet e MTM-së”

Urdhër Prokurimi nr. 57, datë 14.02.2023 fond limit 990 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta me vlerën më të ulët “P” me vlerë 850 mijë lekë pa TVSH.

4. “Shërbim riparim dhe mirëmbajtje e sistemit të kondicionimit”

Urdhër Prokurimi nr. 113, datë 11.04.2023 fond limit 805 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta me vlerën më të ulët “C” SHPK me vlerë 500 mijë lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme u konstatua se në çdo rast:

-Është hartuar kërkesa për zhvillimin e procedurës;

-Është hartuar procesverbal për përlogaritjen e fondit limit;

-Janë ngritur urdhrat përkatëse të prokurimit;
-Janë hartuar ftesat për ofertë;
-Janë hartuar procesverbalet për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit;
-Janë hartuar procesverbalet mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve nga komisionet respektive të marrjes në dorëzim;
Likuidimet janë kryer konform rregullave dhe procedurave në bazë të faturave të lëshuara nga operatorët ekonomikë sipas rastit.
Lidhur me këto procedura nuk u konstatuan problematika.

5.Prokurimi me objekt “Monitorim i medias”.

Urdhër Prokurimi Nr. 90, datë 23.03.2023 fond limit 940 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta e vetme “P” SHPK me vlerë 765,400 lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 811 prot., datë 02.02.2023 është hartuar kërkesa për planifikimin e nevojës për kryerjen e shërbimit me objekt “Monitorim i medias” nga këshilltari për komunikimin z. E. U. Në këtë shkresë citohet “Faktikisht gjatë monitorimit manual humbasin deri në 40% të lajmeve, sado i vëmendshëm dhe i kujdesshëm të jetë ky monitorim”. Për këtë konstatim nuk ka një analizë të argumentuar dhe të mirë realizuar.

-Me shkresën datë 23.03.2023 është hartuar procesverbali për përlogaritjen e fondit limit, ku janë marrë 3 oferta përkthësisht nga shoqëria “E” SHPK me vlerë 940 mijë lekë pa TVSH; “J” SHPK në vlerë 956 mijë lekë pa TVSH dhe Shoqëria “P” SHPK në vlerë 924,000 lekë pa TVSH. Fondi limit është përcaktuar si mesatare e tre ofertave në vlerë **940,000** lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 811/1 prot., datë 23.03.2023 është ngritur urdhri Nr. 90 datë 23.03.2023 për prokurimin me vlera të vogla.

-Me shkresën nr. 811/2 prot., datë 23.03.2023 është hartuar ftesa për ofertë, sipas formularit nr. 3.

-Me shkresën nr. 811/3 prot., datë 23.03.2023 është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit.

Me shkresën nr. 811/4 prot., datë 28.03.2023 është lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet AK dhe OE fitues shoqërisë “P” SHPK.

Me shkresën nr. 811/5 prot., datë 28.03.2023 është hartuar autorizimi ku është vendosur z. E. U. si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Nuk është ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të shërbimit, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me shkresat përkatëse për çdo muaj janë hartuar procesverbalë për marrjen në dorëzim të shërbimit.

Procedurat e prokurimit ***“sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”***

Me urdhrin nr. 4 datë 05.01.2023 “Për krijimin e komisionit të sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” është ngritur grupi i punës me përbërje znj. R. L., znj. I. B. dhe z. S. K.

“Blerje bileta avioni Tiranë- Samarkand (Uzbekistan)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi nr. 300, datë 03.10.2023 data e tenderit 03.10.2023, fituese oferta “O”, me vlerë 770,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE e renditur në vend të tretë), pasi OE “E” dhe “A” të kualifikuar në vend të parë dhe të dytë janë tërhequr nga lidhja e kontratës, pjesëmarrës në tender 4 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 521 datë 23.10.2023, sipas faturës nr. 96/2023 datë 03.10.2023.

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Bruksel (Belgjikë)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi nr. 178, datë 09.06.2023 data e tenderit 09.06.2023, fituese oferta “A”, me vlerë 795,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 330 datë 04.07.2023, sipas faturës nr. 644/2023 datë 09.06.2023.

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Dubai (Emiratet e Bashkuara Arabe)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi nr. 343, datë 13.11.2023 data e tenderit 13.11.2023, fituese oferta “E”, me vlerë 420,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët), pjesëmarrës në tender 5 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 609 datë 04.12.2023, sipas faturës nr. 1150/2023 datë 13.11.2023.

Viti 2024

Për vitin 2024, janë realizuar 24 procedura prokurimi “blerje me vlerë të vogël” dhe 26 procedura prokurimi “sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” me vlerë totale të kontratave të realizuara **16,978 mijë** lekë me TVSH dhe fond limit 20,333 mijë lekë pa TVSH.

Për vitin 2024 u përzgjedhën për auditim procedurat si vijon:

000/lekë

Nr	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Urdhër prokurimi	Pjesëmarrës në tender	Refuzuar
1	Shërbim riparim automjeti për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	1,000	980	A	Nr. 129, datë 20.03.2024	12	4
2	Shërbim lyerje dhe mirëmbajtje të ambjenteve të brendshme dhe zyrave të ISH MTM	995	778	M	Nr. 130, datë 25.03.2024	18	1
3	Shërbim riparimi i pajisjeve elektronike (kompjutera, UPS, sÿwÿtche, printera, skanera, fotokopje etj)	943	750	I	Nr. 167, datë 25.04.2024	10	1
4	Shpenzime të tjera për shërbime të ndryshme	996	960	A	Nr. 229 datë 18.06.2024	9	3
Totali		3,934	3,468				

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave nga regjistri i realizimit të prokurimeve

U audituan procedura e prokurimit:

1. “Shërbim riparimi i pajisjeve elektronike (kompjutera, UPS, sÿwÿtche, printera, skanera, fotokopje etj.)”

Urdhër Prokurimi nr. 167, datë 25.04.2024 fond limit 943 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta e renditur e treta “I” me vlerë 750 mijë lekë pa TVSH. Sipas klasifikimit fitues rezultoi si fillim operatori ekonomik Q. me ofertë në vlerën 534 mijë lekë pa TVSH. Ky OE nëpërmjet sistemit ka njoftuar tërheqjen nga procedura. Gjithashtu OE i renditur në vend të dytë “I” është tërhequr nga realizimi i procedurës me arsyen e një gabimi në ofertë.

2. “Shërbim riparim automjeti për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”

Urdhër Prokurimi nr. 129, datë 20.03.2024 fond limit 1,000 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta e renditur i gjashti “A” me vlerë 980 mijë lekë pa TVSH. OE të renditur në fillim nuk kanë paraqitur dokumentat në afat apo janë tërhequr nga procedura.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme u konstatua se në çdo rast:

- Është hartuar kërkesa për zhvillimin e procedurës;
- Është hartuar procesverbal për përlllogaritjen e fondit limit;
- Janë ngritur urdhrat përkatëse të prokurimit;
- Janë hartuar ftesat për ofertë;
- Janë hartuar procesverbalet për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit;
- Janë hartuar procesverbalet mbi marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Lidhur me këto procedurë nuk u konstatuan problematika.

3. “Shërbim lyerje dhe mirëmbajtje të ambienteve të brendshme dhe zyrave të MTM”

Urdhër Prokurimi nr. 130, datë 25.03.2024 fond limit 995 mijë lekë pa TVSH, fituese oferta e renditur e katërta “M” me vlerë 778 mijë lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 1413 prot., datë 20.02.2024 është hartuar kërkesa për planifikimin e nevojës për kryerjen e shërbimit të lyerjes dhe mirëmbajtjes të ambienteve të MTM-së.

-Me shkresën nr. 1413/2 është hartuar ftesa për ofertë dhe me procesverbalin datë 25.03.2024 është përlogaritur fondin limit.

-Me shkresën nr. 1413/3 prot., datë 25.03.2024 është hartuar procesverbali i specifikimeve teknike. Lidhur me kapacitetin teknik është kërkuar: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Në çdo rast, vlera duhet të jetë jo më e vogël se 400 mijë lekë.

Në datë 03.04.2024 është hartuar procesverbali përmbledhës i vlerësimit. Sipas klasifikimit fitues rezultoi si fillim operatori ekonomik M-M me ofertë në vlerën 642 mijë lekë pa TVSH. Ky OE nëpërmjet sistemit ka njoftuar tërheqjen nga procedura. U kalua te OE i dytë “M”, i cili është tërhequr nga realizimi i procedurës me arsyen e mungesës së burimeve njerëzore. U njoftua fituesi i radhës “M”. Me shkresën datë 28.03.2024 është mbajtur procesverbali për skualifikimin e operatorit i renditur i treti, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar nga AK (nuk disponon licensën profesionale NS 14 dhe nuk ka deklaruar se disponon inxhinier mekanik.) Fitues u shpall operatori i katërt “M” SHPK.

Me shkresën nr. 1413/4 prot., datë 08.04.2024 është lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet AK dhe OE fitues.Me urdhrin nr. 149 datë 08.04.2024 është ngritur grupi i punës për mbikqyrjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit me përbërje znj. A. M, znj. Dh. L. dhe znj. A. S.

OE ka lëshuar faturën tatimore nr. 3/2024 datë 18.04.2024 në vlerën 934 mijë lekë me TVSH. Në datën 18.04.2024 është mbajtur procesverbali mbi marrjen në dorëzim të shërbimit.

4. “Shpenzime për qiramarrje automjeti”

Urdhër Prokurimi nr. 229, datë 18.06.2024 fond limit **996 mijë** lekë pa TVSH, fituese oferta e renditur e dyta “A” me vlerë 960 mijë lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 3411 prot., datë 20.05.2024 është hartuar kërkesa për planifikimin e nevojës për kryerjen e shërbimit të marrjes me qira të automjetit nga z. Sh. K. me detyrë P/Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme. Nga subjekti argumentohet se automjeti tip Volvo CX 90, me targë A..., përgjatë 2 viteve të fundit ka bërë defekte serioze duke krijuar vështirësi në mbulimin e nevojave të transportit për titullarin. Automjeti është riparuar, por nuk është më në gjendje optimale pune për të përballuar intensitetin e lëvizjeve të shumta dhe të gjata të Titullarit të Institucionit dhe nuk mund të garantojë siguri maksimale në udhëtime, veçanërisht në udhëtime të gjata. Për të përballuar nevojën e transportit dhe për të garantuar siguri teknike në udhëtim të Titullarit të Institucionit, është propozuar që të operohet me procedurën e prokurimit për marrjen me qira të automjetit.

-Nga auditimi rezulton se është kryer një procedurë tjetër prokurimi me objekt “Shërbim riparim automjeti për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, pikërisht për mjetin me targë A.. me urdhrin nr. 129 datë 20.03.2024, për të cilën është kryer shpenzimi në vlerën 1,176 mijë lekë me TVSH, të trajtuar më lart.

Me shkresën datë 15.04.2024 është hartuar procesverbali për marrjen në dorëzim të shërbimit të riparimit të automjetit, si dhe ka deklaruar garancie nga OE fitues që garanton cilësinë e shërbimit për jo më pak se 6 muaj nga data e kryerjes.

Përsa trajtuar më lart, kërkesa dhe nevoja për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrjen me qira të automjetit **është e pabazuar dhe e pa justifikuar**, duke qënë se prokurimi është realizuar brenda periudhës së aftatit të garancisë së automjetit të riparuar. Gjithashtu nga verifikimi i fletë daljeve të magazinës, për këtë automjet ka shpenzime karburanti për periudhën pas riparimit, pra është në gjendje pune dhe është përdorur për nevoja të institucionit.

Vlera e marrjes me qira të automjetit 1,152 mijë lekë me TVSH dhe përbën **shpenzim të pajustificuar dhe pa ekonomikitet** për buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

-Me shkresën datë 18.06.2024 është hartuar procesverbali për përlllogaritjen e fondit limit, ku janë marrë 3 oferta përkthësisht nga shoqëria “A” SHPK me vlerë 1,005 mijë lekë pa TVSH; “A.” SHPK në vlerë 1,005 mijë lekë pa TVSH dhe Shoqëria “A” SHPK në vlerë 979,680 lekë pa TVSH. Fondi limit është përcaktuar si mesatare e tre ofertave në vlerë **996 mijë lekë** pa TVSH.

-Me shkresën nr. 3411/1 prot., datë 18.06.2024 ka dalë urdhri nr. 229 datë 18.06.2024 për prokurimin me vlera të vogla.

-Me shkresën nr. 3411/2 prot., datë 18.06.2024 është hartuar ftesa për ofertë, sipas formularit nr. 3.

-Me shkresën nr. 3411/3 prot., datë 18.06.2024 është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të kualifikimit.

Sipas klasifikimit fitues rezultoi si fillim operatori ekonomik “A” me ofertë në vlerën 958 mijë lekë pa TVSH. Ky OE nëpërmjet sistemit ka njoftuar tërheqjen nga procedura, për arsye të angazhimit në tendera të tjerë.

-Me shkresën datë 20.06.2024 është mbajur procesverbali për kalimin te OE i rradhës pas tërheqjes së OE “A”. U kalua te OE i dytë “A”, me vlerë oferte 960 mijë lekë pa TVSH.

-Me shkresën nr. 3411/5 prot datë 27.06.2024 është autorizuar z. D. M. si person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e kontratës. Nuk është ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të shërbimit, veprim jo në përputhje me VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 3411/4 prot., datë 27.06.2024 është lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet AK dhe OE fitues shoqërisë “A” SHPK.

Me procesverbalin e shoqërisë datë 01.07.2024 është dhënë me qira automjeti. Ky procesverbal ka shërbyer si marrje në dorëzim.

Subjekti ka lëshuar faturat elektronike nr. 36691/2024 dt 06.08.2024; 38588/2024 dt 04.09.2024; 40311/2024 dt 01.10.2024; 42172/2024 dt 04.11.2024; 45330/2024 dt 30.12.2024 në vlerën totale 1,152 mijë lekë me TVSH.

Lidhur me auditimin e procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël të trajtuara më sipër, grupi i ngritur për marrjen në dorëzim nuk plotëson kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43 që citon “43. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tri veta, duke përfshirë edhe punonjës të punësuar me përgjegjësi materiale.”

Auditimi i procedurave të prokurimit “**Sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar**” për vitin 2024.

Me urdhrin nr. 4 datë 04.01.2024 “Për krijimin e komisionit të sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” është ngritur grupi i punës.

“**Blerje bileta avioni Tiranë- Berlin (Gjermani)-Tiranë**”.

Urdhër Prokurimi nr. 371, datë 08.10.2024 data e tenderit 08.10.2024, fituese oferta “S”, me vlerë 42,000 lekë pa TVSH, (lidhur kontrata me OE e renditur në vend të dytë), pasi OE “A” i kualifikuar në vend të parë është skualifikuar se nuk ka dorëzuar në kohë dokumnetacionin e kërkuar, pjesëmarrës në tender 8 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 645 datë 23.10.2024, sipas faturës nr. 1598/2024 datë 14.10.2024.

Në këtë rast, ftesa për pjesëmarrje është përcjellë në datë 29.08.2024, ndërsa memo e përgatitur nga znj. R. A. me detyrë specialiste e Drejtorisë së Ndryshimeve Klimatike ka datën 07.10.2024. Procedurat e prokurimit është realizuar 2 ditë para datës së udhëtimit, pasi praktika

e miratimit për pjesëmarrje në evente është kryer me vonesë jo menjëherë nga momenti i njoftimit nga organizatorët. Vonesa në fillimin e procedurave të prokurimit, mund të sjellë si pasojë blerjen e biletave të transportit ajror me kosto të lartë.

“Blerje e bileta avioni Madrid (Spanjë)-Tiranë-Madrid dhe Madrid-Tiranë-Sarajevë”.

Urdhër Prokurimi nr. 138 datë 29.03.2024 data e tenderit 29.03.2024, fituese oferta “O”, me vlerë 874,000 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE me ofertë më të ulët*), pjesëmarrës në tender 3 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 192 datë 17.04.2024, sipas faturës nr. 59/2024 datë 30.03.2024.

“Blerje e bileta avioni Tiranë- Athinë (Greqi)-Tiranë dhe Paris (Francë)-Tiranë”.

Urdhër Prokurimi nr. 148, datë 08.04.2024 data e tenderit 08.04.2024, fituese oferta “K”, me vlerë 105,700 lekë pa TVSH, (*lidhur kontrata me OE e renditur në vend të dytë*), pasi OE “I..” i kualifikuar në vend të parë ka njoftuar tërheqje nga procedurë si rezultat i një gabimi në çmimin e ofertuar, pjesëmarrës në tender 9 OE, likuiduar OE në zbatim të kontratës me urdhër shpenzimin nr. 252 datë 08.05.2024, sipas faturës nr. 434/2024 datë 09.04.2024.

Në procedurat e prokurimit **“sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”** të cilat u përzgjedhën mbi bazë risku (*vlera më e lartë e kontratës së lidhur*), konstatimi i përgjithshëm:

-Në tre raste të audituara, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se *“ka ndryshuar çmimi”* me të cilin kanë ofertuar, e cila sjell si pasojë që kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. Një fenomen i tillë tregon për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë në momentin e lidhjes së kontratës.

Konkluzion:

-Planifikimi i nevojës për prokurimin e procedurës *“Shpenzime për qiramarrje automjeti”* është i pabazuar dhe i pa justifikuar, pasi ka lindur si rezultat i argumentimit të pabazuar të kërkesës nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, për mos garanci teknike të mjetit të Titullarit të institucionit me targë A., procedurë e kryer brenda periudhës së afatit të garancisë së automjetit të riparuar realizuar me procedurën e prokurimi *“Shërbim riparim automjeti për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”*, për të cilin ka deklaruar garancie jo më pak se 6 muaj nga data e kryerjes së shërbimeve, lëshuar nga OE fitues, për të cilën është kryer shpenzimi në vlerën 1,176 mijë lekë me TVSH. Vlera e marrjes me qira të automjetit 1,152 mijë lekë me TVSH, përbën shpenzim të pajustificuar dhe pa ekonomikitet për buxhetin e ish Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

-Në procedurat e prokurimit “blerje me vlerë të vogël” evidentohet se grupi i ngritur për marrjen në dorëzim nuk rezulton në përfundim me kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit *“Sistem dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”* për vitet 2023-2024 evidentohet në tre raste të audituara, vihet re tërheqja e operatorëve ekonomik fitues në fazën e lidhjes së kontratës, me pretendimin se *“ka ndryshuar çmimi”* me të cilin kanë ofertuar, e cila sjell si pasojë që kontrata të lidhet me OE të renditur më pas, me një vlerë më të lartë. Një fenomen i tillë tregon për ekzistencën e marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë në momentin e lidhjes së kontratës.

2.6 Te tjera, e vlerësim të rregullshmërisë në nxjerrjen e akteve të brendshme rregullatorë, që i shërbejnë kryerjes së veprimtarisë së ISH MTM-së, si dhe çështje që mund të dalin gjatë auditimit.

Ligji nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, ka qëllim të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës për vizitorë vendas e të huaj, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse të sotme dhe të brezave të ardhshëm. Neni 31 i Ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin” përcakton mbështetjen financiare për projektet turistike. Ministria përgjegjëse për turizmin harton programe që përputhen me objektivat e ligjit, duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e destinacioneve turistike. Fondet buxhetore financojnë projekte edukimi, promovimi dhe studime, të paraqitura nga individë dhe subjekte juridike, vendas e të huaj. Ky fond nuk i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik. Projektet që kërkojnë mbi 50% të fondit vjetor miratohen nga Këshilli i Ministrave. Përzgjedhja e projekteve bëhet nga një komision i përbërë nga zyrtarë dhe përfaqësues të sektorit të turizmit, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteret dhe afatet për propozimet financiare përcaktohen po ashtu me vendim të Këshillit të Ministrave.

Lidhur me procedurat për përfitimin e mbështetjes financiare në fushën e turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka zbatuar procedurat, kriteret dhe afatet e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”. Ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, privatë ose publikë. Ministria përzgjedh projektet në fushën e turizmit, duke vlerësuar ndikimin social, mjedisor dhe ekonomik të tyre. Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin. Projektet të cilat kërkojnë një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (pika 4, VKM Nr.281/2016).

Ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, miraton projektet turistike që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Nuk mund të marrin pjesë në këtë komision personat që kanë konflikt interesi me aplikuesit, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit. (pika 11, VKM Nr.281/2016).

Për vitin 2024 programi “Zhvillimi i Turizmit” u realizua 814,057 mijë lekë ndaj fondeve totale të planifikuara **846,245 mijë lekë**, ose u realizua në masën 96% për produktet **si me poshtë:**

Shpenzime korente sipas programit buxhetor 2024 (në mijë lekë)

Kodi produktit	Totali shpenzimeve korente	Viti paraardhës 2023 (Shpenzime faktike)	Periudha raportuese 2024					
			Plani fillestar vjetor	Plani i rishikuar	Ndryshimi i planit	Shpenzime faktike te periudhës (progresiv)	Ndryshimi vjetor Plan /Fakt	% realizimit
92603AA	Akte ligjore/nënligjore	18,016	36,600	23,100	(13,500)	20,493	2,607	89%
92603AB	Monitorime te kryera gjatë vijës bregdetare	111,582	123,600	140,190	16,590	135,131	5,059	96%
92603AC	Turizëm i promovuar	86,719	93,920	75,175	(18,745)	74,049	1,126	99%
92603AF	Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit	167,388	250,000	200,000	(50,000)	180,701	19,299	90%
92603AG	Projekte për financimin e turizmit te financuara	102,842	150,280	150,280	-	146,839	3,441	98%
92603AH	Aktivitete per evente dhe promovime turizmit	29,997	-	-	-	-	-	-
92603AI	Panairi Turizmit ITB Berlin	-	180,000	257,500	77,500	256,844	1,126	99.7%
	Shpenzime korrente 2024	516,545	834,400	846,245	11,845	814,057	32,658	96%

- ✓ Produkti “Akte ligjore/nënligjore” rezulton me mosrealizim 2,607 mije lekë ose realizuar 89 %.
- ✓ Produkti “Monitorime te kryera gjatë vijës bregdetare” rezulton me mos realizim 5,059 mije lekë ose realizuar 96 %.
- ✓ Produkti “Turizëm i promovuar” rezulton me mosrealizim 1,126 mije lekë ose realizuar 99 %.
- ✓ Produkti “Bashki të mbështetura për pastrimin e bregdetit” rezulton me mosrealizim 19,299 mije lekë ose realizuar 90%.
- ✓ Produkti “Projekte për financimin e turizmit të financuara” rezulton me mosrealizim 3,441 mije lekë ose realizuar 98%.
- ✓ Produkti “Panairi Turizmit ITB Berlin” rezulton me mosrealizim 1,126 mije lekë ose realizuar 90.7%.

Për auditim u përzgjedhën 2 (dy) produktet përkatësisht:

- Produkti me kod 92603AI “*Panairi Turizmit ITB Berlin*” dhe
- Produkti me kod 92603AG “*Projekte për financimin e turizmit të financuara*”;

✚ Produkti me kod 92603AI “Panairi Turizmit ITB Berlin”.

Në zbatim të nenit 69 të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, dhe në kuadër të angazhimit për prezantimin e Shqipërisë si “vend pritës” në panairin ndërkombëtar ITB Berlin 2025, është nënshkruar “Marrëveshja e vendit pritës” midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe kompanisë ndërkombëtare Messe Berlin GmbH. Procesi ka kaluar disa faza: shprehjen e interesit (qershor 2023), zhvillimin e takimeve me përfaqësues të Messe Berlin (korrik 2023), nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit që i dha Shqipërisë statusin për të negociuar termat konkretë dhe përmbajtjen e bashkëpunimit, si dhe përgatitjen për kontratën zyrtare brenda marsit 2024. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Turizmit ka përgatitur dokumentacionin përkatës (memorandumin, statusin ligjor të Messe dhe marrëveshjen kontraktore) dhe ka rekomanduar ngritjen e një strukture të posaçme për menaxhimin e procesit. Me urdhër nr. 308, datë 13.10.2023, u ngrit grupi i punës i drejtuar nga znj. L. B. A. me anëtarë përfaqësues nga MTM dhe AKT, ndërsa për nënshkrimin e memorandumit në nëntor 2023 u delegua kompetenca te znj. B, znj. H. D. dhe znj. E. Z.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrit nr. 308/2023 zhvilloi mbledhjen e datës 19.10.2023, ku u përcaktuan hapat procedurale për përfaqësimin e Shqipërisë si “vend pritës” në ITB Berlin 2025. Në përfundim, grupi miratoi propozimin për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me kompaninë MESSE Berlin GmbH, në bazë të ligjit nr. 93/2015 “Për Turizmin”, dhe ia paraqiti atë për miratim Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit. Me urdhër nr. 325, datë 31.10.2023, Ministri delegoi kompetencën për nënshkrimin e Memorandumit të zv.ministrja V. B. Më tej, Drejtoria e Programeve të Turizmit kërkoi informacion mbi fondet në dispozicion për vitet 2024–2025, ndërsa me shkresë të datës 01.03.2024 u sqarua se marrëveshja me MESSE Berlin është një akt teknik me kompani private, dhe si e tillë nuk konsiderohet marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit nr. 43/2016. Marrëveshja u nënshkrua më 6 mars 2024 gjatë ITB Berlin 2024, duke i dhënë Shqipërisë statusin ekskluziv të “vendit pritës” për edicionin 2025 dhe duke përcaktuar bashkëpunimin në tre shtylla kryesore: marketing, evente dhe shtyp, si dhe sponsorizime e reklamim.

Me memo nr. 4553, datë 08.07.2024, Titullari u informua për përmbushjen e angazhimit të Shqipërisë si vend pritës në ITB Berlin 2025, në bashkëpunim me Messe Berlin GmbH, çka i jep vendit mundësinë të promovohet gjatë një viti të plotë para një audience ndërkombëtare të specializuar në turizëm. Agjencia Kombëtare e Turizmit, nën sloganin “Albania All Senses”, do të realizojë aktivitetet e parashikuara në marrëveshje – përfshirë reklamimin, ndërtimin e stendës, ceremoninë e hapjes, darkën zyrtare dhe komunikimin publik – përmes kontratave specifike me Messe Berlin dhe filialet e saj. **Ndërkohë, me ndryshimet e ligjit nr. 93/2015**

“Për turizmin”, të bërë me ligjin nr. 30/2024, është parashikuar që Ministria dhe AKT të financojnë projekte me rëndësi të veçantë që tejkalojnë 50% të fondit vjetor për projekte.

Në zbatim të këtij ndryshimi, është miratuar VKM nr. 648, datë 16.10.2024, që përcakton procedurat dhe kriteret për financimin e këtyre veprimtarive në fushën e turizmit.

Në zbatim të VKM nr. 648/2024, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit me urdhër nr. 386, datë 21.10.2024, ngriti Kolegjiumin përgjegjës për zhvillimin e projektit ndërkombëtar ITB Berlin 2025. Më pas, me urdhër nr. 396, datë 24.10.2024, Ministri delegoi Sekretares së Përgjithshme, znj. L. B. A., kompetencën për nënshkrimin e kontratave me Messe Berlin GmbH, filialet e saj dhe subjektet fituese të procedurave të lidhura me përfaqësimin e Shqipërisë si vend pritës në ITB Berlin 2025.

Në vijim, Kolegjiumi zhvilloi tre procedura për realizimin e shërbimeve dhe lidhi kontratat:

- 1- me “P.” shpk për konceptin dhe dizajnin e ceremonisë së hapjes 50,214,000 lekë;
- 2- me “D.” shpk për dizajnin e standës 16,947,161 lekë;
- 3- me “O.” shpk për materialet promovuese audiovizuale e vizuale 36,240,000 lekë.

Buxheti i Planifikuar.

Sa i takon angazhimit të MTM, lidhur me prezantimin e Shqipërisë si vend pritës në panairin ndërkombëtar të turizmit ITB Berlin 2025, projekt i cili zhvillohet gjatë viteve 2024-2025, respektivisht janë planifikuar fonde buxhetore si me poshtë vijon:

Për vitin buxhetor 2024:

Në kuadër të vitit buxhetor 2024, në PBA 2024–2026 dërguar MFE-së me shkresën nr. 5350/1 prot., datë 30.08.2023, janë kërkuar 350,000,000 lekë për vitin 2024 dhe 100,000,000 lekë për vitin 2025 për produktin “Panairi i Turizmit ITB Berlin 2025”. Sipas Ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” dhe shkresës së MFE nr. 496/1 prot., datë 29.01.2024, në programin “Zhvillimi i Turizmit” janë miratuar 180,000,000 lekë për vitin 2024 (80,000,000 lekë në llogarinë 602 dhe 100,000,000 lekë në 604) dhe 100,000,000 lekë për vitin 2025 në llogarinë 604. Pas alokimeve të brendshme dhe shtesave sipas AN nr. 3, datë 28.04.2024, buxheti final për 2024 u bë 257,500,000 lekë (157,500,000 lekë në llogarinë 602 dhe 100,000,000 lekë në 604). Më pas, me shkresën nr. 3524 prot., datë 27.05.2024, MFE-së iu kërkuar një shtesë prej 60,000,000 lekësh për produktin “Panairi i Turizmit ITB Berlin”.

Realizimi i produktit “Panairi Turizmit ITB Berlin 2025” në vitin buxhetor 2024 është buxhetuar dhe realizuar si me poshtë vijon:

Realizimi i produktit “Panairi i Turizmit ITB Berlin 2025” deri 31.12.2024

Nr.	Buxhet 2024-programi 04760	Llog. Ekon.	Përshkrimi	Vlera Euro	Pagesa ne leke	Pagesa nga Llog. 602	Pagesa nga Llog. 604
1	157,000,000	602	Shpenzime per ITB Berlin 2025	425,000	42,563,926	42,563,926	
2	100,000,000	604	Tarifa e vendit pritës	950,000	94,525,000	94,525,000	
3			Qira e hapësirës së standës -Messe	159,180	15,918,000	-	15,918,000
4			Qira për prodhim reklamim -Messe	440,000	44,510,286	12,158,286	32,352,000
5			Paketa e Komunikimit-Messe	76,650	7,626,675	7,626,675	-
6			Kontrata PIK-koncepti dhe dizajni i ceremonisë së hapjes	251,000	25,107,000	-	25,107,000
7			Kontrata Dixhi-print-Konceptimi dhe dizajni i standës	84,700	8,473,580	-	8,473,580
8			Kontrata Optima-realizimi i videove dhe fotove	181,000	18,120,000	-	18,120,000
	250,000,000			2,567,530	256,844,467	156,837,887	99,970,580

Pagesat e realizimi i produktit “Panairi Turizmit ITB Berlin 2025” janë kryer me Urdher shpenzim nr. 89/2024; nr. 771/2024; nr. 775/2024; nr.776/2024; nr. 777/2024; nr.806/2024; nr.854/2025; nr. 859/2025 **në total 256,844,467 lekë**, nga te cilat 156,837,887 lekë janë nga llogaria 602 dhe llogaria 604.

Nga auditimi rezultoi se:

Në vijim të procedurës së pjesëmarrjes së Shqipërisë në cilësinë e vendit pritës në ITB Berlinit 2025, grupi i punës i ngritur me Urdhër nr. 308, datë 13.10.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e hapave procedurave në kuadër të përfaqësimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si “Host Contry” në ITB Berlin 2025”, Grupi i Punës ka mbajtur Proces verbal me datë 19.10.2023. Në këtë proces verbal grupi i punës **ka evidentuar** se citojmë: “Procedura që do të ndiqet për Komisionimin e Shqipërisë si “Vendi Pritës” në ITB Berlin 2025 (në terma kontraktuale dhe financiare, do të bazohet në ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, konkretisht në kreun V, neni 31, pika 5 “*Projektet, të cilat kërkojnë një financim, që arrin mbi 50 për qind të fondit vjetor të parashikuar për projektet turistike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Në përfundim të takimit u dakortësua në mënyrë kolegjiale në favor të nënshkrimit të Memorandumit, si dhe e propozon për miratim pranë Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Për vitin 2024 për produktin me kod 92603AG “*Projekte për zhvillimin e turizmit të financuara*” janë miratuar fonde me vlere **150,280,000** lekë, ndërsa në produktin me kod 92603AI “Panairi Turizmit ITB Berlin 2025”, janë miratuar fonde totale në **257,500,000 lekë** (157,500,000 lekë në llogarinë 602 dhe 100,000,000 lekë në llogarinë ekonomike 604).

Në zbatim të pikës 5, të nenit 31 “*Mbështetja financiare në fushën e turizmit*”, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” (sipas ligjit në fuqi nr. 101/2018, datë 13.12.2018) përcaktohet se “*Projektet, të cilat kërkojnë një financim, që arrin mbi 50 për qind të fondit vjetor të parashikuar për projektet turistike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave*”. Raporti i produktit i fondit vjetor të produktit me kod 92603AI “*Panairi Turizmit ITB Berlin*” në vlerë **180.000.000 lekë** kundrejt totalit të fondit vjetor për projekte, në vlerën **150.280.000 lekë**, rezulton 120% ose mbi pragun 50% të kriterit ligjor. **Ky raport tejkalohe mbi 50% edhe me planin e rishikuar të buxhetit.**

Shpenzime korente sipas programit buxhetor 2024

Kodi produktit	Totali shpenzimeve korente	Viti paraardhës 2023	Periudha raportuese 2024	Plani i rishikuar	Ndryshimi i planit	Shpenzime faktike te periudhës (progresive)	Ndryshimi vjetor Plan /Fakt	% e realizmit
		Shpenzime faktike	Plani fillestar vjetor					
92603AG	Projekte për financimin e turizmit të financuara	102,841,600	150,280,000	150,280,000	-	146,838,790	3,441,210	98%
92603AI	Panairi Turizmit ITB Berlin	-	180,000,000	257,500,000	77,500,000	256,844,457	655,543	99.75%
	Shpenzime Korrente 2024	102,841,600	330,280,000	407,780,000	77,500,000	403,683,247	4,096,753	99%
	Kriteri mbi 50% miratim me VKM		120%	171%	fondi faktik 2024	175%		

(Burimi: ISH MTM, Punoi KLSH)

Në vijimësi në kuadër të amendimit të Ligjit nr. 93/2015 “*Për turizmin*”, i ndryshuar me Ligjin nr. 30/2024, datë 04.04.2024 është **ndryshuar edhe neni 31**, lidhur me financimin e projekteve dhe veprimeve në fushën e turizmit. Në nenin 31 pika 1 është shtuar edhe shkronja “b”, sipas të cilës Ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit financojnë nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit, që konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 50% të fondit vjetor për projekte. Në zbatim të pikës 4 të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2024, datë 4.4.2024 është miratuar VKM nr. 648, datë 16.10.2024 “*Për miratimin e procedurave dhe kriterëve që ndiqen për financimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit që konsiderohen të rëndësishme së veçantë*”.

Në zbatim të VKM 648/2024 Ministri me Urdhër nr. 386, datë 21.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e Kolegjiumit, në funksion të zhvillimit të projektit ndërkombëtar të turizmit, ITB Berlin 2025 të cilët ngarkohen i cili në vazhdimësi ka ndjekur procedurat e zhvillimit të projektit.

Konkluzion: Ligjvënësi për zbatimin e zbatimit të pikës 5, të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015 “*Për turizmin*”, në pikën 1 të nenit 75 të këtij ligji, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim (pikës 5 të nenit 31).

Por gjatë periudhës së zbatimit të këtij ligjit, deri në ndryshimet me Ligjin nr. 30/2024, datë 04.04.2024 **Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë akt nënligjor** për zbatimin e pikës 5 të nenit 31.

Në zbatim të pikës 5, të nenit 31 “*Mbështetja financiare në fushën e turizmit*”, të Ligjit Nr. 93/2015 “*Për turizmin*” (sipas Ligjit në fuqi Nr. 101/2018, datë 13.12.2018) përcaktohet se “Projektet, të cilat kërkojnë një financim, që arrin mbi 50 për qind të fondit vjetor të parashikuar për projektet turistike, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”. Raporti i produktit i fondit vjetor të produktit me kod 92603AI “*Panairi Turizmit ITB Berlin*” në vlerë 180.000.000 lekë kundrejt totalit të fondit vjetor për projekte, në vlerën 150.280.000 lekë, rezulton 120% ose mbi pragun 50% të kriterit ligjor. **Ky raport tejkalohe mbi 50% edhe me planin e rishikuar të buxhetit.** Në vijim të procedurave dhe akteve të nxjerra nga MTM dhe në referencë të Ligjit nr. 93/2015 “*Për turizmin*”, në datën 06.03.2024 është nënshkruar Marrëveshja e vendit pritës, midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe entitetit MESSE Berlin GmbH, mbi angazhimin e Shqipërisë si “Vendi pritës”, në panairin ndërkombëtar të turizmit ITB Berlin 2025, me një kosto buxhetore për vitin 2024 në shumën 257,500,000 lekë, e realizuar 256,844,457 lekë ose 99.75%.

Në mungesë të aktit nënligjor për zbatimin e pikës 5 të nenit 31 të Ligjit nr. 93/2015 2015 “*Për turizmin*” **financimi, është kryer pa miratimin e Këshillit të Ministrave**, ndonëse shuma e financuar tejkalon 50% të fondit vjetor të parashikuar për financimin e turizmit.

Produkti me kod 92603AG “Projekte për zhvillimin e turizmit te financuara”.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit sipas kriterëve ligjore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi në turizëm, duke: a) **mbuluar deri në 50%** të kostove të pranuar, bazuar në kriteret e përcaktuara nga VKM nr. 281, datë 13.04.2016; b) ndërsa projektet që kërkojnë financim mbi këtë përqindje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 4 të këtij vendimi (deri ne date 04.04.2024 ndryshimi nenit 31 të ligjit 93/2016, por jo vetëm).

Në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 93/2015 “*Për Turizmin*”, financimi i projekteve në këtë sektor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik. Kjo qasje synon të lehtësojë aksesin në mbështetje financiare për individët dhe subjektet e interesuara, duke mundësuar fleksibilitet më të madh në zbatimin e projekteve turistike.

Për vitin 2023 ISH MTM ka financuar:

✓ **në thirrjen e parë ka financuar** 25 projekte në shumën 71,540,000 lekë, për të cilat ka likuiduar këstin e parë 30% në shumën 18,762,000 lekë dhe këstin i dytë 70% në shumën 43,778,000 lekë;

✓ **në thirrjen e dytë ka financuar** 8 projekte në shumën 43,000,000 lekë, për të cilat ka likuiduar këstin e parë 30% në shumën 12,900,000 lekë dhe këstin i dytë 70% në shumën 30,085,600 lekë;

Per vitin 2024 ka financuar 38 projekte në shumën 128,192,500 lekë, për të cilat ka likuiduar këstin e parë 30% në shumën 38,442,750 lekë dhe këstin i dytë 70% në shumën 89,684,750 lekë;

I. Fokusi i thirrjes për aplikim.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në zbatim të misionit dhe vizionit të saj strategjik, si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 93/2015 “*Për turizmin*”, i ndryshuar, dhe kuadrit nënligjor në fuqi, synon nxitjen e zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, të përgjegjshëm dhe gjithëvjetor në Shqipëri. Kjo bëhet përmes promovimit inovativ të destinacioneve dhe vlerave natyrore, kulturore e historike të vendit. Ministria financon, nga fondi buxhetor vjetor, projekte të edukimit, promovimit dhe studime që shërbejnë për zhvillimin e ofertës turistike, të paraqitura nga subjekte fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj. Mbështetja synon të forcojë një turizëm të diversifikuar, përfshirë turizmin bregdetar, malor, rural, natyror, sportiv, gastronomik dhe atë

të trashëgimisë kulturore shqiptare. Njëpërmjet kësaj thirrjeje për aplikim, synohet rritja e vlerës së Shqipërisë si një destinacion mikpritës, autentik dhe tërheqës në rajon dhe më gjerë, duke kontribuar në zhvillimin e potencialeve ekonomike, natyrore dhe sociale të vendit.

II. PROCEDURA

Mbështetur në nenet 9, 31 dhe 32 të Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, procedura e aplikimit për mbështetje financiare zhvillohet në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në aktet nënligjore si më poshtë:

- VKM nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të afateve të kërkesë-propozimeve për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”.
- VKM nr. 325, datë 31.05.2018, i ndryshuar me VKM nr. 121, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”.

Mbështetje Financiare për projektet në fushën e turizmit.

Për vitin 2023

ISH MTM ka realizuar “Thirrjen e Parë” me tematikë: “Promovimi i destinacioneve dhe zhvillimi i produkteve turistike në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik 2023” (përfshirë turizmin malor, natyror, kulturor, tradicional, kulinar, ekoturizëm, nostalgjik, aventurës etj.) Afati i aplikimit: 23.01.2023 – 21.02.2023. Periudha e realizimit të projekteve: 01.03.2023 – 15.11.2023.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve të Turizmit, me shkresë nr. 511, datë 23.01.2023 i ka propozuar për miratim Titullarit të ISH MTM, përcaktimin e kriterëve dhe afateve të kërkesë-propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”. Në zbatim të procedurës Ministri ka nxjerrë:

- Urdhër nr.20, datë 23.01.2023 “Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitim të mbështetjes financiare”;
- Urdhër nr.21, datë 23.01.2023 “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”;
- Urdhër nr. 73, datë 02.03.2023 “Për miratimin e projekteve për mbështetje financiare”.
- Urdhër nr. 58, datë 07.02.2022 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

Konkluzion: Nga auditimi rezulton se Kontratat për mbështetje financiare në fushën e turizmit për thirrjen e parë të vitit 2023, janë nënshkruar nga znj. L.B., autorizuar me Urdhër Ministri nr. 58, datë 07.02.2022.

Urdhëri i Ministrit nr. 58, datë 07.02.2022 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, i shtrin efektet e delegimit me subjektet fituese të thirrjes financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2022. Nga pikëpamja administrative, ky urdhër ka humbur fuqinë ligjore dhe nuk duhet përdorë si dokument autorizues për nënshkrimin dhe realizimin e kontratave për thirrjen e parë në vitin 2023, veprime në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Thirrja e Dytë: me tematikë “Zhvillimi dhe promovimi i destinacioneve, produkteve të diversifikuara të ofertës turistike dhe mjedisore”. Afati i aplikimit: **22.05.2023 – 20.06.2023**. Periudha e realizimit të projekteve: 07.07.2023 – 15.11.2023

Në zbatim të procedurës të thirrjes së dytë Ministri ka nxjerrë:

- Urdhër nr. 164, datë 22.05.2023 “Për disa shtesa në urdhërin nr. 21, datë 23.01.2023 “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”;
- Urdhër nr. 165, datë 22.05.2023 “Për miratimin e formularit dhe procedurave për përfitim të mbështetjes financiare”;
- Urdhër nr. 221, datë 26.06.2023 “Për miratimin e projekteve për mbështetje financiare”.

-Urdhër nr. 220, datë 26.06.2023 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, për vitin 2023.

III. VLERËSIMI I KËRKESË PROPOZIMEVE:

Vlerësimi kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave:

Për thirrjen e parë sipas VKM-së nr. 325, datë 31.05.2018 “Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në turizëm”,

Për thirrjen e dytë: Nr. 121, datë 01.03.2023 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 325 datë 31.05.2018 ‘Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm’”.

Procesi i përzgjedhjes së kërkesë propozimeve u krye në fazat e mëposhtme:

- Vlerësimi i personit fizik/juridik dhe dokumentacionit të dorëzuar për plotësimin e kriterëve;
- Vlerësimi i përmbajtjes së projektit për subjektet që kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë.

Afatet për thirrjen e parë: Klasifikimi dhe përzgjedhja e projekteve në fushën e turizmit nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve, u zhvillua brenda 10 ditë pune, pas përfundimit të afatit 30 ditor. Me tej u bë miratimi i projekteve nga Ministri, pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, i zhvilluar brenda 3 ditë pune. Njoftimi dhe nënshkrimi i kontratës me fituesit e projekteve, është zhvillohet brenda 2 ditëve pune, pas miratimit nga Ministri.

Afatet për thirrjen e dytë: Komisioni ka klasifikuar dhe përzgjedhur projektet në fushën e turizmit brenda 5 (pesë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesë propozime për mbështetje financiare. Ministri, brenda 3 (tre) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, ka miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim. Nëse kërkesë propozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga Ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit brenda 5 (pesë) ditëve për nënshkrimin e kontratës. Nënshkrimi i kontratës u krye nga SP i autorizuar prej Ministrisë. pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të projektit, kryhet procesi i monitorimit të realizimit të projektit të përzgjedhur, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

IV. Financimi:

Për vitin 2023

Thirrja për përfitimin e mbështetjes financiare, në kuadër të zhvillimit të programeve në fushën e turizmit, financohet nga fondi buxhetor i miratuar për vitin kalendarik 2023.

Në zbatim të Ligjit nr. 84/ 2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, janë miratuar fonde buxhetore në programin “Zhvillimi i Turizmit”, llogaria ekonomike 604, produkti me kod 92603AG “Projekte për zhvillimin e turizmit të financuara”, në vlerën **78,000,000 lekë**, sipas shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 2374/44 prot., datë 20.01.2023 “Dërgohet detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2023-2025”.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 293, datë 17.05.2023 “Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2023, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, është alokuar **fondi në vlerën 45,000,000 lekë** në programin “Zhvillimi i Turizmit”, llogaria ekonomike 604, produkti me kod 92603AG “Projekte për zhvillimin e turizmit të financuara”, sipas shkresës së MFE-së nr. 10285/2 prot., datë 15.06.2023, për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike në Turizëm, i destinuar për hapjen e thirrjes së dytë për vitin 2023.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet shkresës nr. 2431/1 Prot., datë 12.04.2023, drejtuar Ministrisë së Financave ka argumentuar nevojën për fonde shtesë si rrjedhojë e numrit të lartë të aplikimeve përgjatë thirrjes së parë të publikuar gjatë muajit Janar 2023, ku kanë aplikuar rreth 70 subjekte, nga të cilët janë përzgjedhur **vetëm 25 subjekte** me një buxhet total prej **71,5 milionë lekë** (të buxhetuara për vitin 2022). Zhvillimit të produktit turistik tematik dhe të ofertës së diversifikuar të destinacioneve dhe të potencialeve të larmishme turistike dhe kulturore, përfshirë turizmin natyror, sportiv, gastronomik, trashëgiminë dhe traditën pasur kulturore. Nxitjes së pjesëmarrjes së turistëve të huaj në përvojat shqiptare tradicionale dhe festat lokale, që stimulojnë rritjen e ekonomisë lokale, ofertës së diversifikuar të shërbimeve dhe produkteve turistike të ofruara nga rajonet shqiptare. Mbështetjes ndaj sipërmarrjeve turistike për krijimin e produkteve inovatore dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore për një shërbim më të mirë turistik, të standardizuar dhe gjatë gjithë vitit për zhvillimin e tregut të qëndrueshëm në industrinë e turizmit.

Për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e vitit 2023, në programin “Zhvillimi i Turizmit”, në artikullin 604, me aktin normativ Vendimi Nr. 293, datë 29.5.2023 i shtohet fondi prej 45,000,000 (dyzet e pesë milionë) lekë për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike në Turizëm, i destinuar për hapjen e thirrjes së dytë për vitin 2023.

Në **kuadër të thirrjes së dytë**, në funksion të sezonit turistik dhe në përputhje me tematikën “Për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, si dhe të produkteve të diversifikuara të ofertës turistike dhe mjedisore”, është paraqitur një kërkesë për shtesë buxhetore në masën 15,000,000 lekë, e cila synohet të mbulohet nga fondi i programit të mjedisit.

Monitorimi

Në mbështetje të nenit 31 të Ligjit 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar dhe VKM nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të aftave të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, Ministri me ka urdhëruar ngritjen e grupit të monitorimit të kontratave për mbështetje financiare në fushën e turizmit si më poshtë vijon:

- Me Urdhër me Nr. 69, datë 21.02.2023 “Për ngritjen e grupeve të monitorimit të kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, **për thirrjen e parë**, me përbërje: me përbërje znj. E. V. (Kryetar) me detyrë specialist, znj. I. L. me detyrë specialist në Drejtoria e Zhvillimit të Programeve në Turizëm.
- Me Urdhër me Nr.222, datë 23.06.2023 “Për ngritjen e grupit të monitorimit të kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, **thirrja e dytë**, me përbërje znj. A. B. (Kryetar) me detyrë përgjegjës sektori, znj. B. T. me detyrë specialist dhe znj. M. H. specialiste në Drejtoria e Zhvillimit të Programeve në Turizëm.

Konkluzion: Nga auditimi rezulton se Kontratat për mbështetje financiare në fushën e turizmit për thirrjen e parë të vitit 2023, janë nënshkruar nga znj. L. B., autorizuar me Urdhër Ministri nr. 58, datë 07.02.2022.

Urdhëri i Ministrit nr. 58, datë 07.02.2022 “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”, i shtrin efektet e delegimit me subjektet fituese të thirrjes financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2022. Nga pikëpamja administrative, ky urdhër ka humbur fuqinë ligjore dhe nuk duhet përdorur si dokument autorizues për nënshkrimin dhe realizimin e kontratave për thirrjen e parë në vitin 2023, veprime në kundërshtim me nenin 29 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Bashkëlidhur praktikave të realizimit të aktiviteteve dhe produkteve të projekteve në çdo rast pagesa shoqërohet me dokumentacion provues si kontrata për mbështetje financiare në fushën e turizmit e nënshkruar ndërmjet financuesit MTM dhe përfituesit të projektit; formulari i aplikimit; aneksi 2, raport i audituesit të pavarur, raporti financiar i përfituesit me anekset

përkatës, raport i realizimit të aktiviteteve dhe produkteve i konceptuar nga specialisti i Drejtorisë së promovimit të Turizmit që ndjek monitorimin e kontratës.

Ne raportet e realizimit të aktiviteteve, dhe dokumentacionin bashkëlidhur mungon gjurma e monitorimit të procesit të realizimit të aktiviteteve të projektit sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur kontratave, veprim në mospërputhje me pikën 3 të Urdhërit e Ministrit Nr.69, datë 21.02.2023 (thirrja e pare për vitin 2023) dhe Nr.222, datë 23.06.2023 (thirrja e dytë për vitin 2023), sipas të cilës: “3 Grupi i Monitorimit të Kontratave, monitoron procesin e realizimit të aktiviteteve të projektit sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur kontratave”.

Për vitin 2023 për auditim u përzgjedhën:

-Kontrata nr. 1636, dt 03.04.2023 me subjekt përfitues U. shpk me NIPT L.....P, fitues në projektin “Promovimi i Shqipërisë turistike në panairin e Berlinit”, koha e zbatimit nga 03.03.2023 deri 09.03.2023, MTM financon 30% datën e fillimit të kontratës dhe 70% do të paguhet në momentin e përfundimit të projektit, kundrejt kërkesës për pagesë të shoqëruar me faturën dhe raportin financiar përshkrues si dhe raportin përfundimtar të auditimit.

Me lidhjen e kontratës nuk është likuiduar parafinacimi, por me USH nr. 216, date 09.05.2023 është likuiduar vlera e plote 2,000,000 lekë ose 100%, mbështetur në fature tatimore, sipas nenit 7 të kontratës përfshirë edhe pjesën e papaguar të parafinacimit sipas nenit 5 pika 1 të kontratës. Praktika është shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur i cili konfirmon se pasqyrat financiare të transaksioneve japin një pamje të sinqerte në të gjitha aspektet materiale, raport financiar që paraqet shpenzimet direkte të projektit, fature tatimore nr. 53/2023, dt 07.04.2023 në shumen 2,000,000 lekë.

Relacioni firmosur nga grupi i monitorimit të kontratave i ngritur me urdhër nr. 69, datë 21.02.2023 “Për ngritjen e grupeve të monitorimit të kontratave”, firmosur nga znj. E. V., znj. M. H. specialiste në Drejtorinë e Zhvillimit të Programeve në Turizëm dhe znj. I. L. specialiste në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, duke kërkuar vendimmarrjen dhe vijimin e procedurave për financimin 100% në fazën e realizimit të plotë të projektit.

Pagesa:

USH	Dt USH	Financim nga ISH MTM	Shuma
216	09.05.2023	Promovimi i Shqipërisë turistike në panairin e Berlinit” 100%	2,000,000

-Kontrata nr. 1738, dt 08.03.2023 me subjekt përfitues “B.” shpk, me NIPT M.....R, fitues në projektin “Promovimi i destinacioneve dhe zhvillimi i produkteve turistike/ Dita e Verës- Eja në Elbasan”, koha e zbatimit nga 08.03.2023 deri 15.03.2023, MTM financon 30% datën e fillimit të kontratës dhe 70% do të paguhet në momentin e përfundimit të projektit, kundrejt kërkesës për pagesë të shoqëruar me faturën dhe raportin financiar përshkrues si dhe raportin përfundimtar të auditimit.

Me lidhjen e kontratës nuk është likuiduar parafinacimi, por me USH nr. 207, date 03.05.2023 është likuiduar vlera e plotë 7,000,000 lekë ose 100%, mbështetur në faturë tatimore është likuiduar 30 % parafinacim, sipas nenit 7 të kontratës përfshirë edhe pjesën e papaguar të parafinacimit sipas nenit 5 pika 1 të kontratës. Praktika është shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur i cili konfirmon se pasqyrat financiare të transaksioneve japin një pamje të sinqertë në të gjitha aspektet materiale, raport financiar që paraqet shpenzimet direkte të projektit, faturë tatimore nr. 100/2023, dt 31.03.2023 në shumen 7,000,000 lekë.

Relacioni firmosur nga grupi i monitorimit të kontratave i ngritur me urdhër nr. 69, datë 21.02.2023 “Për ngritjen e grupeve të monitorimit të kontratave”, firmosur nga znj. E. V., znj. M. H. specialiste në Drejtorinë e Zhvillimit të Programeve në Turizëm dhe znj. I. L. specialiste në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, duke

kërkuar vendimmarrjen dhe vijimin e procedurave për financimin në fazën e realizmit të plotë të projektit.

Pagesa:

USH	Dt USH	Financim nga ISH MTM	Shuma
207	03.05.2023	“Promovimi i destinacioneve dhe zhvillimi i produkteve turistike/ Dita e Verës- Eja në Elbasan” 100%	7,000,000

Për Vitin 2024:

Mbështetur në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, dhe pikës 8 të VKM 281/2016 “Për përcaktimin e afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, përcaktohet se nëpërmjet njoftimit në media dhe në website-in e ministrisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, publikohet çdo fillim viti thirrja publike për përfitimin e mbështetjes financiare, në kuadër të programeve për mbështetjen e projekteve në fushën e turizmit, nga fondi buxhetor i miratuar për vitin kalendarik.

Referuar VKM 325/20118 “Për përcaktimin e anëtareve të Komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”, i ndryshuar, dhe për shkak të vakancave me propozim të Ministrit të ISH MTM me Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 14.02.2024 “Për një ndryshim në vendimin Nr. 325 datë 31.05.2018 ‘Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm”, është ndryshuar përbërja e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm për shkak të vakancave në pozicionin e Drejtorit të Projekteve Zhvillimore të Turizmit dhe Drejtorit të Zhvillimit të Programeve të Turizmit, zëvendësohen me “Drejtori i Përgjithshëm Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse” dhe “Drejtori i Përgjithshëm për Zhvillimin e Turizmit”.

Lidhur me thirrjen për mbështetje financiare të projekteve në turizëm për vitin 2024 tematika u fokusua në “Promovimin e destinacioneve dhe zhvillimin e produkteve turistike në mbështetje të veprimtarive të sezonit turistik 2024”. Bazuar kuadrit ligjor të fushës, thirrja publike qëndroi e hapur për një afat 30 ditor. Shpallja e thirrjes për mbështetje financiare u hap nga data 15 Janar 2024 deri 13 Shkurt 2024, konform nenit 9 të VKM nr. 281/2016. Projektet duhet të realizohen brenda vitit buxhetor, nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 15.11.2024. Për sa më sipër deri në 13 Shkurt, në protokollin e MTM ja paraqitur 77 aplikime. Gjithashtu kanë mbërritur me poste 10 aplikime të tjera të cilat mbajnë datat 12.02.2024; 13.02.2024 dhe 14.02.2024.

Vlerësimi i projekteve kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm (KPPT) i ngritur me VKM 325/2018, i ndryshuar së fundmi me VKM 77/2024.

Në kuadër të këtij detyrimi ligjor, KPPT me Vendim nr. 1, datë 21.02.2024 “Për përzgjedhjen e projekteve në turizëm”, mbështetur në proces verbal të mbajtura në datat 20.02.2024 dhe 21.02.2024 ka kualifikuar fitues 38 projekte. Anëtarët e KPPT kanë plotësuar deklaratën mbi parandalimin e konfliktit të interesave (5 deklaratë/ 5 anëtarë).

Nga auditimit rezulton se anëtarja e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve znj. A. B. me deklaratën e datës 21.02.2024, deklaroi se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, me përjashtim të aplikimit të subjektit “Q”, për arsye të lidhjes familjare. Sa më sipër, tërhiqem nga vijimi i procedurave për vlerësimin e projektit të paraqitur nga ky subjekt.”

KPPT në mbledhjen e datës 21.02.2025, në proces verbalin nr. 2, datë 21.02.2024 konstatohet se anëtari i KPPT znj. A. B., ka konflikt interesi me subjektin “Q” (R. B.- person fizik) për arsye të lidhjes familjare, prandaj u vetëdeklarua dhe hoqi dorë nga vijimi i procedurave për vlerësimin e këtij projekti, ndërsa pjesa tjetër plotësuan formularët e deklaramit se nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe dispozitat e Ligjit nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

KPPT me vendimin nr. 1, datë 21.02.2024 “Për përzgjedhjen e projekteve në Turizëm”, në 38 subjektet e kualifikuara, nuk ka shpallur fitues subjektin “Q”, me NIPT M.....J,

Në fund të procedurës së përzgjedhjes së projekteve në turizëm, Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve , me shkresë nr. 1341/4 datë 21.02.2024, i propozon Ministrin për miratim listën e projekteve të kualifikuara.

Ministri, me Urdhër nr. 102, datë 26.02.2024 ka miratuar projektet e që rezultuan fituese dhe do të përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, sipas Aneksit nr.1 (38 projekte me fond buxhetor 128, 892,500 lekë), si dhe ka ngarkuar KPPT për publikimin në faqen zyrtare të MTM të listës së projekteve përfituese të financimit.

Ministri, me Urdhër nr. 113, datë 29.02.2024 *“Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2024”*, ka deleguar kompetencën e nënshkrimit të kontratave për Sekretaren e Përgjithshme znj. L. A.

Sa me sipër, Ministri në mbështetje të procedurës për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit ka nxjerrë:

- Urdhër nr. 102, datë 26.02.2024 *“Për miratimin e projekteve në turizëm që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit”*;
- Urdhër nr. 164, datë 22.05.2023 *“Për disa shtesa në urdhrin e ministrit nr. 21, datë 23.01.2023 “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve”*;
- Urdhër nr. 113, datë 29.02.2024 *“Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit për vitin 2024”*, ka deleguar kompetencën e nënshkrimit të kontratave për Sekretaren e Përgjithshme znj. L. A..

Ndryshimet ligjore në Ligjin “Për Turizmin” dhe Mbështetja Financiare e Projekteve.

Ligji nr. 93/2015 *“Për Turizmin”*, i ndryshuar i cili përbën bazën ligjore për zhvillimin dhe menaxhimin e sektorit të turizmit në Shqipëri, është përditësuar me disa ndryshime të rëndësishme në vitet e fundit, me qëllim përmirësimin e mekanizmave të mbështetjes dhe përfshirjes së aktorëve në këtë fushë.

Ndryshimet kryesore përfshijnë ndryshimet me Ligjin nr. 114/2017, datë 18.12.2017; Ligji nr. 101/2018, datë 13.12.2018; Ligji nr. 30/2024 datë 04.04.2024; Ligji nr. 99/2024 datë 12.09.2024. Këto ndryshime konsolidojnë më tej strukturën institucionale dhe procedurat për mbështetjen financiare të projekteve në turizëm, të trajtuara në Kreun V të ligjit. Kreu V *“Mbështetja Financiare e Projekteve në Fushën e Turizmit”* i Ligjit 93/2015 *“Për turizmin”* përfshin dispozitat për mënyrën e mbështetjes me fonde publike të projekteve në fushën e turizmit, përfshirë promovimin, edukimin, zhvillimin e produkteve turistike dhe nxitjen e turizmit të qëndrueshëm. Neni 31 përshkruan bazën ligjore për mbështetjen financiare të projekteve dhe objektivat që duhet të përmbushin këto iniciativa. Neni 31/1 *“Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga ministria përgjegjëse për turizmin”*, përcakton rolin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në vlerësimin dhe miratimin e projekteve që aplikojnë për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Neni 31/2 *“Kompetencat e kolegjiut në ministrinë përgjegjëse për turizmin”* është shtuar me ligjin nr. 30/2024, datë 04.04.2024. Ky nen vendos krijimin dhe funksionimin e një strukture të posaçme përkatësisht *“Kolegjiut të Turizmit”*, brenda ministrisë përgjegjëse, i cili ka kompetenca për vlerësimin teknik dhe përzgjedhjen e projekteve, si dhe për ndjekjen e zbatimit të tyre.

Udhëzim i Ministrit nr. 2, datë 28.5.2024

“Mbi kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë propozimet për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

Urdhëri Ministrit nr. 207, datë 10.6.2024

“Mbi miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të kolegjiut”.

Nga auditimit rezulton se:

Për vitin 2023 nënshkrimi i kontratave për subjektet fituese është realizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, në mungesë të delegimit të kompetencës nga Ministri MTM, **në kundërshtim me pikën 11 të VKM Nr. 281 datë 13.4.2016** *“Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të*

kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, ku përcaktohet se Ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve, miraton projektet turistike që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.

Monitorimi:

Në mbështetje të nenit 31 të Ligjit 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar dhe VKM nr. 281, datë 13.04.2016 “Për përcaktimin e kriterëve e të aftave të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, Ministri ka urdhëruar ngritjen e grupit të monitorimit të kontratave për mbështetje financiare në fushën e turizmit si më poshtë vijon:

- Urdhër nr. 114, datë 29.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit” për thirrjen e pare, për vitin 2024;
- Urdhër nr. 176, datë 03.05.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin e ministrit nr. 114, datë 29.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”;
- Urdhër nr. 333, datë 11.09.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin e ministrit nr. 114, datë 29.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratave për mbështetje financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

Për vitin 2024 për auditim u përzgjedhën:

-Kontrata nr. 1984, datë 18.03.2024 me subjekt përfitues H.. znj. G. D. person fizik, NIPT L.....N, fitues në projektin “Shqipëria në Izrael Travel Channel”, koha e zbatimit nga 21.03.2024 deri 30.09.2024, MTM financon 50% ose 1,000,000 lekë. Me lidhjen e kontratës me USH nr. 146, datë 21.03.2024, mbështetur faturë tatimore është likuiduar 30 % parafinancim, sipas nenit 7 të kontratës.

Praktika është shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, CD me fotot dhe video, faturë tatimore. Dokumentacion shoqërues mbështet shpenzimet sipas zërave. Specialistja e Drejtorisë së Promovimit të Turizmit, ka hartuar raport realizimi nr. 1984/3, dt 18.12.2024, konceptuar nga M. H. duke kërkuar vendimmarrjen dhe vijimin e procedurave për financimin 70%.

Pagesa:

USH	Dt USH	Financim nga ISH MTM	Shuma
146	21.03.2024	G., 30% parafinancim projekti "Shqipëria në Travel Channel"	300,000
813	23.12.2024	G., 70% pr "Shqipëria në Travel Channel"	700,000
		Totali	1,000,000

-Kontrata nr. 2399, datë 08.04.2024, me subjekt fitues shoqata “V.”, OJF, me NIPT M.....D, për realizimin e projektit “Himara International Music (edicioni III)”. Praktika është shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, CD me fotot dhe video. Dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave, raport realizimi nr. 2399/3, dt 13.11.2024 konceptuar nga E. V. specialiste e Drejtorisë së Promovimit të Turizmit, paguar 30%+70%.

USH	Dt USH	Finacim nga ISH MTM	Shuma
398	12.06.2024	V..., parafinancim pr "Himara International <Music"edicioni III	300,000
755	04.12.2024	V..., Likujdim 70% "Himara International Music" edicioni III	700,000
			1,000,000

-Kontrata nr. 798, datë 18.02.2024, me subjekt fitues shoqata “Q.”, OJF, me NIPT L.....P, për realizimin e projektit “Zhvillimi i Turizmit në zonën Fushë Arrëz –Pukë, nëpërmjet promovimit të shtegut turistik Fushë Arrëz-Bicaj-Mali Korabit dhe fuqizimit të komunitetit lokal (RurAIB)”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 1795/4, dt 16.12.2024, raport auditit dt 23.10.2024, raport financiar dt raportin e audituesit te pavarur, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

US H	Dt USH	Finacim nga ISH MTM	Shuma
186	17.04.2024	Q., parafinancim pr "Zhvillimin e turizmit në zonën Fushë-Arrëz"	150,000
798	18.12.2024	Q., 70%pr "Zhvill.turizmit në zonën F. Arrëz-Pukë"	350,000
		Totali	500,000

Kontrata nr. 1709 datë 01.03.2024, me subjekti fitues “B.” shpk, me NIPT M.....R, për realizimin e projektit “Për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve të diversifikuara të ofertës turistike në turizëm/ Dita e verës në Elbasan”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 1709/1, dt 02. 05.2024, konceptuar nga B. C., specialistit në Drejtorinë e Jetësimit të prioriteteve dhe Statistikave, raport auditit, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

USH	Dt USH	Finacim nga ISH MTM	Shuma
132	20.03.2024	B., 30% parafinancim projekti "Promovim destiancioneve prod turistike, Dita e Verës Eja në Elbasan"	2,460,000
272	09.05.2024	B., 70% projekti "Promovim destiancion prod.turistike, Dita e Verës Eja në Elbasan"	5,740,000
		Totali	8,200,000

Kontrata nr. 1795 datë 07.03.2024, me subjekti fitues “Q.”, OJF, me NIPT L.....P, për realizimin e projektit “Zhvillimi i turizmit në zonën Fushë –Arrëz-Pukë, nëpërmjet promovimit të shtegut turistik Fushë -Arrëz-Bicaj-Mali Krrabit dhe fuqizimit të komunitetit lokal”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 1795/4, dt 16.12.2024, konceptuar nga E. S., specialiste Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, raport auditit, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

US H	Dt USH	Finacim nga MTM	Shuma
186	17.04.2024	Q., parafinancim pr "Zhvillimi turizmit në zonën Fushë-Arrëz"	150,000
798	18.12.2024	Q., 70%pr "Zhvill.turizmit në zonën F.Arrëz-Pukë"	350,000
		Totali	500,000

Kontrata nr. 2249 datë 29.03.2024, me subjekti fitues “L.”, person fizik, me NIPT K.....U, për realizimin e projektit “Kostumografia një atraksion i çmuar turistik”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 2249/2, dt 16.12.2024, konceptuar nga E. T, specialiste e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Turizmit, raport auditit, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

USH	Dt USH	Finacim nga MTM	Shuma
175	05.04.2024	L., parafinancim pr "Kostumografia një atraksion i cmuar turistik"	210,000
799	18.12.2024	L.,70% pr "Kostumografia, një atraksion i çmuar turistik"	490,000
		Totali	700,000

L91910453M, për realizimin e projektit “Vjosa Wild River”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 2249/2, dt 16.12.2024, konceptuar nga E. N., specialiste, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, raport auditit, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

USH	Dt USH	Finacim nga ISH MTM	Shuma
313	15.05.2024	M., parafinancim pr "Maratona Vjosa Wild Rivier,"	300,000
814	23.12.2024	M. OJF ,70% pr. "Maratona Vjosa Wild River"	700,000
		Totali	1,000,000

Kontrata nr. 2562 datë 1604.2024, me subjekti fitues “Q.”, OJF, me NIPT L.....P, për realizimin e projektit “Tregojmë Historinë Tonë”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 2562/4, dt 03.12.2024, konceptuar nga F. B., specialiste, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, raport auditimi, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

USH	Dt USH	Finacim nga ISH MTM	Shuma
197	18.04.2024	Q., parafinancim pr "Tregojmë historinë tonë"	450,000
758	05.12.2024	Q., likujdim 70% pr "Tregojmë historinë tonë"	1,050,000
		Totali	1,500,000

Kontrata nr. 1690 datë 01.03.2024, me subjekti fitues “Q.”, OJF, me NIPT L.....I, për realizimin e projektit “Albania All Inclusive”. Praktika është shoqëruar me raport monitorimi nr. 1690/2, dt 03.11.2024, konceptuar nga B. T., specialiste, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Turizmit, raport auditit, raport financiar, lista e detajuar e shpenzimeve, foto dhe linqe mbi publikimin e materialeve, dokumentacion që mbështet shpenzimet sipas zërave etj.

Nga auditimi rezultoni se:

Udhëzimi i Ministrit Nr. 2, datë 28.5.2024 “Mbi kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë propozimet për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit ” dalë në zbatim të nenit 31/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, në pikën III. 5 përcakton: “5. Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve kryhet nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/ Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe/ apo drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Në përfundim të aktivitetit/ projektit, përgatitet relacioni i monitorimit nga grupi i monitorimit.”

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për mbështetjen financiare në fushën e turizmit ka lidhur kontratë individuale me secilin subjekt përfitues për financim në fushën e turizmit. Në kontratën e nënshkruar, në pikën 3 nenin 5 “Financimi dhe modalitetet e pagesës” ndërmjet te tjerash për pjesën e mbetur (70%) përcaktohet se: 3. Përpara kryerjes së pagesës “Grupi i monitorimit te kontratave” pranë financuesit përgatit raportin që miraton realizimin e aktiviteteve të projektit, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur kontratës. Ministri në cilësinë e Autoritetit Financues miraton kërkesën dhe urdhëron kryerjen e kontratës”. Në pikën 4 të nenin

6 Kontratës së Financimit përcaktohet se “4. *Procesi i monitorimit nga ana e “Financuesit” realizohet nëpërmjet grupit të monitorimit të kontratave të ngritura pranë “Financuesit”*”.

Në përputhje me Urdhrin nr. 114/2024, Ministri ka urdhëruar ngritjen e një Grupi Pune për monitorimin e kontratave që lidhen me mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit për projekte në fushën e turizmit, siç përcaktohet në Urdhrin nr. 102, datë 26.02.2024. Ky grup përfshin përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (ISH MTM), të specifikuar në Aneksin nr. 1, si dhe punonjës të Drejtorive Rajonale të Administratës së Zonave të Mbrojtura, të cilët caktohen rast pas rasti nga drejtuesit përkatës të AZKM-ve. Urdhëri i Ministrit nr. 114/2024 nuk përcakton qartë rolet, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të këtij grupi pune, duke lënë hapësirë për interpretim dhe nevojë për udhëzime shtesë për zbatimin efektiv të detyrave të tij.

Raporti i monitorimit të aktiviteteve të projektit (relacioni i realizimit) përgatitet dhe nënshkruhet nga personi përgjegjës, dhe jo nga grupi i monitorimit të kontratave. Për më tepër, raporti për çdo projekt nuk përmban gjurmë të bashkëpunimit me punonjësit e AZKM-ve, të ngarkuar me monitorimin e zbatimit për shoqërimin e informacionit me dokumentacion si fotografi, video apo botime që verifikojnë aktivitetet e kryera. Kjo praktikë është në kundërshtim me pikën III.5 të Udhëzimit të Ministrit nr. 2, datë 28.05.2024, që përcakton kriteret dhe afatet për kërkesë-propozimet për mbështetjen financiare në turizëm; pikën 4 të Urdhërit të Ministrit nr. 114/2024, dhe pikën 7, neni 6 të Kontratës/ve së Financimit, sipas të cilave një relacion monitorimi duhet përgatitur nga grupi i monitorimit në përfundim të aktivitetit/projektit.

Konkluzion: Në raportet e realizimit të aktiviteteve, dhe dokumentacionin bashkëlidhur mungon gjurma e monitorimit të kontratave të financimit të procesit të realizimit të aktiviteteve të projektit nga Grupi i Monitorimit të Kontratave sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur kontratave, veprim në mospërputhje me pikën nr. 3 të Urdhërit të Ministrit Nr.69, datë 21.02.2023 (thirrja e pare për vitin 2023) dhe Nr.222, datë 23.06.2023 (thirrja e dytë për vitin 2023) dhe Urdhërit të Ministrit nr. 114/2024 për thirrjen e vitit 2024.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave duke pasur parasysh:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar rezultoi se ka mungesë të gjurmëve të auditimit në disa procese kyçe të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, duke përfshirë mos mbajtjen e procesverbaleve dhe dokumentimin e vendimeve për mbledhjet e GMS/EMP dhe për ndarjen e detyrave, mos dokumentimin e hartës së proceseve dhe gjurmëve të auditimit brenda afateve ligjore, mungesën e gjurmëve të auditimit për përdorimin dhe dorëzimin e kredencialeve të sistemeve elektronike. Kjo situatë cenon integritetin, transparencën dhe gjurmën e vendimmarrjes, duke rritur rrezikun për mospërputhje ligjore dhe keqpërdorim të informacionit financiar e operacional në kundërshtim me nenin 16, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Titullarët e ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrin masa për unifikimin dhe standardizimin e dokumentimit dhe ruajtjes së gjurmëve të auditimit në të gjitha funksionet, proceset organizative dhe teknologjike, duke përfshirë mbledhjet, ndarjen e detyrave, hartën e proceseve, menaxhimin dhe administrimin e kredencialeve të sistemeve, si dhe përditësimin e faqes zyrtare të internetit. Gjithashtu, të krijohet një bazë e centralizuar e të dhënave statistikore, operacionale dhe financiare, me qëllim forcimin e transparencës publike, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe sigurimin e besueshmërisë së të dhënave financiare dhe operative.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kërkesave buxhetore të njësisë të varësisë të dërguara në MTM, rezultoi se:

-Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) për fazën e dytë të PBA 2023-2025 nuk ka dërguar kërkesa buxhetore, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 9 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” si dhe Udhëzimin e MFE nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, shtojca 3, pika 25.

-Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) nuk ka dërguar kërkesat buxhetore për fazën e I-rë të PBA 2024-2026, sipas formateve të kërkuara, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të MFE nr. 5 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”. Për këtë fazë, kjo agjenci ka dërguar vetëm kërkesë për planifikim TVSH për projektin “Rezervati Ndërkufitar i Biosferës së Prespës” në vlerën 8,030 mijë lekë me shkresën nr. 1232 prot., datë 03.04.2023.

-Lidhur me investimet me financim të huaj për të cilat MTM paguan TVSH, në disa raste evidentohet se këto projekte nuk janë të planifikuara në PBA, pasi kërkesa për likuidimin e TVSH-së nga donatori ka ardhur pas afatit të mbylljes së PBA-së përkatëse. Në këto raste nuk ka pasur koordinim, korrespondencë dhe nxitje bashkëpunimi nga zyrat përkatëse të ministrisë të lidhura me investimet e huaja për të arritur në parashikimin e kostos së TVSH-së përpara përfundimit të afatit të planifikimit të PBA. Mosparashikimi i vlerës së TVSH-së në afatin e duhur, sjell si pasojë rishikim të buxhetit në vijim të vitit buxhetor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Titullarët e ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, në bashkëpunim me njësitë e varësisë, të marrin masa për të siguruar që kërkesat buxhetore të PBA-ve përkatëse të paraqiten brenda afateve të përcaktuara dhe sipas formateve standarde të miratuara, me qëllim që të mbështetet procesi i planifikimit buxhetor për vitin përkatës.

Në vijimësi

2.2. Rekomandimi: Titullarët e ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin/Strukturat përgjegjëse në lidhje me investimet e huaja, të marrin masa për koordinimin dhe nxitjen e bashkëpunimit me korrespondencat përkatëse me donatorët në mënyrë që planifikimi i TVSH-së të kryhet para afatit të përgatitjes së PBA-ve respektive dhe këto komunikime t'i shërbejnë procesit të planifikimit buxhetor në mënyrë që të minimizohen rishpërndarjet buxhetore përgjatë vitit.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rekrutimin e punonjësve rezultoi se në 5 raste kriteret e pranimit të punonjësve janë të përcaktuar të përgjithshme dhe jo specifike sipas pozicioneve, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Struktura e Burimeve Njerëzore pranë ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin në bashkëpunim dhe me DAP, të marrë masa për të rishikuar dhe përditësuar kriteret e pranimit të punonjësve, duke përcaktuar qartë kërkesat specifike të çdo pozicioni pune, për të garantuar një proces të drejtë të bazuar në meritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi pagat për vitin 2023, rezultoi mospërputhje midis vlerave të pasqyruara në ditarin e pagave, të dhënave të deklaruara në sistemin e tatimeve (e-filing) dhe vlerave të evidentuara në pasqyrat financiare të MTM. Mospërputhjet lidhen me kontabilizimin e shpenzimeve në llogaritë 600 “Shpenzime personeli dhe shpërblime” dhe 601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në pasqyrën e performancës. Kjo situatë përbën rrezik për pasqyrim të pasaktë të të dhënave financiare dhe bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 5 dhe 6 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqet 31-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës i ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, të marrë masa për rakordimin periodik mujor të të dhënave ndërmjet ditarit të pagave, sistemit të tatimeve dhe pasqyrave financiare. Të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që kontabilizimi i shpenzimeve të pagave dhe kontributeve të bëhet në përputhje të plotë me të dhënat reale dhe kërkesat ligjore. Sektori i Financës të analizojë vlerat me diferenca, të kryejë sistemit në llogaritë kontabël, të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me pasaktësitë e krijuara dhe t'i pasqyrojë ndryshimet në Pasqyrat Financiare të vitit 2025.

Deri në 31.03.2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit financiar, rezultoi se MTM ka realizuar likuidimin me vonesë të 33 faturave për vitin 2023 dhe 12 faturave për vitin 2024. Këto pagesa janë kryer në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës origjinale, duke vepruar në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, të ndryshuar, ku përcaktohet detyrimi për dorëzimin e dokumentacionit justifikues pranë strukturës së thesarit brenda afatit të përcaktuar. Në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet me vlerën 2,024,624 lekë, e mbartur pa ndryshim nga viti 2023, që përfaqëson detyrime të krijuara para vitit 2010 dhe të evidentuara më parë nga KLSH. Nga auditimi u konstatua se në vitin 2023 janë likuiduar 9 fatura të vitit 2022 në shumën 48,562,124 lekë, si dhe në vitin 2024 likuiduar 12 fatura të vitit 2023 në shumën 2,674,228 lekë, transaksione të njohura në momentin e pagesës.

Këto transaksione nuk janë pasqyruar si detyrime të prapambetura në pasqyrat financiare përkatëse. Mos pasqyrimi i tyre përbën shkelje të UMF nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, i cili kërkon raportimin e detyrimeve të prapambetura që mbeten të papaguara për më shumë se 60 ditë nga data e faturës, si dhe të VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, që përcakton strategjinë për parandalimin dhe shlyerjen e tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-41, si dhe siç evidentohet në Aneksin nr. 4.1 dhe 4.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Titullarët e ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, të marrin masat për një planifikim/programim sa më real dhe të besueshëm të buxhetit, duke u mbështetur

në analizën e të dhënave që raportohet nga Sektori i Financës, si dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi SIFQ, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer mbi trajtimin e vendimeve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet në MTM, u konstatua se gjatë viteve 2023 dhe 2024 janë ekzekutuar pjesërisht vendime gjyqësore të formës së prerë në vlera përkatësisht 12,722,911 lekë për 13 persona dhe 14,441,563 lekë për 15 persona, pa ekzekutuar rikthimin në pozicionin e mëparshëm. Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë shkojnë deri në 15 vite në proces, duke përfshirë raste të pazgjidhura që datojnë nga viti 2010. Kjo përbën shkelje të detyrimeve ligjore për zbatimin e menjëhershëm të vendimeve gjyqësore, veçanërisht në rastet e rikthimit në detyrë të nëpunësve civilë, siç parashikohet në nenin 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neni 117 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i cili përcakton detyrimin e qartë të institucioneve publike për zbatimin e vendimeve gjyqësore, duke sjellë pasoja në të drejtat ligjore të individëve dhe rritjen e barrës financiare për institucionin. Sipas këtyre dispozitave, detyrimet duhet të njihen në momentin e krijimit të tyre (pra në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë), pavarësisht momentit të likuidimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 35-41, si dhe siç evidentohet në Aneksin nr. 4.1 dhe 4.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin, të marrin masa për intensifikimin e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm të ngritur për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke garantuar një ndarje të qartë dhe efektive të përgjegjësisë për përsheptimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke përfshirë jo vetëm likuidimin financiar, por edhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të individëve kur kjo është e parashikuar.

Në vijimësi

6.2. Rekomandimi: Sektori i Financës në ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrë masa për evidentimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, në pasqyrat financiare përmes llogarive përkatëse, në mënyrë që të reflektohet me transparencë situata reale e detyrimeve të krijuara. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e planifikimit buxhetor, uljen e barrës financiare afatgjatë dhe respektimin e të drejtave të individëve të përfshirë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në raportet e realizimit të projekteve për mbështetjen financiare në fushën e turizmit, si dhe në dokumentacionin shoqërues, mungon evidenca e procesit të monitorimit nga Grupi i Monitorimit të Kontratave, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të urdhrave të Ministrit nr. 69, datë 21.02.2023 (thirrja e parë për vitin 2023), nr. 222, datë 23.06.2023 (thirrja e dytë për vitin 2023) dhe nr.114/2024 për thirrjen e vitit 2024. Mungesa e dokumentimit të procesit të monitorimit çënon transparencën dhe gjurmueshmërinë e zbatimit të kontratave, kufizon mundësinë për të verifikuar përputhshmërinë e përdorimit të fondeve me qëllimin e financimit dhe rrit riskun për mosrealizim të objektivave të programeve të mbështetjes në turizëm.

Për vitin 2023 nënshkrimi i kontratave për subjektet fituese është realizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, në mungesë të delegimit të kompetencës nga Ministri i MTM-së, në kundërshtim me pikën 11 të VKM nr. 281, datë 13.4.2016 “Për përcaktimin e kritereve e të afateve të kërkesë propozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”, ku përcaktohet se Ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e Komisionit të Përzgjedhjes

së Projekteve, miraton projektet turistike që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 66-82, si dhe siç evidentohet në Aneksin nr. 4.1 dhe 4.2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrin masa për monitorimin e projekteve të mbështetura financiarisht në fushën e turizmit, duke siguruar që Grupi i Monitorimit të Kontratave të dokumentojë në mënyrë të rregullt dhe të gjurmueshme procesin e zbatimit të kontratave.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi. Në procedurat e prokurimit të kryera për vitin 2023-2024 të llojit “marrëveshje kuadër/minikontrata” dhe “blerje e vogël” të audituara me zgjedhje, Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit, nuk ka në përbërje të tij specialist të fushës dhe personin e ngarkuar me përgjegjësi materiale, në kundërshtim me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 43;

-Procesverbalet respektive të marrjes në dorëzim të shërbimit për minikontratat e lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër nuk janë protokolluar, por vetëm janë nënshkruar, në kundërshtim me Kapitullin III, pika 36 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenit 13, “Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave si dhe Rekomandimit të APP nr.5529/1, datë 18.07.2023 “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave të furnizimit të mallrave, të nënshkruara në bazë të marrëveshjeve kuadër”, pika III/4, germa “d” .

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqet 59-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Titullarët e Autoritetit Kontraktor/Sekretari i Përgjithshëm, i ministrive përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrin masa, që në të ardhmen, urdhrat për ngritjen e Komisioneve për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të përmbajnë specialistin e fushës dhe personin e ngarkuar me përgjegjësi materiale, me qëllim menaxhimin dhe dokumentimin e aktiveve në përputhje me marrjen në dorëzim sipas kriterëve specifike të kontratës.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi. Në procedurat e prokurimit të kryera për vitin 2023-2024, të audituara me zgjedhje rezultoi parregullsi në:

-Hartimin e dokumenteve të tenderit/kriteret e veçanta, në 3 raste në prokurimet me objekt “Rikonstruksion i Godinës së AKM”, “Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona Rreth tij” dhe “Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës”, jo në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, nenin 39, pika 4 të VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi kriteret për licenca profesionale dhe staf inxhinierik e teknik, nuk përputhen me objektin e tenderimit, gjithashtu dhe vendosja e kriterit për një punësim mesatar “*minimumi 150 punonjës*” nuk argumentohet llogaritja në mënyrë të detajuar, duke i bashkëlidhur procesverbalit të hartimit të dokumenteve të tenderit analizën e bazuar në preventivin e punimeve, sipas normave ditore të punës për punonjës, etj.

- Vlerësimin e ofertës fituese në 2 raste (tenderat “Projekti i Zbatimit për Parkun Natyror Liqeni i Ulzës dhe Zona Rreth tij” dhe “Qendra multifunksionale në Luginën e Vjosës”) ku dokumentacioni i publikuar në SPE dhe dokumentacioni fizik i dorëzuar pas shpalljes fitues, nuk përputhet, si dhe ka mangësi në plotësim, jo në përputhje me dokumentet e tenderit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqet 41-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Njësia përgjegjëse për hartimin e kriterëve të veçanta për prokurim në ministritë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrë masa që, për argumentimin e kriterëve të jepen qartë dhe në mënyrë të plotë arsyet e vendosjet së tyre shoqëruar dhe me llogaritjet analitike për çdo rast nëse ka, duke i bërë pjesë të procesverbalit për hartimin e kriterëve të veçanta/specifike.

Në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, Titullari i ministrisë përgjegjëse për mjedisin të kërkojë shpërblimin e dëmit në vlerën totale **1,851,948 lekë pa TVSH**, duke nxjerrë aktet administrative përkatëse si dhe kthimin e tij në rrugë ligjore, duke ndjekur të ndjekur shkallët e gjykimit dhe kontabilizimin e vlerës, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me objekt: “*Rikonstrukcion i godinës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*”, nr. 2644/8 prot., datë 10.07.2023, lidhur midis AK/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Operatorit Ekonomik “A.” SHPK, me vlerë kontrate 24,049,623.78 lekë me TVSH, e cila është amenduar me kontratën nr. 2644/8, datë 24.11.2023, rezultoi se nga verifikimi i punimeve në terren janë konstatuar parregullsi dhe mospërputhje ndërmjet volumeve të punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar dhe atyre të kryera realisht në terren, si edhe diferenca në volumet e llogaritura në librezat e masave, të cilat nuk janë në përputhje me punimet faktike si më poshtë:

-Zëri i punës nr.analize “*An 4-Prishje shtrese suvaje mure+tavane*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 3,825.6 m², duke krahasuar librezat e masave me punimet faktike në terren vihet me librezat e masave të dorëzuara në dosje, është përfshirë në mënyrë të gabuar prishja e suvatimeve të tavaneve në disa nga ambientet në Katin 1, ndërkohë që tavanet në këtë kat janë bërë me tavan gipsi, ashtu si edhe korridoret janë bërë me gips. Gjithashtu edhe një pjesë e fasadës së jashtme, pjesa e prapme është raportuar sikur është prishur suvaja në katin 1, ndërkohë që sipas fotografive fillestare përpara se të fillonin punimet, kjo pjesë e fasadës nuk ka qenë e suvatuar. Pas rillogaritjeve sipas gjendjes faktike në terren, për këtë zë pune, kjo sasi llogaritet 2,622.29 m². Diferenca midis sasisë së raportuar 3,825.6 m² dhe sasisë së llogaritur 2,622.29 në vlerën: 1,203m² x 320 lekë/m² = **384,960 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Zëri i punës nr.analize “*2.196/c-Hidroizolim me dy shtresa mapej*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 392.5 m², vihet re se, në librezat e masave të dorëzuara në dosje është përfshirë në mënyrë të gabuar hidroizolimi i disa sallave të tjera në kundërshtim me projektin e zbatimit, ku në të cilin parashikohet vetëm hidroizolimi i tualeteve. Sa më sipër pas llogaritjeve sipas punimeve faktike në terren, sasia duhet të ishte raportuar 91.5 m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën: 301 m²x1,500 lekë/m²= **451,500 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Zëri i punës nr.analize “*2.328-Patinim muri allçi (stuko)*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,410.6 m², referuar llogaritjeve sipas punimeve faktike në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 1,788.9m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën 612.6 m² x 250 lekë/m² = **155,400 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Zëri i punës nr.analize “*An.66-Lyerje me beton kontakt për muret qe do patinohen*” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 2,410.6 m², referuar llogaritjeve sipas punimeve faktike

në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 1,788.9m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën 612.6 m² x 350 lekë/m² = **217,564 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Zëri punës nr.analize “2.358/b-Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm + rrjete + suva” i raportuar në situacionin përfundimtar në sasinë 712 m², ndërsa sipas gjendjes faktike në fasadën e pasme te objektit kjo veshje nuk ishte kryer në të gjithë gjatësinë perimetrale, dhe jo me lartësinë e raportuar në librezës e masave. Referuar llogaritjeve sipas punimeve faktike në terren, del se kjo sasi duhet të ishte raportuar 618.4 m². Diferenca midis sasisë së raportuar dhe sasisë së llogaritur në vlerën: 94.1 m² x 1,700 lekë/m² = **160,024 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

-Gjithashtu në terren u konstatuan disa zëra pune në mangësi midis sasisë së raportuar në situacionin përfundimtar me sasinë në fakt, shuma totale e diferencave në vlerën **482,500 lekë pa TVSH**, përbën **dëm për buxhetin e shtetit**.

Vlera totale e diferencave të sipërme prej **1,851,948 lekë pa TVSH**, përbën dëm ekonomik për shkak të llogaritjeve të gabuara, punimeve të pakryera apo punime të llogaritura jo sipas gjendjes faktike në objekt, pasi Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori i punimeve kanë vepruar në kundërshtim me kontratën e zbatimit të punimeve dhe Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit” neni 24.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 54-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të ministrisë përgjegjëse për mjedisin, të merren masa për vlerësimin e përgjegjësive që kanë sjellë shkaktimin e dëmit për buxhetin e shtetit në vlerën **1,851,948 lekë pa TVSH**.

Autoriteti Kontraktor/Ministria e Mjedisit të nxjerrë aktin administrativ ndaj OE “A.” SHPK, për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në vlerën 1,851,948 lekë pa TVSH, duke ndjekur gjyqësisht kthimin e tij në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe kontabilizimin e saj.

Në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlerë të vogël “Shpenzime për qiramarrje automjeti” rezultoi se kërkesa dhe planifikimi i nevojës për realizimin e procedurës së prokurimit marrje me qira të automjetit **është e pabazuar dhe e pa justifikuar** pasi, prokurimi është kryer brenda periudhës së garancisë së shërbimit për mjetin me targë A..., për të cilin është realizuar procedura e prokurimit me objekt “Shërbim riparim automjeti për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit”, me vlerë 1,176,000 lekë me TVSH. Referuar procesverbalit për marrjen në dorëzim të shërbimit të riparimit të automjetit, datë 15.04.2024, rezulton që OE fitues ka lëshuar deklaratë garancie jo më pak se 6 muaj nga data e kryerjes së shërbimeve. Vlera e marrjes me qira të automjetit **1,152,000 lekë** me TVSH përbën shpenzim të pajustificuar dhe pa economicitet për buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për planifikimin e nevojave në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për prokurimet publike në ministritë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrë masa që, në të ardhmen planifikimi për çdo procedurë prokurimi të jetë në përputhje të plotë me kërkesat dhe nevojat e analizuara, me qëllim shmangien e shpenzimeve pa economicitet si në rastin e marrjes me qira të automjetit për titullarin e MTM-së në vlerën 1,152,000 lekë me TVSH.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e komponentit 5 “Monitorimi” për MFK, rezultoi se GMS/EMP e ngritur në MTM nuk kanë kryer procesin e monitorimit për detyrimin e kthimit në detyrë të punonjësve të larguar nga puna gjyqfitues, në kundërshtim me nenin 9, pika 3 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Pavarësisht ndryshimeve të kryera në strukturën organizative dhe kriterëve për pozicionin e punës, MTM nuk ka marrë masa për sistemimin e tyre për rikthim në detyrë apo në pozicione ekuivalente. Për pasojë, janë kryer pagesa të dyfishta për të njëjtin funksion: një punonjësi gjyqfitues i është paguar paga sipas vendimit gjyqësor, ndërsa detyrat sipas funksionit janë kryer nga një tjetër punonjës. Gjatë vitit 2023, bazuar në vendimet e formës së prerë të gjykatës rezultoi se janë ekzekutuar vendime gjyqësore të formës së prerë për rikthimin në detyrë për 15 punonjës, në shumën totale prej 12,723 mijë lekë dhe janë paguar shpenzime për tarifë përmbartimore në shumën 363 mijë lekë. Për vitin 2024, janë likuiduar 14,441 mijë lekë për 13 punonjës dhe shpenzime për tarifë përmbartimore në vlerën 445 mijë lekë. Vlera prej **27,973 mijë lekë** përbën përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 9-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1 Rekomandim: Ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe mjedisin të marrin masa për të siguruar ndjekjen e vazhdueshme dhe monitorimin e rasteve të rikthimit në detyrë të punonjësve gjyqfitues, ku të parashikohen mundësitë e emërimit në pozicione ekuivalente ose të lira brenda strukturës organizative, si dhe për rastet kur kriteret e pozicionit të mëparshëm kanë ndryshuar. GMS/EMP të forcojë kontrollin e vendimmarrjes dhe raportimin periodik për menaxhimin e vendimeve gjyqësore që kanë ndikim në burimet njerëzore dhe fondet buxhetore me qëllim, parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja të ngjashme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI LARTË I SHTETIT